


KËRKESË ANKIMORE – PËRPARA KAS

Tiranë – Datë 28.05.2025



ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Tel: 0697839115
KOALICIONI “PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE” (PD-ASHM)	

<u>OBJEKTI I ANKIMIT</u>	
1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 1317, datë 23.05.2025 – të KSHZ - “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025” 2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11 maj 2025 në zonën zgjedhore Qarku Fier. 3. Zgjidhjen e pasojave duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Fier.	
Vendimi	<u>TITULLI I VENDIMIT</u> “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025”
Nr.	Datë
1317	23.05.2025
1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkengjitet këtij vendimi ; 2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit për kandidatët për deputetë në zonën zgjedhore Qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkengjitet këtij vendimi; [...]	
Baza Ligjore: Nenet: 3, 8, 19, pika 1, 21, pika 1, gërma “a”, neni 25, 25/1, 25/2, 26 pika 2, neni 39, pika 2, nenet 115, 116, 117, 118, 119, 121, 123, 123/1, 123/2, 123/3, 124, 125, 127, 133, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 143, 160, 161 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.	



NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN

A. Në lidhje me legjitimimin e palës ankuese

Neni 123 i Kodit Zgjedhor parashikon se nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Zgjedhjet për Kuvend, bëhet nga KQZ. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore, pra në rastin konkret të Qarkut Fier.

Në çdo rast Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për Zonën Zgjedhore, sipas këtij neni, nuk mund të miratohet nga KQZ-ja, pa numëruar të gjitha kutitë e pranuar të rregullta, sipas këtij Kodi, në të kundërt vendimi i miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, është i pavlefshëm.

Kur gjatë hartimit të tabelës, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vëren mospërputhje të shifrave të votave për subjektet të tabelës së rezultatit të ZAZ-së me tabelat e rezultateve të qendrave të votimit, merr vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore me shifrat e korrigjuara, duke u bazuar në origjinalet e tabelave të qendrave të votimit. Një kopje e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore u jepet të gjitha subjekteve zgjedhore që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e zonës zgjedhore përkatëse.

Vendimi i KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KAS, sipas procedurave të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi.

Referuar Nenit 123/1 të Kodit Zgjedhor, parashikohet e drejta për të vënë në lëvizje KQZ-ne, si një e drejtë që i njihet subjekteve zgjedhore, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.

Sipas pikës 2 të po këtij Neni, kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor.

Ndërsa, neni 124, pika 3 parashikohen qartë se kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi. Nderkohe në baze të Nenit 124/6 i Kodit Zgjedhor, percaktohet se : ***“Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor”.***

- Zgjedhjet për Kuvend u caktuan në datën 11 Maj 2025, me dekretin e Presidentit të Republikës.

- Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025” ;

- Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor, “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE” (PD-ASHM), të kryesuar nga Partia Demokratike (PD), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025.



Për shkak se cenohen interesat tona të ligjshme, PD-ASHM e kundërshton këtë tabelë përmbledhëse të rezultateve, për shkaqet dhe arsyet që do të paraqiten në vijim.

Duke qenë se jemi subjekt zgjedhor i regjistruar rregullisht në zgjedhjet e 11 majit 2025, si dhe duke qenë se ankimi jonë paraqitet brenda afatit 5-ditor nga momenti i shpalljes së Tabelës Përmbledhëse të rezultateve nga KQZ, ne kemi legjitimitet të plotë për shqyrtimin e kërkesës tonë ankimore përpara KAS.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

Neni 12, pika 5, e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim "KAS") është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma "a" parashikon se KAS-i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, 124 e vijues të Kodit Zgjedhor parashikon se vendimet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.

Me Vendimin objekt ankimi është vendosur miratimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për Subjektet dhe kandidatët për Zgjedhjet për Kuvend të 11 majit 2025 në Qarkun Fier. Në zbatim të Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit zgjedhor, brenda afatit ligjor prej 5-ditësh.

Në këtë kuptim, Koalicioni "PD-ASHM" përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 124, pika 3 ka parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KQZ për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit, mund të bëhet jo më vonë se 5-ditë nga shpallja e këtij vendimi.

Në rastin konkret, vendimi objekt ankimi është shpallur në datën **23.05.2025**. Ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga dispozitat perkatëse të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, Koalicioni "PD-ASHM" përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.

Konkluzion: Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se sic kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga BF përmbush të tre kriteret proceduriale (***legjitimitimin, kompetencën dhe afatin ligjor***), kërkojmë nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore të paraqitur nga PD-ASHM lidhur me zgjedhjet e 11 maj 2025 në zonën zgjedhore Qarku Fier.



PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Zgjedhjet për Kuvend u caktuan në datën 11 Maj 2025, me dekretin e Presidentit të Republikës.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave në Qarkun Fier, KQZ-ja miratoi Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre për Zgjedhjet për Kuvend, sipas tabelave që

Nënshkrimi i Ankuesit

i janë bashkëlidhur vendimit, objekt ankimi [Bashkëlidhur Vendimi nr. Nr. 1317, datë 23.05.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025”].

Koalicioni PD-ASHM, ka ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullësi të rënda të procesit zgjedhor të ndodhura në të gjitha Qendrat e Votimit të Qarkut Fier.

Në Qarkun Fier, përdorimi i administratës publike dhe shtetërore si “makineri zgjedhore” ka qenë i përhapur dhe intensiv, duke krijuar një mjedis krejtësisht jo-transparent dhe të pabarabartë. Së pari, institucionet që duhet të jenë neutrale në procesin zgjedhor – nga administrata e bashkive deri te degët lokale të ministrive - janë mobilizuar në funksion të partisë në pushtet. Për shembull, funksionarë të ndryshëm jo vetëm që janë angazhuar në fushatë, por janë përfshirë në skema të mëdha të tjetërsimit të vullnetit të zgjedhësve, sikundër është blerja e votës.

Kjo gjendje, në thelb, e fshin ndarjen mes interesit publik dhe atij partiak, duke rrëzuar themelet e konkurrencës demokratike, sepse cdo force opozitare perballlet me Shtetin Elektoral. Aty ku Partia-Shtet fillon së vepruari, zgjedhjet pushojnë së qenuri të lira, të drejta dhe të barabarta.

Farsa elektorale që nevojitet të denoncohet është pikërisht kjo: opozita nuk hyn në garë me një fushatë të lirë dhe të ndershme, por përballet me një kundërshtar që gëzon të gjitha resurset shtetërore apo publike, si dhe mund të angazhojë edhe resurse private pa limit në dispozicion sa herë i nevojitet. Ndërkohë që partia në pushtet ka në dispozicion buxhetin e shtetit, rrjetin e administratës së fryre artificialisht, dhe strukturat policore apo gjyqesore etj., si instrumente trysnie, subjektet opozitare operojnë me fondet e tyre të kufizuara dhe pa akses duke u vendosur kështu, në një disproportcion të skajshëm në kapacitet, dukshmëri dhe aftësi mobilizimi.

Po ashtu, përdorimi i bandave kriminale dhe i grupeve të dhunshme për të frikësuar votuesit është kulmi i këtij sistemi. PD-ASHM ka denoncuar raste ku këta individë kanë patrulluar zonat urbane dhe rurale, kanë bllokuar rrugë dhe kanë ushtruar presion të drejtpërdrejtë mbi individë apo familje, duke u imponuar verime apo mos-veprime te caktuara.

Në këtë kontekst, zgjedhjet në Shqipëri nuk janë më një mekanizëm përfaqësues i demokracisë, por një **farsë elektorale** ku rezultati parapërcaktohet nga instrumentet e Shtetit, i cili njehsohet me Partinë, dhe sikur të mos mjaftonte, mbështetet në veprimtarinë e tij edhe nga grupet kriminale.

Edhe Raporti Paraprak i OSBE-ODIHR i dates 12 Maj 2025, pra më pak se 24 orë pas mbylljes së procesit të votimit, sa i takon Qarkut Fier, ka evidentuar këto probleme serioze:

1/ Intimidimi dhe presioni mbi votuesit



Gjatë fushatës janë raportuar raste konkrete të përpjekjeve për të penguar pjesëmarrjen e opozitarëve në aktivitete politike në të gjithë Qarkun e Fierit. Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë dokumentuar pretendime për mosmarrje pjesë në tubime opozitare nga frika e hakmarrjes, si dhe presion mbi familje për të votuar për subjektin në pushtet. Këto forma presioni përfshijnë që nga kërcënime të heshtura deri te deklarata të hapura nga përfaqësues lokalë të pushtetit që ndikojnë në votën e lirë dhe të ndërgjegjshme të qytetarëve.

Nënshtetësi / Apologjist

Të gjitha këto ngrejshë shqetësime serioze mbi standardet demokratike të procesit zgjedhor në këtë qark, si dhe mbi mundësinë reale të një gare të barabartë mes forcave politike.

2/ Përdorimi i burimeve shtetërore dhe klientelizmi

Edhe pse ky fenomen është gjërësisht i përhapur, në zona si Fieri shpërndarja e ndihmave sociale, emërimet e aprovuara nga pushteti lokal dhe investimet infrastrukturore janë perceptuar shpesh si “monedhë këmbimi” për vota. KQZ-ja ka trajtuar me ngurrim ankesat për keqpërdorim të burimeve administrative, duke lënë pa sanksione një pjesë të konsiderueshme të tyre.

Por, përtej problematikave mjaft shqetësuese që kanë ndodhur në Qarkun Fier, problem që impakton vlefshmërinë e zgjedhjeve kudo, ishte **votimi nga jashtë**. Ndonëse votimi nga jashtë, pra vota e diasporës, si një e drejtë kushtetuese për çdo shtetas shqiptar mbi 18 vjeç që jeton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhej të ishte një manifestim demokracie, ky proces u kthye në një manifestim të tjetërsimit të vullnetit të zgjedhësve, sikundër dëshmojnë të gjitha të dhënat publike, dhe ato që do të parashatrojmë para Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Është fakt i njohur botërisht se, megjithë kërkesat që PD – ASHM ka depozituar pranë KQZ-së, deri më sot nuk na është vendosur në dispozicion asnjë provë e vetme nga ky organ që të provojë përmbushjen e kushtit ligjor, që zarfat janë marrë personalisht nga zgjedhësit në adresën e regjistruar në Platformën elektronike.

Në vijim po analizojmë faktet, argumentat dhe dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMI.

Referuar Nenit 160 “Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit” parashikon se:

“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre”.



Referuar Nenit 161 “Përsëritja e zgjedhjeve” :

“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

2. Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend kur numri i zgjedhëse, që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përlllogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore, të bërë sipas nenit 162 të këtij Kodi. Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

3. Në rast pavlefshmërie për shkak të fatkeqësisë natyrore, sipas shkronjës “b”, apo të mosfillimit të votimit ose pezullimit më shumë se pesë orë të tij, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 160, merret në konsideratë numri total i zgjedhësve të regjistruar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

4. Në rast pavlefshmërie për shkelje të ligjit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 160, apo kur votimi është shpallur i pavlefshëm, sipas paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 138 të këtij Kodi dhe kur procesi i votimit ka përfunduar, sipas këtij Kodi, për përcaktimin e ndikimit merret në konsideratë numri i zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

5. Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së, që i shpall ato të pavlefshme. Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.

6. Zgjedhjet e shpallura të pavlefshme dhe për të cilat KQZ-ja ka vendosur përsëritjen, sipas këtij neni, përsëriten në një ditë të vetme për të gjitha zonat zgjedhore ku është vendosur përsëritja e tyre. Vendimi për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve merret nga KQZ-ja me përfundimin e procedurave ankimore, sipas kësaj pjese ose me kalimin e afateve ligjore të ankimit, të përcaktuara në këtë pjesë. Përsëritja e zgjedhjeve zhvillohet jo më vonë se 4 javë nga data e vendimit.

7. Ankimi ndaj vendimit të KQZ-së për shpalljen ose jo të zgjedhjeve të pavlefshme bëhet në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë pjesë”.

Të gjitha faktet, indicjet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të renda të dispozitave të Kodit Zgjedhor, të cilat kanë cënuar procesin zgjedhor në atë masë, që kanë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore të Qarkut Fier, si vijon:

Problemet e zgjedhjeve në qarkun e Dibrës, dhe bashkitë përbërëse Fier, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Roskovec dhe Patos, janë thellësisht të ndërlidhura me izolimin gjeografik, varfërinë strukturore dhe keqadministrimin e burimeve publike. Në kontekstin e zgjedhjeve të 11 majit 2025, këto probleme janë pasqyruar dhe përkeqësuar nga përdorimi politik i administratës shtetërore, intimidimi i votuesve dhe ndërhyrja e grupeve të interesit kriminal. Raporti ndërkombëtar i vëzhgimit të zgjedhjeve i OSBE-ODIHR, i datës 12 Maj 2025, bashkëlidhur kësaj kërkesë ankimore, përmend në mënyrë eksplicite se përdorimi i burimeve administrative nga partia në pushtet ka krijuar një avantazh të padrejtë dhe ka ndikuar ndjeshëm në rezultatin e zgjedhjeve.

Në Fier, kjo është përkthyer në presion mbi nëpunësit civilë, aktivizimin e strukturave të patronazhimit dhe madje edhe intimidim të votuesve të opozitës, sipas Raportit të OSBE-ODIHR. Kjo klimë e presionit



dhe manipulimit bie ndesh me çdo standard demokratik dhe ka prodhuar një atmosferë ku **farsa zgjedhore zë vendin e garës reale**. Në qytete si Patosi, Roskoveci, Mallakstra dhe Divjaka, ku varfëria është e përhapur dhe mundësitë për zhvillim ekonomik janë të reduktuara, kapja e votës përmes premtimeve të ndihmës ekonomike ose shantazhit të punësimit shtetëror është edhe më e lehtë për t'u realizuar.

Në thelb, Qarku i Fierit përfaqëson një tjetër tablo të situatës ku ndodhet demokracia shqiptare për shkak të papajtueshmërisë së procesit të zgjedhjeve me standardet demokratike të sanksionuara në legjislacionin zgjedhor shqiptar, dhe në standardet ndërkombëtare. Pabarazia në garë, kapja e institucioneve, instrumentalizimi i varfërisë dhe mungesa e përfaqësimit real krijojnë një cikël të mbyllur ku qytetarët ndihen të papërfaqësuar, të pambrojtur dhe të abuzuar në mënyrë të përsëritur.

A. Blerja e votës dhe presioni ndaj votuesve:

Në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 në Shqipëri, veçanërisht në Qarkun Fier, që përfshin bashkitë Fier, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Roskovec dhe Patos, u raportuan shqetësime serioze lidhur me blerjen e votës. Këto praktika u denoncuan nga opozita, media dhe organizata ndërkombëtare, duke ngritur pikëpyetje mbi integritetin e procesit zgjedhor.

A.1 Blerja e votës nëpërmjet skemave të mirëorganizuara kriminale:

Partia Demokratike e Shqipërisë ka denoncuar në mënyrë të përsëritur angazhimin e funksionarëve të lartë publikë, në nivel qendror apo vendor, si dhe grupet kriminale, të përfshira në shitblerjen e votës. Këto informacione i janë përcjellë Strukturës së Posacme Antikorrupsion (SPAK), me qëllim kryerjen e veprimeve të shpejta hetimore, me metoda speciale hetimi, me qëllim identifikimin e personave përgjegjës, veprimeve të tyre të paligjshme dhe parandalimin e ndikimit në proceset zgjedhore. Konkretisht, u përfshinë në shitblerjen e votave shtetasit si më poshtë vijon:

Njësia Administrative Frakull:

Darli Hoxha – Drejtor i OSHEE Tiranë;
Bardhi Kapa – Drejtor i Kadastrës Fier;
Qemal Hasani – Punonjës i ZAR Fier;
Dashnor Troka – Kryetar i Njesisë Administrative Frakull;
Alban Hasa – Nëndrejtor i OSHEE Fier.

Njësia administrative Dërmenas:

Fatmir Kajolli – EkspONENT i krimit të organizuar;
Emin Genica – EkspONENT i krimit të organizuar;
Bujar Hoxha – Biznesmen, pronar i restorant “Egnatia”, Fier.

Njësia administrative Mbrostar:

Armand Lita;
Arlind Mile.

Njësia administrative Libofsh:



Nënshkrimi i Njësies

Gazment Zela;
Francesko Kapo.

Njësia administrative Ballsh, Mallakastër:

Marjus Hykaj.

Bashkia Lushnjë:

Bledar Pupi – Drejtor i Postës, Dega Lushnjë (përmes disa punonjësve të shërbimit postar, ka organizuar një rrjet të shpërndarjes së parave në këmbim të votave. Nga ana e strukturave tona lokale janë identifikuar punonjësit Ervis Dhima dhe Erigert Gorovelli).

Fation Bardhi – Polic (aktiv në ish-komunën Bubullimë).

Bashkia Divjakë:

Avdi Snalla – Kandidat për deputet i Partisë Socialiste;
Fredri Kokoneshi – Ish-kryetar i Bashkisë Divjakë;
Loni Kokoneshi – Vëllai i Fredi Kokoneshit;
Blerim Zeneli – Punonjës i IMT-së, Bashkia Divjakë;
Llazar Vodo – Ish-Drejtor i Urbanistikës, Bashkia Divjakë.

Megjithë denoncimet tona të vazhdueshme, deri më tani nuk kemi ndonjë informacion apo të dhënë nga SPAK se ndaj këtyre shtetasve janë ndërmarrë veprime hetimore, me qëllim identifikimin e tyre dhe të veprimtarive të paligjshme, në formën e korrupsionit zgjedhor, me synim mbështetjen e Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj. Sic mund të konstatohet lehtësisht në të shumtën e rasteve këta shtetas janë funksionarë publikë ose eksponentë të krimit të organizuar, të cilët ose janë nën varësinë e drejtueses politike të Partisë Socialiste në Qarkun e Fierit, Belinda Balluku, ose kanë interesa të drejtpërdrejta ekonomike me Ministrinë që drejton Belinda Balluku.

Tërësia e veprimeve të paligjshme të konstatuara, duke përfshirë shpërndarjen e parave, përdorimin e mjeteve të paligjshme për ndikim të votuesit, përfshirjen e funksionarëve publikë, përbën një ndërhyrje të rëndë dhe të organizuar në procesin zgjedhor. Këto shkelje të ligjit, të ndodhura në një shkallë të gjerë përhapjeje siç provohet nga sa më sipër, kanë çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që ka ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore përkatëse, duke komprometuar barazinë e garës dhe vullnetin e lirë të zgjedhësve.

A.2 Blerja e votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera shtetërore:

Në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 në Shqipëri, janë ngritur akuza për blerje votash nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera shtetërore, veçanërisht në Qarkun Fier, duke përfshirë të gjitha bashkitë e këtij qarku. Konkretisht, qeveria shpërndau 62 milionë euro për pensionistët, në formën e të ashtuquajturit bonusi i pranverës, por që në fakt nuk ishte tjetër vecse “lëmosha elektorale” për pensionistët, duke iu dhënë këtyre të fundit një shumë prej 100 euro shumë pak ditë përpara datës së zgjedhjeve. Po ashtu, qeveria shpërndau 2.2 milionë më shumë në katër muajt para datës së zgjedhjeve, në formën e pagesave të paafësisë në punë.



[Signature]

Nënshkrimi / A. J. J. J.

Më datë 09.05.2025, vetëm dy ditë para zgjedhjeve, miratoi Vendimin “Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara”, duke krijuar kështu përfitime për një kategori të caktuar të popullsisë, kundërt të cilës ishin marrë më herët masa administrative nga autoritetet publike, sipas fushës së përgjegjësisë në referim të vendimit përkatës. Praktikisht, qeveria fali rreth 200 milionë euro gjoba të shtrira në një periudhë 9-vjecare (2015 – 2024).

Një rast flagrant në Qarkun e Fierit, i përdorimit të bonuseve shtetërore për qëllime elektorale ishte ai i Drejtoreshës së Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Ardita Kuci, e cila në datën 9 prill 2025, njoftoi se ishin hapur aplikimet për Skemën e Mbështetjes në Bujqësi për vitin 2025, të cilat do të zgjasnin nga data 14 prill deri më 30 maj 2025. Masat përfshinin mbështetje financiare për tufat e gjedhëve, të imtave, bletarisë, farave, fidanëve, inputeve të tjera, kultivimin e bimëve aromatike, fermat organike dhe mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

13 ditë pas këtij njoftimi publik, Drejtoresha e AZHBR-së, Ardita Kuci u shfaq në një takim elektorale të drejtueses politike të Partisë Socialiste, Belinda Balluku, me fermerë të Roskovecët, ku shpjeguan pikërisht skemën e mbështetjes financiare të fermerëve me subvencione nga Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR-ja. Ky ishte një rast flagrant i korrupsionit zgjedhor, nëpërmjet fondeve publike, ku fermerëve iu premttoheshin subvencione monetare dhe karburant, në këmbim të mbështetjes për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj në Qarkun e Fierit, dhe në rastin konkret Bashkinë Roskovec.

Po ashtu, sipas raportit të OSBE-së, zgjedhjet u karakterizuan nga mungesa e një fushe loje të barabartë, përfshirë censurën vetjake të gazetarëve dhe një fushatë polarizuese. U raportua për përdorim të gjerë të burimeve publike dhe pushtetit institucional nga partia në pushtet, si dhe raste presioni ndaj punonjësve publikë dhe votuesve të tjerë, përfshirë raste intimidimi.

Në Qarkun e Fierit janë raportuar raste të përdorimit të administratës publike dhe burimeve shtetërore për qëllime elektorale, duke përfshirë shpërndarjen e bonuseve dhe përfitimeve të tjera për të ndikuar në votën e qytetarëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe rregullat për ndarjen e qartë midis funksioneve publike dhe veprimtarive politike.

A.3 Intimidimi i qytetarëve si formë e tjetërsimit të vullnetit të zgjedhësve

Sipas Komisionit të Venecias, zgjedhjet e lira përbëhen nga dy aspekte: së pari, nga liria e zgjedhësit për të formuar opinionin e tij dhe së dyti, nga liria e shprehjes së këtij opinionin.¹ Liria e zgjedhësit për të formuar opinionin e tij nënkupton detyrimin e shtetit jo vetëm për të qenë i paanshëm, por edhe për të ndërmarrë veprime konkrete, që lidhen me aksesin në informacion mbi kandidatët që garojnë në zgjedhje etj. Nga ana tjetër, liria e zgjedhësit për të shprehur opinionin e tij nënkupton detyrimin e autoriteteve shtetërore për të respektuar procedurën e votimit, duke mbrojtur çdo individ nga kërcënimet ose presionet që mund të pengojë ushtrimin e vullnetit të tij.²

Në rastin konkret, në Qarkun Fier zgjedhësit nuk kanë qenë të lirë për të formuar dhe shprehur opinionin e tyre, sikundër është pranuar dhe nga Vëzhguesit Ndërkombëtarë, për shkak të intimidimit sistematik ndaj qytetarëve jo vetëm gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, por gjatë zgjedhjeve në tërësi. Kështu, drejtuesja politike e Partisë Socialiste, Belinda Balluku, njëkohësisht zv.kryeministre dhe Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Ministrin e Financave, Petrit Malaj, kryetarët e Bashkive Fier,



¹ Venice Commission, *Electoral Law*, Strasbourg: Council of Europe Publishing, Strasbourg: 2013.

² Ibid.

Nënshkrimi Belinda Balluku

Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Roskovec dhe Patos, kishin ngarkuar të gjithë vartësit e tyre, që përfshinin zv.ministra si Ami Kuzeli dhe Besfort Lamallari, drejtorë qendrorë dhe vendorë, përgjegjës sektorësh dhe deri në nivelin e specialistëve, duke përfshirë këtu edhe kompanitë publike në pronësi të shtetit si Albpetrol sh.a., të cilët kishin për detyrë kontaktimin e cdo qytetari, vecanërisht anëtarëve, simpatizantëve dhe mbështetësve të opozitës, që nëpërmjet formave të joshjes dhe në rast kur kjo nuk funksiononte të kërcënimin, të siguronin mbështetje për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj.

Nuk ishin të rralla rastet kur qytetarë refuzuan mbështetjen për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj, u përballën me masa represive, si gjopa ndaj bizneseve, prishje të ndërtesave apo objekteve që mund të shërbenin për qëllime banimi apo biznesi, shoqërime në Polici etj. Të gjitha këto kishin për qëllim të qartë që të nxisnin frikë dhe intimidim të qytetarët që kishin shprehur hapur mbështetjen për Partinë Demokratike dhe opozitën. Me shkresë zyrtare drejtuar Strukturës së Posacme Antikorrupsion (SPAK) dhe misionit të OSBE/ODIHR, drejtuesi politik i Partisë Demokratike ka informuar se menjëherë pas takimeve që kandidatët e PD-së kryenin me qytetarë, në banesat e tyre paraqiteshin punonjës të Policisë së Shtetit, që ushtronin presionin ndaj tyre me qëllim që të inkriminonin kandidatët e opozitës apo që të hiqnin dorë nga mbështetja për PD, ndryshe do të kishin pasoja.

Në rastet kur ndërhyrja e funksionarëve të lartë publike, në nivel vendor dhe qendror, përfshirë funksionarët e Policisë së Shtetit, nuk arrinte qëllimin për të siguruar mbështetje për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj, apo minimalisht për të hequr dorë nga mbështetja për Partinë Demokratike dhe kandidatët e saj, atëherë aktivizoheshin grupet kriminale, persona me rekorde të rënda kriminale, të shpallur në kërkim nga organet ligjzbatuese, të cilët nëpërmjet kërcënimeve, presioneve dhe kanosjeve të drejtpërdrejta ndaj qytetarëve siguroheshin që minimalisht këta qytetarë nuk do të përfshihejshin në fushatën elektorale në mbështetje të Partisë Demokratike apo nuk do të merrnin pjesë në zgjedhje më 11 maj. Policia e Shtetit ishte shumë e zënë për t'u marrë me këto raste, pasi i ishin ngarkuar detyra konkrete elektorale, dhe Fieri ishte shembulli më flagrant i kontratës së krimit me politikën, me shtetin.

Nga raportime të shumta dhe të besueshme të ardhura pranë strukturave tona, tregonin që drejtuesja politike e Partisë Socialiste, Belinda Balluku, njëkohësisht zv.kryeministre dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, iu premtonte haptazi grupeve kriminale dhe individëve me rekorde të rënda kriminale, që në rast fitoreje të Partisë Socialiste ishte ajo garancia që ata nuk do të prekeshin nga organet ligjzbatuese. Kjo i motivonte ata për të nxitur aktivitetin e paligjshëm dhe krimet zgjedhore, pasi kishin marrë garanci nga numri 2 i qeverisë se do të ishin të paprekshëm, cka në fakt deri më tani ka rezultuar e vërtetë nga pafuqia e Policisë së Shtetit (edhe pa dëshira e tyre), e Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm.

B. Vendosja e shtetit në shërbim të Partisë, duke përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për manipulimin e vullnetit të zgjedhësve.

Përdorimi i Burimeve Publike:

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore ka paraqitur disa denoncime në mënyrë zyrtare pranë Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me shpërdorimin e burimeve publike nga ana e funksionarëve shtetërorë dhe përfaqësuesve të Partisë Socialiste në Qarkun e Fierit, por megjithatë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka ndërmarrë masa konkrete jo vetëm për të sanksionuar përgjegjësit, por edhe për të ndërgjegjësuar aktorët pjesëmarrës, duke parandaluar shpërdorimin e burimeve publike.



[Handwritten signature]

Nënshkrimi i Autorit

B.1 Shteti vendosi investimet publike (prokurimet publike), intimidoi administratën shtetërore dhe përdori në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore në funksion të Partisë Socialiste për zgjedhjet e 11 majit 2025:

Vendosja e investimeve dhe fondeve publike në funksion elektoral:

Është raportuar se gjatë muajve para zgjedhjeve, qeveria intensifikoi zbatimin e projekteve publike në këto zona, duke përfshirë tenderime dhe prokurime publike me ndikim lokal, shpesh të shoqëruara me promovime politike dhe prezencë të zyrtarëve të lartë të PS-së. Kjo lloj praktike, kur nuk bazohet në planifikim të zakonshëm buxhetor por synon të ndikojë në preferencat elektorale të qytetarëve, përbën shkelje të parimeve të barazisë në garën zgjedhore.

Në vetëm katër muajt e fundit, qeverisja vendore dhe qendrore kreu prokurime publike me vlerë 33.3 milionë euro, të cilat në të shumtat e rasteve nuk ishin tjetër vecse “punë elektorale”, ku shkëlqeu në paligjshmërinë e tij “asfalti elektoral”, i përhapur kudo, vecanërisht në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Mallakastër. Më poshtë do të sjellim disa raste se si investimet publike u përdorën masivisht në funksion të maksimizimit të rezultatit të Partisë Socialiste në Qarkun e Fierit, nën udhëheqjen e bandës elektorale të Belinda Ballukut.

Në datën 24.01.2025, Bashkia Roskovec njoftoi tenderin me objekt *“Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në Njësinë administrative Strum”*, me vlerë fondi limit 59.111.172 lekë ose rreth 600 mijë euro. Tenderi është zhvilluar në datën 10.02.2025 dhe fitues është shpallur shoqëria “Caushi M” sh.p.k., në datën 17.02.2025, me ofertë fituese në vlerën 41.083.400 lekë plus TVSH. Kontrata parashikon një kohëzgjatje 6-mujore. Vihet re se kjo procedurë prokurimi është njoftuar, zhvilluar dhe shpallur fituesi i saj pas datës 11 janar 2025, që përkon në periudhën e ndalimeve për disa veprimtari të caktuara, të cilat vlerësohet se kanë për qëllim që të ndikojnë vullnetin e zgjedhësve në favor të një kandidati apo partie politike, e në rastin konkret në favor të Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj.

Kryetarja e Bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi, me qëllim të qartë për të mbështetur dhe favorizuar Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj në zgjedhje, ka njoftuar, zhvilluar dhe shpallur fituesin e një procedure prokurimi publik për rikonstruksionin e rrugëve të Njësisë administrative Strum, e cila ka një numër prej 7577 zgjedhësish ose rreth 30% e totalit të zgjedhësve të Bashkisë Roskovec, referuar të dhënave zyrtare për zgjedhjet vendore të vitit 2023. Zhvillimi i kësaj procedure prokurimi publik dhe fillimi i zbatimit të saj në periudhën e ndalimeve 4 muaj para zgjedhjeve përkon me fenomenin e njohur si *“asfalti elektoral”*.

Në datën 12 shkurt 2025, Partia Demokratike ka denoncuar në KQZ procedurën e prokurimit publik të shpallur nga Bashkia Fier me objekt *“Festojmë me emigrantët fierakë në Greqi”*. Shpenzimet për këtë aktivitet përfshinin pagesën për tre këngëtare, një autobus me 30 vende dhe shpenzime për koordinatorin e eventit. Megjithatë kamuflimin si një festë me emigrantët shqiptarë nga qarku i Fierit, qëllimi i këtij aktiviteti ishte shumë i qartë dhe kishte të bënte me mobilizimin e votës së Diasporës në Greqi për të mbështetur Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj, duke shpërdoruar fondet publike, paratë e takspaguesve të Bashkisë Fier.

Në datën 17.03.2025, ora 13:45, kryeministri Edi Rama ka postuar në profilin e tij në rrjetin social Facebook një postim me titull *“Divjakë – Në kantierin e rrugës Gurë-Remas”*, me përmbajtje si vijon: *“Divjakë – Në kantierin e rrugës rurale Gurë-Remas, një investim i Fondit Shqiptar të Zhvillimit që do të lidhë Gurin dhe Remasin, si dhe do të lidhet me rrugën e Karavastasë, duke lehtësuar jetesën e banorëve që jetojnë aty, por edhe duke hapur perspektiva të reja të zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit në këto*



zona.”³ Postimi është shoqëruar edhe me video, ku shfaqet kryeministri, së bashku me ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, si dhe kryetari i Bashkisë Divjakë, Josif Gorrea, duke inspektuar punimet e një rruge.

Në të njëjtën datë, ora 18:16, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ka postuar në profilin e saj në rrjetin social Facebook një postim me përmbajtje: “Divjakë, aty ku po punohet për rehabilitimin e rrugës Gurë-Remas, me një gjatësi prej afro 3.2 km. Një ndërhyrje e cila do ta sjellë këtë rrugë në parametrat e duhur, duke ju shërbyer të gjithë banorëve të zonës, e veçanërisht do të lehtësojë ndjeshëm fermerët. Investim i FSHZH, përmes të cilit hapen perspektiva të reja për zhvillimin e mëtejshëm të të gjithë zonës.”⁴ Postimi është shoqëruar edhe me foto, ku shfaqet ministrja, kryeministri dhe kryetari i Bashkisë Divjakë, duke inspektuar punimet e një rruge.

Kryeministri Edi Rama, ministrja Belinda Balluku, kryebashkiaku Josif Gorrea, me qëllim të qartë për të mbështetur dhe favorizuar Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, në Bashkinë Divjakë dhe më tej në Qarkun e Fierit, kanë drejtuar, marrë pjesë dhe kontribuar në promovimin e investimit që po kryhet për ndërtimin e rrugës Gurë-Remas, Divjakë. Kjo veprimtari ka pasur karakter publik dhe ka pasur për qëllim që të ndikojë zgjedhësit në Bashkinë Divjakë, Qarkun e Fierit dhe më gjërë, duke treguar punën që është duke u kryer nga qeveria dhe bashkia në infrastrukturën e qytetit të Divjakës. Megjithatë, kryerja e investimeve në infrastrukturë është detyrë funksionale e zyrtarëve organizator dhe pjesëmarrës në këtë aktivitet, promovimi i këtij investimi është përdorur për të ndikuar, manipuluar dhe tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025.

Në datën 24 mars 2025, Partia Demokratike ka denoncuar në KQZ procedurën e prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare” nga Bashkia Roskovec, me vlerë 20.7 milionë lekë, me kohëzgjatje 4 muaj. Kjo procedurë prokurimi ishte në kushtet e ndalimeve të parashikuara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Megjithatë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nuk konstatoi asnjë shkelje dhe nuk mori asnjë masë ndaj kësaj procedure, që kishte qëllime të qarta elektorale.

Në datën 1 prill 2025, Partia Demokratike ka denoncuar procedurën e prokurimit publik me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagjia e Re”, nga Bashkia Patos, me vlerë 40.57 milionë lekë, me kohëzgjatje pesë muaj. Kjo procedurë prokurimi, përveçse në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, është e kuptueshme se synonte përdorimin e asfaltit elektorale në funksion të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025.

Në datën 23 prill 2025, Belinda Balluku, së bashku me kryetarin e Bashkisë Lushnjë, Eriselda Sefa, u shfaqën në kantierin e një rrugë në fshatin Plug, Bashkia Lushnjë. Në datën 4 maj 2025, Belinda Balluku, së bashku me kandidatin e Partisë Socialiste, Ceno Klosi, njëkohësisht zv.ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, u shfaqën në promovimin e investimit të kryer në rrugën hyrëse në Njësinë Administrative Cakran, Bashkia Fier. Gjatë këtyre takimeve, shtetasja Belinda Balluku foli gjërësisht për të gjitha investimet infrastrukturore që po kryheshin në Bashkinë Fier dhe Bashkinë Lushnjë. Këto aktivitete, të cilat publikoheshin në rrjete sociale dhe media kishin qëllime të qarta elektorale, në ditët e fushatës zgjedhore, fare pak ditë përpara datës së zgjedhjeve. Fenomeni i asfaltit elektorale në Bashkinë Fier është



³ <https://www.facebook.com/ediramaal/videos/1032673081660605>

⁴ https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=1087057526795580&id=100064740292189&mibextid=wwXlfr&rdid=x8RjbK3t4y8AikFz#

Nënshkrimi i Belindës

denoncuar në mënyrë të përsëritur nga Partia Demokratike, por fatkeqësisht asnjë masë nuk është marrë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

(Sh)Përdorimi politik dhe elektoral i administratës shtetërore:

Janë raportuar raste të presionit të ushtruar ndaj punonjësve të administratës publike për të mbështetur në mënyrë aktive Partinë Socialiste, përfshirë pjesëmarrje në mitingje dhe fushata, si dhe ndjekje të votuesve (patronazhim) me qëllim orientimin dhe kontrollin e votës. Këto veprime bien ndesh me Kodin Zgjedhor dhe cenojnë rëndë lirinë e zgjedhësve për të votuar pa frikë apo ndërhyrje.

Konkretisht, në datën 12 prill 2025, emisioni investigativ “Piranjat”, në Syri Tv, publikuan një material filmik, në të cilin shfaqeshin punonjës të administratës shtetërore të Bashkisë Fier, të cilët ishin detyruar që të të vinin në mitingun e hapjes së fushatës të Partisë Socialiste. Në video shfaqet një nëpunës, i cili bën apelin, duke lexuar emrat: “Veziri s’ka ardhur ë? Ky Dervishi tjetër, Agroni, ka ardhur? Ligori ka ardhur. Syrja Greca? Mikail Cobo? Ermali është këtu. Gysarda Sako? Liljana Sako? Taulant Saraci? Vasilika Kalemaj? Arjan Kallashi? Amarildo ka ikur me makinë. Elvira Qoku këtu është. Besmira Myrto? Elona Ruko? Silvana Kacaniku? Dritan Gjergji? Sofie Gjergji? Aurel Metushi, Leonela Brahimaj? Aleksandër Bitri, Erik Levanaj, Ligori është? Edmondi është atje? Albanën nuk po e shikoj. Bedri Zani, Melio Jaupaj? Florian Muca? Mariol Grëmi? Reviol Tafa? Suzana Kucukali?”.

Më pas shfaqet një zotëri, i cili shprehet: “Po kemi miting moj, kemi miting. Na ka thirrur “i madhi” që të shkojmë. Këtu e mbushin nga Vlora, nga Gjirokastra, nga... Erdhën përfaqësues nga Fieri. Po me 50 veta. Mirë ju që jeni nëpunëse po unë dhe ky c’kërkojmë?”. Një tjetër zotëri shprehet: “Punoj usta. Punoj akoma unë në Bashki. Më detyruan eh. Neziri. E njeh ti Nezirin? Do vish më tha. Këto janë, që i njoh unë, janë 15 veta, të tjerët janë në administratë, që punojnë.”. Pastaj një zonjë shprehet: “Do vemi, do vemi të na shikojë ajo Moza, se do na bëjë apelin, sic bëri.”. Një tjetër zotëri thotë: “Unë jam kundër këtyre gjërave. Unë prandaj them që...unë vij edhe si nga halli po edhe një cikë...Nga ky moment tani dua dhe unë t’i kërkoj një vend pune. Dhe për atë e dua unë që të kem një...Zanat s’kam unë, po të jetë ndonjë shofer kështu.”.

Ky rast i dokumentuar provon në mënyrë të padyshimtë përdorimin kriminal që iu bë administratës shtetërore në funksion të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025, nga Partia Socialiste, drejtuesit dhe kandidatët e saj, duke detyruar punonjësit e administratës publike që të angazhoheshin aktivisht në fushatën e Partisë Socialiste. Por, rasti në fjalë është një dëshmi e dyfishtë e krimit zgjedhor, pasi përvec detyrimit të punonjësve të administratës për të marrë pjesë në një miting elektoral, në këtë video del qartë se pjesëmarrja në këto mitingje është një mënyrë edhe për të siguruar një vend pune në administratë, sic dëshmon zotëria, i cili shfaqet i fundit në pamjet filmike.

Në datën 1 maj 2025, drejtuesja politike e Partisë Socialiste, Belinda Balluku ka zhvilluar në ambientet e punës së shoqërisë “Albpetrol” sh.a., një takim elektoral me inxhinierët e rinj të kësaj kompanie. Sjellim në vëmendje se kjo kompani është në pronësi shtetërore, përkatësisht të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që drejtohet nga vetë shtetasja Balluku, duke bërë kështu që ky rast të jetë ilustrimi më i qartë i vënies së burimeve njerëzore në funksion të fushatës elektorale të Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025.

Por, akoma më e rëndë, më flagrante dhe kriminale është përdorimi i Policisë së Shtetit për fushatë zgjedhore. Drejtuesi politik i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi ka informuar zyrtarisht SPAK dhe OSBE/ODIHR në datën 6 maj 2025, se në atë datë Drejtori i Policisë Fier, Skënder Hitaj, ka thirrur një



Wënshkrimi / Anshkrimi

mbledhje pune informale me drejtues të policisë në qarkun Fier, në të cilën i ka urdhëruar vartësit e tij që të ndjekin, mbajnë në vëzhgim dhe të inskenojnë ngjarje mbi disa prej kandidatëve të Partisë Demokratike, përkatësisht Gentian Koci, Silva Hasaj, Samena Malenaj, Gentian Cela, përfshirë edhe vetë drejtuesin politik të qarkut Gazment Bardhi. Target i këtyre veprimeve të kundërligjshme kanë qenë edhe drejtues të strukturave lokale dhe anëtarë aktiv të PD-së.

Po ashtu, punonjës të Policisë së Shtetit shfaqeshin në dyert e qytetarëve sapo largoheshin kandidatët e opozitës, për t'i informuar lidhur me përmbajtjen e takimeve, si dhe për t'i nxitur në inkriminimin e kandidatëve të Partisë Demokratike. Me qëllim intimidimin e kandidatëve, drejtuesve lokalë dhe mbështetësve, nga ana e Policisë kontaktoheshin për t'u paraqitur në komisariate apo Drejtorinë Vendore, pasi sipas tyre kishte pasur ankesa nga qytetarë. Megjithatë, faktikisht kjo nuk rezultonte më pas të kishte ndodhur, por e gjitha ishte një inskenim për intimidim, frikësim dhe pengim të veprimtarisë së Partisë Demokratike dhe drejtuesve të saj lokalë në fushatë elektorale.

B.2 Punësime të reja në administratën publike, si shkelje e rëndë e ligjit për përfitim politik, duke devijuar vullnetin e zgjedhësve.

Punësime të reja në administratë gjatë fushatës:

Neni 91, pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1.3, gërma "d" i Vendimit Nr. 9/2020 ndalojnë punësimet në administratën publike në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve. Megjithatë, burime të besueshme në terren, kanë raportuar për shkelje të kësaj ndalese ligjore, përmes rekrutimeve të reja në administratën qendrore dhe lokale gjatë periudhës zgjedhore, të pajustificuara nga ndonjë nevojë për rritjen e organikës, veçanërisht, në kushtet e zbatimit të reformës territoriale. Në këto konsiderata, punësimet vlerësohen vetëm si të motivuara politikisht, dhe që synojnë të ndikojnë tek votuesit përmes ofrimit të përfitimeve publike në këmbim të mbështetjes elektorale, një praktikë që përbën formë të blerjes së votës dhe minon integritetin e procesit zgjedhor.

Me VKM-të nr. 110/2025 dhe nr. 181/2025, Qeveria hapi 2375 vende të reja pune në administratën shtetërore, në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese. Po ashtu, nga të dhëna e Thesarit të Shtetit, rezulton se shpenzimet për paga u rritën në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve në masën 7.2 milionë euro më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Por, për të kuptuar se si funksiononte skema e punësimit në shërbim të fushatës elektorale dhe zgjedhjeve parlamentare do të sjellim një shembull flagrant, i cili i është përcjellë nga drejtuesi politik i Partisë Demokratike edhe Strukturës së Posacme Antikorrupsion (SPAK).

Konkretisht, Partia Demokratike ka siguruar një listë me 82 emra, e gjeneruar nga Shtabet Elektorale të Partisë Socialiste në Qarkun Fier, në të cilën krahas emrit, atësisë, mbiemrit, shënohet qendra e votimit, arsimi, punësimi i mëparshëm, pozicioni në strukturat e PS-së, kërkesa për punësimi, prioriteti, punësimi efektivisht ose jo. Kjo listë, e cila përbëhet nga individë konkretë të angazhuar në fushatën elektorale të Partisë Socialiste është shembulli më i qartë dhe më flagrantë i korrupsionit zgjedhor, ku premtohen vende pune dhe kryhen efektivisht punësime në këmbim të marrjes së votës apo mbështetjes në fushatë për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj. Listën së bashku me emrat do ta gjeni bashkëlidhur këtij ankimi.

Në kuadër të hetimit administrativ, ne kërkojmë që të administrohen nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore që përbëjnë Qarkun e Fierit, institucionet e tyre të varësisë, si dhe institucionet qendrore që kanë



Nënshkrimi i Autorit

degë lokale në këtë Qark, numri i punonjësve të rinj, baza ligjore e emërimit të tyre, nevoja që ka diktuar emërimin, si dhe të dhënat mbi parashikimet që lidhen me organikën etj.

B.3 Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore, si dhe veprimtari të tjera të ndaluara.

Dhënia e lejeve të legalizimit dhe ndërtimit:

Neni 3, pika 1.3, gërma “a” parashikon ndalimin e veprimtarive publike të cilat konsistojnë në shpërndarjen e lejeve të legalizimit në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve. Pavarësisht këtij ndalimi, në të gjithë qarkun e Fierit, sipas të dhënave tona, janë shpërndarë leje legalizimi apo ndërtimi, në mënyrë selektive, vetëm për mbështetësit e subjektit zgjedhor Partia Socialiste ose për banorë të cilët kanë pranuar të votojnë Partinë Socialiste në këmbim të marjes së lejes përkatëse. Këto vendime janë një përpjekje e qartë për të siguruar mbështetje politike nëpërmjet përfitimeve konkrete, çka e minon besimin publik tek procesi zgjedhor.

Konkretisht, në datën 19 mars 2025, ora 08:17, shtetasja Majlinda Bufi, me detyrë kryetare e Bashkisë Roskovec, ka postuar në profilin e saj zyrtar në rrjetin social Facebook, postimin me përmbajtje si vijon: «Mirëmëngjes, me lajmin se rreth 300 dosje janë plotësuar me elementët e duhur nga grupet e terrenit dhe për gati 90 banesa janë gjeneruar Vendimet e Legalizimeve/Certifikatat e Pronësisë në njësitë Roskovec e Strum, ju urojmë një ditë të bukur.»⁵ Bashkëlidhur këtij postimi janë pesë foto, në të cilat shfaqen dy individë që plotësojnë dokumente (prezumohet funksionarë shtetërorë katër persona të tjerë që qëndrojnë krah tyre (prezumohen qytetarë përfitues të këtyre procedurave). Ky rast ilustron qartë përdorimin politik të lejeve të legalizimit dhe shpërndarjes së certifikatave të pronësisë për qëllime elektorale, duke pasur si synim final përkthimin në mbështetje për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj.

Në përfundim, përdorimi i mjeteve shtetërore për përfitim elektoral është një shkelje serioze e demokracisë dhe cenon lirinë e zgjedhjes së qytetarëve. Këto praktika kërkojnë hetim dhe ndëshkim të menjëhershëm nga institucionet përkatëse.

Dhënia në përdorim e pasurive publike:

Në datën 12 shkurt 2025, Partia Demokratike ka denoncuar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, vendimmarrjet e Këshillit Bashkiak Fier, të iniciuara nga kryebashkiaku Armando Subashi, të cilat kishin për objekt dhënien me qira të pronave publike në fshatrat Asturkas, Libofshë, Sheq, Marinas, Topojë, Bregas, Frakull, si dhe dy pasuri brenda qytetit të Fierit. Megjithatë u mohua që këto vendimmarrje të kishin lidhje me zgjedhjet, është e qartë se dhënia e këtyre pronave publike në përdorim nga privatët kishte qëllim të qartë elektoral, dhe ishte në shkelje të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Fatkeqësisht këto akte ligjore dhe nënligjore nuk u injoruan vetëm nga Bashkia Fier dhe Këshilli Bashkiak Fier, por edhe nga KQZ-ja që nuk konstatoi ndonjë shkelje në këto praktika të dyshimta, që kaluan me zero transparencë për publikun dhe erdhën në vëmendje vetëm pas publikimit nga mediat investigative.



G. Sistemi kriminal i përdorimit të patronazhistëve të Partisë Socialiste:

⁵ <https://www.facebook.com/photo/?fbid=2090803398058916&set=pcb.2090803738058882>


Nënshkrimi: Armando Subashi

Përdorimi i patronazhistëve nga Shteti dhe PS, vazhdoi të ishte një problem edhe në këto zgjedhje, që u evidentua dhe denoncua jo vetëm nga opozita dhe mediat, por edhe nga organizatat shqiptare dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e zgjedhjeve, duke përfshirë këtu edhe vëzhguesit e zgjedhjeve. Përdorimi i patronazhistëve nga struktura shtetërore dhe nga Partia Socialiste në zgjedhjet e 11 majit 2025 në Qarkun Fier, përfshirë të gjitha njësitet administrative përbërëse të këtij qarku, paraqiti një sfidë serioze për integritetin dhe lirinë e votës. Në këto zona, ku ndikimi lokal i administratës shtetërore është i fortë dhe lidhjet personale shpesh përcaktojnë dinamikat elektorale, mazhoranca ka vënë në lëvizje rrjete patronazhiste për të orientuar dhe kontrolluar votuesit në mënyrë sistematike.

Sipas dëshmive të mbledhura nga opozita dhe gazetarë investigativë, në Fier janë vërejtur grupe të organizuara personash të paautorizuar pranë qendrave të votimit me lista të detajuara emrash dhe adresash. Këta persona, të cilët ishin shpesh punonjës administrate, inspektorë apo madje efektivë policie në terren, nje pjese e mire e tyre me badge dhe akreditime të paligjshme të KQZ, e shoqëronin votuesin deri në derën e qendrës, nxitnin mbajtjen e fotografive të fletëvotimit dhe ushtroheshin presion konstant për t'u siguruar se vota *"rrjedhte"* në favor të subjektit apo kandidatit përkatës të PS-së.

Nga ana jonë janë siguruar dy lista patronazhimi, në të cilat del shumë qartë emri i patronazhistit dhe emrat e personave në patronazhim. Ajo që vihet re është që patronazhisti është punonjës i administratës lokale dhe është i detyruar të sigurojë një listë emrash të personave që do të mbështesin Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025. Këto lista provojnë në fakt realitetin e skemës kriminale të patronazhimit, e cila për shkak se mbeti e pandëshkuar në vitin 2021, u perfeksionua edhe më tej duke u shndërruar tashmë në një realitet, për të cilin kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama dhe drejtuesit e PS-së nuk ngurrojnë edhe ta mburrijn publikisht këtë skemë tërësisht të paligjshme, kriminale dhe korruptive.

Edhe pse ligji ndalon përdorimin e "burimeve njerëzore" të administratës për fushatë, shkrirja mes funksionit publik dhe atij politik bëri të mundur krijimin e një atmosfere frike dhe varësie të zgjedhësve nga aktorët lokalë. Avancimi i sistemit të patronazhimit në Qarkun e Fierit dhe në të gjithë Shqipërinë është problematik jo vetëm për faktin se shkel Kodin Zgjedhor, vendimet e Komisionit Rregullator, dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, por edhe sepse çon në mërzi të votuesve nga procesi: shumë zyrtarë lokalë raportuan se qytetarët refuzuan të paraqiteshin fare në votime, nga frika e presionit.

D. Manipulimi kriminal i votës së Diasporës

Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM), përmes numëruesve dhe përfaqësuesve të saj pranë KQZ-së dhe komisioneve përkatëse, ka kontestuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të dokumentuar parregullsitë serioze në procesin e votimit të Diasporës në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, me theks të veçantë mbi shtetin fqinj, Greqinë.

1. Dyshime serioze mbi integritetin e votës së Diasporës në tërësi, veçanërisht në Greqi

Përfaqësuesit tanë kanë kundërshtuar hapjen dhe pranimin e të gjitha zarfeve të tipit B të ardhura nga Greqia, mbi bazën e dyshimeve të thella dhe të besueshme për:

- Tjetërsimin e votës;
- Manipulimin e saj në favor të mazhorancës;



[Signature]
Nënshkrimi i Komisionit

- **Ndërhyrjen e mundshme të strukturave të administratës shtetërore shqiptare jashtë vendit;**
- **Përdorimin e praktikave të patronazhimit dheurvejimit të preferencave politike të emigrantëve shqiptarë në Diasporë, veçanërisht në Greqi.**

PD-ASHM ka paraqitur **prova dhe fakte të shumta** mbi mënyrën se si operatori postar fitues i tenderit, DHL, ka shkelur kushtet bazë të përcaktuara nga ligji dhe Kodi Zgjedhor, duke nënkontraktuar palë të treta në Greqi, të cilat:

- **Nuk i shpërndanë zarfat në mënyrë individuale, në banesë;**
- **Nuk kërkuar paraqitjen e dokumentit të identifikimit;**
- **Nuk siguruan që nënshkrimi të bëhej personalisht nga marrësi i zarfit.**

2. Mungesa e përgjigjeve nga KQZ

PD-ASHM i është drejtuar me kërkesa të përsëritura Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për:

- Marrjen e masave urgjente për ndalimin e kësaj praktike të paligjshme;
- Sqarime lidhur me mënyrën e shpërndarjes së zarfeve në Greqi;
- Masat për eliminimin e emrave të dyfishtë në listat zgjedhore (në Shqipëri dhe në Diasporë);
- Dokumente shkresore të operatorit postar që të provojnë se zarfat janë shpërndarë ligjërisht.

Asnjë nga këto kërkesa nuk ka marrë një përgjigje të plotë apo të argumentuar nga ana e KQZ-së deri në ditën e sotme.

Ndaj, për sa kohë që nuk ka asnjë provë ligjore dhe të dokumentuar për shpërndarjen e rregullt dhe të ligjshme të mbi 245.000 zarfeve në Diasporë, përfshirë rreth 68.000 zarfa vetëm në Greqi, ku një pjesë jo e vogël ishin votues të Qarkut e kontestuar, PD-ASHM e konsideron rezultatin zgjedhor në çdo zonë ku këto vota kanë ndikuar, si të **cenuar në mënyrë të rëndë në integritetin dhe ligjshmërinë e tij.**

Vendimi Nr. 13, datë 12.11.2024 i Komisionit Rregullator ka parashikuar mundësinë e kontestimit të votave (nga numëruesit) kur ata kanë dyshime rreth integritetit të votave.

Nisur nga dispozitat e cituar më sipër, ne gjejmë se ky proces është njëlloshur me shumë problematika thelbësore. Kur filloi nisma për përfshirjen e qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në këto zgjedhje, autoritetet zgjedhore vendase garantuan publikisht se çdo zarf me votë do të dorëzohej në adresën e deklaruar të votuesit në PER, përmes një shërbimi postar të drejtpërdrejtë. Votuesit u siguruan se nuk do të kishin nevojë të dilnin nga shtëpia dhe se procesi do të ishte personal, i sigurt dhe pa ndërmjetës.

Por më para pak ditësh nga dita e zgjedhjeve, KQZ ndryshoi papritur qasje. Përmes një njoftimi të thjeshtë të publikuar nga në rrjetet sociale të KQZ, votuesit shqiptarë në Greqi, u njoftuan nga KQZ se duhet të paraqiten personalisht pranë pikave të DHL për të tërhequr ose dorëzuar zarfin e votimit. Ky ndryshim i befasisëm ka sjellë jo vetëm konfuzion mes votuesve, por ka ngritur edhe shqetësime serioze për transparencën, standardin dhe ligjshmërinë e procesit.

Ndryshimi i mënyrës së shpërndarjes së zarfeve bie ndesh me deklaratat dhe rregullat e mëparshme të KQZ-së. Sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, operatori postar ishte i detyruar të dorëzonte fizikisht çdo zarf tek votuesi, kundër nënshkrimit dhe paraqitjes së një dokumenti identifikimi. Madje u theksua



[Signature]

Nënshkrimi i Anëtarit

publikisht se asnjë anëtar familje nuk mund të merrte zarfin në emër të një tjetri dhe do të bëheshin tre tentativa për t'u gjetur votuesi në adresë.

Në Greqi prej javësh kishim patur raportime se zarfat me vota nuk po u dorëzohen qytetarëve në dorë në banesë, por shpesh herë po përvetësohen në mënyrë të organizuar nga individë të caktuar që mund të paraqiten pranë pikave postare (*qoftë zyrtare, si zyra bastesh, apo hyrje pallatesh*), duke përdorur makina me qira me targa shqiptare për të shmangur gjurmët. Këta persona, të dyshuar të lidhur me Partinë Socialiste dhe strukturat e saj, ka njoftime se mund të kenë grumbulluar zarfa me fletët e votimit, cka është totalisht e ndaluar dhe penalisht e dënueshme.

Ndërkohë, siç dihet, Shteti shqiptar ka firmosur një kontratë me vlerë rreth 9.2 milionë Euro me kompaninë postare DHL për të garantuar shpërndarjen dhe grumbullimin korrekt të zarfeve kudo të Botë për 246.000 zgjedhës të regjistruar në PER. **Ky ndryshim i papritur në mënyrën e dorëzimit – nga “zarfi vjen në shtëpi” në “shko e merre vetë” – jo vetëm që rrit vështirësitë praktike për mijëra votues, por krijon dhe hapësirë për ndërhyrje, parregullsi dhe potencialisht manipulime procesi.** Vetem 1 jave para zgjedhjeve të 11 Majit 2025, ishin raportuar nga KQZ se mbi 6,000 zarfe të ardhura në Tiranë nga Greqia, ditën tjetër po 6.000 zarfa, ditën me pas 7.000 zarfa dhe në fund serish mbi 5.000 zarfa, ndërkohë që për disa javë më parë numri total ishte 17,700.

Si shpjegohet që një e treta e të gjithë zarfave të Greqisë vijnë në një ditë të vetme? Si shpjegohet që me pas për 3-4 dite kjo shifer kerceu në rreth 53.000 vota. Ky fluks i pazakontë dhe i papritur, në kontekstin e problemeve të raportuara, përforcon dyshimet mbi integritetin dhe parregullsinë e procesit.

Por, edhe vetë kutitë me votat e Greqisë prodhuan disa anomali, të cilat nuk mund të shpjegohen ndryshe përveç se kemi të bëjmë me një farsë elektorale. Konkretisht, nga 9601 vota të ardhura nga Greqia, 8198 vota ose 85.4% e tyre ishin për Partinë Socialiste, ndërsa vetëm 618 vota ose 6.4% ishin për Partinë Demokratike. Rezultati i PS në Greqi ishte 13% më shumë se rezultati i PS në votimin e Diasporës në tërësi dhe 23% më shumë se rezultati i PS nga votimi brenda vendit.

Qarku Fier	Greqia	Votimi jashtë vendit	Votimi brenda vendit
Totali	9601 vota	26.952 vota	154.465 vota
PS	8198 (85.4%)	19.733 (73.22%)	97.003 (62.8%)
PD	618 (6.4%)	3379 (12.54%)	39.314 (25.45%)

Tjetër anomali ishte edhe rezultati i disa kutive. Konkretisht, kutitë me nr. 100, nr. 101 dhe nr. 102 kanë 0 vota për Partinë Demokratike. Kutitë me nr. 103, nr. 104 dhe nr. 115 kanë nga 1 votë për Partinë Demokratike. **Ndërsa, kutitë me nr. 106, nr. 110 dhe nr. 112 kanë të njëjtin numër votash për Partinë Demokratike, përkatësisht 21 vota. Po ashtu, me të njëjtin numër votash janë edhe kutitë nr. 130, nr. 131 dhe nr. 132, përkatësisht me 21 vota. Pra, 6 kuti kanë ekzaktësisht të njëjtin numër votash (21 vota).** Kutitë me nr. 118 dhe nr. 123 kanë të njëjtin numër votash për Partinë Demokratike, përkatësisht 31 vota.



Shqetësimi ynë është i thellë jo vetëm për integritetin e votës, por edhe për pasoja të rënda që kjo situatë mund të ketë në besimin e publikut te procesi zgjedhor dhe demokracia në tërësi. Kjo situatë nuk u korrigjua ndaj, procesi i votimit të Diasporës u kthye një eksperiment të dështuar, i shtrenjtë dhe me pasoja serioze për vendin.

Ndaj PD-ASHM kërkon shpalljen të pavlefshme të gjithë rezultatit zgjedhor në zonën zgjedhore të kontestuar, pasi procesi ka qenë i deformuar, i manipuluar dhe në kundërshtim të hapur me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

E. Finalizimi i farsës elektorale (dita e zgjedhjeve dhe ditët e numërimit):

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025 në Qarkun Fier, përfshirë bashkitë Fier, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Roskovec dhe Patos, u raportuan një sërë problematikash që ngritën shqetësime serioze mbi integritetin e procesit zgjedhor.

Në Fier, përfaqësues të opozitës denoncuan praninë e drejtuesve të institucioneve publike, si drejtorë shkollash, të hipotekës, postës dhe doganierë, pranë qendrave të votimit. Këta individë, të cilët janë pjesë e administratës shtetërore, akuzohen për ushtrim presioni ndaj votuesve në favor të Partisë Socialiste. Ky veprim është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilat ndalojnë praninë e personave të paautorizuar brenda një perimetri prej 150 metrash nga qendrat e votimit.

Në të gjashtë bashkitë e qarkut, u raportua për një sistem të organizuar të patronazhistëve, të cilët shoqëronin votuesit deri pranë qendrave të votimit, duke ndikuar në mënyrë të paligjshme mbi vullnetin e tyre. Ky fenomen është një vazhdimësi e praktikave të mëparshme, ku individë të lidhur me Partinë Socialiste monitoronin dhe kontrollonin preferencat politike të qytetarëve, duke cenuar lirinë e votës.

Pavarësisht denoncimeve dhe raportimeve të shumta për parregullsi dhe shkelje të ligjit, reagimi i institucioneve përgjegjëse, si KQZ dhe organet e rendit, ka qenë i vakët. Mungesa e ndërhyrjes së menjëhershme dhe e masave ndëshkuese ka ngritur dyshime mbi paanshmërinë dhe efektivitetin e këtyre institucioneve në garantimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe transparent.

Konkretisht, ditën e votimit u konstatuan zyra ilegale të Partisë Socialiste, pa logo, pa simbole, në të cilat hynin votues para votimit, sic është rasti i zyrës pranë shkollës “Janaq Bakalli”, Bashkia Fier. Pamjet e siguruar tregojnë që brenda këtyre ambienteve ka individë që mbajnë në duar dhe plotësojnë lista zgjedhësish. Po ashtu, brenda qendrave të votimit u konstatuan fletë që përmbanin numrat e zgjedhësve, të cilat plotësoheshin sapo votonte dikush dhe më pas i raportoheshin strukturave të Partisë Socialiste, për t’u siguruar lidhur me pjesëmarrjen dhe mënyrën e votimit të qytetarëve.

Të tjera pamje të siguruar nga ana jonë tregojnë votimin me shoqërim në qendrat e votimit të Bashkisë Fier. Por, ajo c’ka është më flagrante dhe ka nevojë që të hetohet edhe nga ana e KAS-it është metoda e ashtuquajtur “treni bullgar”, ku zgjedhësve iu jepej në zyrat ilegale një fletë votimi e plotësuar dhe më pas kjo fletë votimi hidhej në kuti, duke marrë më vete fletën bosh të dorëzuar nga Komisioni i Qendrës së Votimit. Për ilustrim në kutinë e Qendrës së Votimit 3020 u gjet një fletë votimi që i përkiste një qendre tjetër.

Po ashtu, në Qendrën e Votimit nr. 3134/01, KZAZ nr. 59 Fier, nuk u gjendën dhe u konsideruan të humbura 500 fletë votimi, duke u gjetur vetëm 47 të tilla. Pyetja që lind natyrshëm është ku kishin shkuar këto 500 fletë votimi?! Apo iu duheshin patronazhistëve të zyrave ilegale të Partisë Socialiste për t’i përdorur për metodën e “trenit bullgar”?!

Ndërkohë që Qendrën e Votimit nr. 2903, KZAZ 54 Lushnjë, u gjendën më shumë fletë votimi se numri i pjesëmarrësve në zgjedhjeve, duke ngritur dyshime për mbushjen e kutive. Për këto tre qendra votimi,



[Handwritten signature]

kërkojmë që të bëhet hapja e tyre dhe të kryhet verifikimi i procesverbaleve, ashtu si edhe i fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore lidhur me parregullsitë e tyre, të cilat ngrejnë dyshime të arsyeshme për shkelje të rënda ligjore dhe cënim të integritetit të procesit zgjedhor.

Këto problematika në Qarkun Fier pasqyrojnë sfidat e vazhdueshme që përballen zgjedhjet në Shqipëri, ku përdorimi i burimeve shtetërore për qëllime politike dhe intimidimi i votuesve mbeten pengesa serioze për zhvillimin e një demokracie të konsoliduar.

Në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërimit. Sidoqoftë, ne si subjekt zgjedhor - përpara shqyrtimit në themel të kërkesës tonë - **kërkojmë nga KAS urdhërimin e KSHZ dhe /ose administratës së KOZ, për të na vendosur në dispozicion provat si më poshtë:**

- a) Të kryhet kryqëzimi i të dhënave të PEI-së për të gjitha Qendrat e Votimit në Qarkun Fier dhe të vihet në dispozicion, sa më parë, një kopje e njëhësuar e këtyre raporteve;
- b) Të vihet në dispozicion, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe operatori postar i kontraktuar prej tij, regjistri i nënshkruar personalisht nga çdo zgjedhës në diasporë, që vërteton marrjen personale të zarfit me materialet zgjedhore nga secili zgjedhës;
- c) Raportin e Audituesit Teknikien lidhur me problematikën e listave të zgjedhësve në këtë Zonë Zgjedhore.
- d) Kopje e të gjitha Regjistrave të Posaçem e çdo QV në Zonën Zgjedhore objekt ankimi ;
- e) Kopje e të gjitha Proces-Verbaleve në çdo QV dhe për secilën KZAZ, në Zonën Zgjedhore;

Në përfundim të kërkesës tonë ankimore,

SA MË SIPËR KËRKOJMË:

1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 1317, datë 23.05.2025 – të KSHZ - “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025”.
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11 maj 2025 në zonën zgjedhore Qarku Fier.
3. Zgjidhjen e pasojave duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Fier.

PROVAT QË PARAQITEN DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.



1. Vendimi nr. Nr. 1317, datë 23.05.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025”;
2. Raporti Paraprak i OSBE-ODIHR, datë 12 Maj 2025;
3. Dokumentacion provues i shkeljeve të ndodhura në Qarkun Fier.

Nënshkrimi i Arkivuesit

**KOALICIONI
PARTIA DEMOKRATIKE -ALEANCA PËR
SHQIPËRINË MADHËSHTORE” (PD-ASHM)**

Përfaqësuar nga:

Av. Marash LOGU

Përfaqësues Ligjor i PD-ASHM në KQZ

Marash Logu

Tiranë, 28/05/2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.5.2025

Nr: 1317

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE PËR REZULTATIN E VOTIMIT NË
ZONËN ZGJEDHORE QARKU FIER, PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE
KANDIDATËT PËR DEPUTETË, NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11
MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, dhe nenit 123, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe kreut VI.2, pika 3, të vendimit nr. 22, datë 20.03.2025, të Komisionit Rregullator, "Për rregullat për administrimin, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit", të ndryshuar.

VENDOS:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për deputetë për 11 subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Birjan CELIBASHI




ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR SUBJEKTET
QARKU FIER

Lidhja I



	ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Mejashtë	Gjithsej
1 Numri i zgjedhësve në listë	55.861	43.090	40.179	42.621	40.615	74.525	32.069	24.223	28.341	32.553	414.077
2 Fletë votimi të gjetura në kuu	25.122	17.623	16.799	15.905	16.673	30.998	12.974	11.389	12.603	27.157	187.243
3 Vota të pavlefshme	1.104	494	748	668	496	814	537	418	342	205	5.826
4 Vota të vlefshme	24.018	17.129	16.051	15.237	16.177	30.184	12.437	10.971	12.261	26.952	181.417
1 Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhëshiore	5.782	4.936	3.882	4.219	3.840	7.968	2.955	3.477	2.255	3.379	42.693
2 Partia Lëvizja Bashkë	157	163	137	108	180	612	151	93	71	459	2.131
3 Lëvizja Atdheu	41	18	26	16	16	37	16	19	5	30	224
4 Partia Koalicioni Euroatlantik	212	125	90	47	35	190	88	220	101	116	1.224
5 Partia Socialiste e Shqipërisë	15.873	10.708	10.427	8.843	10.402	17.653	7.885	6.232	8.980	19.733	116.736
6 Koalicioni Nisma Shqiptaria Bëhet	1.206	606	906	831	754	1.259	552	612	287	2.197	9.210
7 Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare	34	35	90	33	41	123	28	31	10	144	569
8 Partia Aleanca Demokracia e Re	21	2	11	9	5	5	4	3	5	4	69
9 Koalicioni Djalhtas për Zhvillim	110	40	147	178	154	312	174	31	218	64	1.428
10 Partia Mundësia	446	442	233	367	419	1.340	339	117	203	711	4.617
11 Partia Socialdemokrate	136	54	102	586	331	685	245	136	126	115	2.516
Gjithsej vota të vlefshme	24.018	17.129	16.051	15.237	16.177	30.184	12.437	10.971	12.261	26.952	181.417




ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		5.782	4.936	3.882	4.219	3.840	7.968	2.955	3.477	2.255	3.379	42.693
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Pelivan Buçi	336	106	140	149	169	276	191	2.299	113	422	4.201
2	Ledion Çala	185	111	67	50	51	354	96	63	28	74	1.079
3	Gentian Çela	3.055	3.386	265	64	95	142	43	11	25	0	7.086
4	Arben Çuko	0	0	122	179	206	686	98	0	0	0	1.291
5	Malin Dogani	54	29	171	50	315	106	45	11	11	31	823
6	Ardian Fero	34	17	14	43	69	331	53	14	16	37	628
7	Ajet Gurguri	72	48	81	211	923	1.537	114	31	183	205	3.405
8	Silva Hasaj	204	76	1.360	1.121	467	599	145	60	400	289	4.721
9	Arben Hoxhaj	36	19	22	98	31	89	39	9	525	55	923
10	Gentian Koci	159	85	127	695	429	665	136	394	229	253	3.172
11	Samena Malenaj	28	10	13	250	37	85	364	5	93	77	962
12	Pajtim Murizi	78	29	829	5	18	35	22	0	5	209	1.230
13	Suzana Numani(Rama)	33	18	12	434	331	1.191	177	24	156	192	2.568
14	Gersa Rrudha	16	76	61	6	4	9	9	0	3	75	259
15	Luljeta Sejko	36	20	26	123	62	736	92	9	30	107	1.241
16	Fatjon Semanaku	46	13	19	58	70	237	796	18	10	74	1.341
Gjithsej vota të vlefshme		4.546	4.219	3.329	3.536	3.277	7.078	2.420	3.018	1.874	3.010	36.307



ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Partia Lëvizja Bashkë

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		157	163	137	108	180	612	151	93	71	459	2.131
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Entiola Agaraj	30	39	18	21	39	135	35	22	10	70	419
2	Redion Bakuliyi	5	6	3	2	3	21	10	2	3	10	65
3	Saimir Brahimi	9	14	5	1	9	17	5	4	0	6	70
4	Endrit Bushaj	3	3	2	6	4	11	0	1	3	11	44
5	Ariela Cenaj	7	4	12	3	10	23	7	3	9	23	101
6	Stavri Çina	2	6	4	1	4	20	2	0	0	6	45
7	Rigels Çuko	4	7	4	3	7	19	3	3	1	12	63
8	Spiro Goga	2	4	1	0	1	28	3	2	1	11	53
9	Sara Koçiaj	1	2	5	2	3	13	3	0	1	24	54
10	Besart Latifaj	2	1	1	3	0	3	1	0	1	1	13
11	Besnik Manushi	4	0	0	5	1	49	4	0	0	4	67
12	Teuta Memaj	3	2	3	4	2	4	2	0	0	9	29
13	Elitjon Metaraku	1	0	0	3	2	19	0	2	0	3	30
14	Marenglen Nijka	0	0	2	0	0	5	0	0	0	2	9
15	Denis Salaj	0	3	0	3	4	15	2	1	1	8	37
16	Gabriela Sulkaj	2	1	3	2	1	12	16	0	1	11	49
Gjithsej vota të vlefshme		75	92	63	59	90	394	93	40	31	211	1.148




ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Lëvizja Atdheu

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		41	18	26	16	16	37	16	19	5	30	224
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Dorina Ago	6	5	4	1	2	5	2	4	0	0	29
2	Griselda Ago	3	1	0	0	0	0	1	1	0	0	8
3	Albin Bendo	4	1	1	1	4	1	5	0	0	0	18
4	Ardit Buzi	0	2	13	0	0	0	1	0	0	0	17
5	Amra Dinaku	0	1	0	0	1	1	0	0	1	0	4
6	Trifon Duka	1	0	1	0	1	1	0	2	0	0	6
7	Emanuela Herrington	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Lefter Kastrioti	0	1	0	0	0	0	0	0	1	0	2
9	Sebastian Kurti	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1
10	Dritan Lance	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
11	Margo Lori	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Anduen Melani	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
13	Sara Rama	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
14	Afrim Rojba	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	2
15	Endri Seiti	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
16	Robert Siqueca	0	0	1	0	1	0	0	1	0	0	8
Gjithsej vota të vlefshme		17	11	20	4	9	8	10	9	2	12	102



ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Partia Koalicioni Euroatlantik

		ZAZ.55	ZAZ.56	ZAZ.57	ZAZ.58	ZAZ.59	ZAZ.60	ZAZ.61	ZAZ.62	ZAZ.63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		212	125	90	47	35	190	88	220	101	116	1.224
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Vjola Avdulaj	9	2	3	8	2	8	1	0	3	1	37
2	Ali Bendaj	1	1	0	1	0	1	4	1	0	0	9
3	Dajela Daka	3	0	1	0	0	1	0	0	0	1	6
4	Burbugë Goxhaj	0	2	0	1	1	3	34	2	3	1	47
5	Sabire Hoxhaj	2	1	2	0	3	0	1	1	1	0	11
6	Afrim Kokla	115	50	26	1	2	13	8	0	1	15	231
7	Gerard Komini	0	4	2	2	3	56	10	3	11	2	93
8	Gëzim Maloku	0	1	1	0	1	12	0	0	0	0	15
9	Klejidian Mehmeti	1	0	0	4	5	20	0	1	0	0	31
10	Burhan Misiraj	2	1	2	19	9	49	17	190	71	72	432
11	Kleanth Miska	0	3	0	1	0	0	0	0	1	0	5
12	Florentina Nushi	1	1	1	0	2	1	0	0	0	0	6
13	Gjergji Peri	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
14	Elvis Pisku	22	31	26	2	0	7	4	5	0	2	99
15	Fatjon Pollozhani	14	3	1	0	0	1	0	0	1	0	20
16	Ernal Sefa	15	14	3	0	0	0	1	0	0	1	34
Gjithsej vota të vlefshme		185	115	68	39	28	172	80	203	92	95	1.077




ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Partia Socialiste e Shqipërisë

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		15.873	10.708	10.427	8.843	10.402	17.653	7.885	6.232	8.980	19.733	116.736
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Përparim Arapi	1.600	216	241	250	274	324	147	75	64	621	3.812
2	Nusret Avdulla	83	56	50	133	188	876	218	91	41	261	1.997
3	Maldria Bardho	2.652	389	145	44	133	136	48	33	10	1.020	4.610
4	Zegjine Çausi	61	33	27	316	263	803	589	1.931	51	600	4.674
5	Antoneta Dhima	138	65	101	395	520	1.256	4.181	154	50	1.871	8.731
6	Gerta Dhima	59	28	39	227	704	500	66	16	7	453	2.099
7	Zaira Gjika	80	41	36	264	285	2.014	204	48	55	521	3.548
8	Asfloral Haxhiu	5.483	4.587	1.148	49	66	183	60	29	17	1.779	13.401
9	Mariglen Hoxha	225	98	215	130	643	1.144	102	66	25	528	3.176
10	Klevis Jahaj	337	236	331	1.472	188	1.407	569	127	8.029	2.984	15.680
11	Ceno Klosi	856	757	795	3.196	5.068	5.225	438	190	113	2.652	19.290
12	Elton Korreshi	2.234	3.245	296	24	37	97	15	12	6	1.277	7.243
13	Dhimiter Kruti	147	57	3.275	25	38	70	11	4	2	945	4.574
14	Ramion Kurti	139	28	132	929	673	1.630	41	44	6	1.171	4.793
15	Ilirjan Musko	45	9	47	36	19	114	73	2.440	14	472	3.269
16	Avdi Snalla	212	73	2.455	11	32	40	12	5	0	773	3.613
Gjithsej vota të vlefshme		14.351	9.918	9.333	7.501	9.131	15.819	6.774	5.265	8.490	17.928	104.510



ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Koalicioni Nisma Shqiperia Bëhet

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		1 206	606	906	831	754	1.259	552	612	287	2.197	9.210
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Refat Beqiraj	118	38	46	190	74	111	74	52	59	104	866
2	Eda Cauli	241	52	30	27	27	58	28	12	14	161	650
3	Elton Çanaj	34	11	11	21	14	23	8	11	14	37	184
4	Patrick Çoku	51	23	301	29	25	29	13	4	2	92	569
	Fioralba Dervishi	89	194	52	80	70	178	40	28	12	237	980
	Laurent Driza	11	10	8	27	55	55	29	4	14	34	247
	Azmer Duleviç	121	76	110	116	178	288	79	92	38	597	1.695
	Luan Godaj	12	6	8	9	6	6	5	2	1	33	88
	Flogert Goricanj	15	25	3	4	5	17	9	123	14	12	227
	Euglen Gjini	12	2	13	9	23	33	13	2	11	49	167
5	Greta Kasa	13	8	7	7	13	17	20	4	7	44	140
6	Erion Muska	25	11	5	44	51	127	53	109	15	131	571
7	Ervin Toro	0	2	8	6	8	38	14	6	1	27	110
8	Visera Vrapj	19	8	62	6	4	10	6	8	5	65	193
9	Briseida Xhelaj	11	7	4	19	10	28	15	8	7	81	190
10	Indrit Zeqo	184	17	9	12	12	10	12	4	1	33	294
Gjithsej vota të vlefshme		956	490	677	606	575	1.028	418	469	215	1.737	7.171



ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		34	35	90	33	41	123	28	31	10	144	569
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Dritan Agaj	5	6	7	3	4	19	8	2	1	12	67
2	Hristo Beqiraj	2	1	1	1	2	1	0	0	0	0	8
3	Helmi Boçova	1	0	1	1	0	6	0	0	0	4	13
4	Lavdie Borçi	2	1	1	1	2	2	2	0	0	2	13
5	Edmond Çuko	1	3	5	0	2	6	0	2	0	12	31
6	Florena Dërka	0	0	3	0	0	0	0	1	0	3	7
7	Anila Durrishaj	3	2	0	0	1	5	0	1	0	2	14
8	Erigenta Hoxhaj	2	0	0	2	0	4	0	2	0	2	12
9	Metullae Kocaj	0	3	7	0	1	11	2	8	1	12	45
10	Nadire Ramadanaj	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
11	Agim Skëndaj	0	0	1	0	1	3	0	0	0	0	5
12	Geraldo Sollaku	1	0	0	0	0	2	0	0	0	1	4
13	Enver Shehaj	0	0	0	0	0	2	0	0	0	1	3
14	Dhurata Tashi	0	0	2	1	0	2	0	0	0	0	5
15	Ermir Troka	0	0	0	2	1	1	0	0	0	2	6
16	Resmie Vidhishta	0	0	0	1	0	0	0	4	0	3	8
Gjithsej vota të vlefshme		17	16	28	14	14	64	12	20	2	56	243




ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Partia Aleanca Demokracia e Re

Lidhja 2

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		21	2	11	9	5	5	4	3	5	4	69
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Daniela Berberi	8	0	1	1	1	2	1	1	0	0	15
2	Eneida Bitraj	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
3	Ariola Golloshi	0	0	1	0	0	1	1	0	0	0	3
4	Gjergji Golloshi	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1
5	Henri Golloshi	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	2
6	Natasha Golloshi	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	2
7	Siri Hamiti	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	2
8	Endrit Koçiaj	1	0	2	0	0	0	0	0	0	0	3
9	Etleva Korkuti	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
10	Rebi Korkuti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	Jonida Manaj	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	3
12	Natalia Ndreu	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	Amarildo Rape	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
14	Ergys Rrapi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
15	Çeleste Tarko	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
16	Artur Ymeraj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej vota të vlefshme		12	1	5	5	1	3	3	3	3	0	36



ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Koalicioni Djathas për Zhvillim

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		110	40	147	178	154	312	174	31	218	64	1.428
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Sidorela Alushaj	4	4	6	32	1	9	13	5	7	2	83
2	Artur Bali	13	0	0	0	1	0	0	0	0	2	16
3	Reneola Bita	0	0	0	1	4	5	0	0	0	0	10
4	Rei Cara	0	0	0	0	1	8	1	0	0	3	13
5	Eriselda Çelaj(Zotaj)	3	5	2	85	83	163	75	10	90	12	528
6	Alketa Gjika	1	0	1	3	6	6	0	0	4	2	23
7	Ismail Koxhaj	0	1	0	12	0	81	37	11	44	12	198
8	Arben Kulloraj	1	0	1	10	0	0	4	0	29	0	45
9	Pamela Metushi	1	0	1	1	17	0	1	0	2	1	24
10	Artan Murrizi	51	11	120	0	0	2	4	0	0	8	196
11	Saimir Pasho	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1
12	Ejona Rizaj	0	0	0	1	0	0	4	0	0	1	6
13	Manjola Sejdinaj	0	0	0	4	0	7	7	2	18	2	40
14	Llambri Sota	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1
15	Elio Shahaj	0	0	0	9	2	3	0	0	1	0	15
16	Ferdinant Zdrava	16	14	0	0	1	0	2	0	0	0	33
Gjithsej vota të vlefshme		90	35	131	158	116	286	148	28	195	45	1232



ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATETEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Partia Mundësia

		ZAZ.55	ZAZ.56	ZAZ.57	ZAZ.58	ZAZ.59	ZAZ.60	ZAZ.61	ZAZ.62	ZAZ.63	Me jashtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		446	442	233	367	419	1.340	339	117	203	711	4.617
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Eni Alliu	103	89	52	66	90	218	80	18	24	82	822
2	Nertila Furxhiu	22	24	14	19	32	123	31	16	5	49	335
3	Sheme Hamitaj	8	20	7	27	17	86	14	3	84	35	301
4	Enkeled Hysenaj	10	12	6	19	20	59	15	7	4	27	179
5	Mimoza Krasniqi	10	19	15	11	21	68	12	7	2	17	182
6	Jurgen Lika	14	15	6	7	23	26	12	5	1	16	125
7	Ymer Merkaj	7	3	4	8	6	11	3	0	0	8	50
8	Nikolin Metaj	2	8	3	5	6	38	6	0	4	12	84
9	Edlira Meziu	10	9	5	7	11	17	8	1	2	8	78
10	Arben Qejvani	5	4	0	38	14	22	7	3	1	19	113
11	Eduard Qyrana	0	2	0	3	7	10	3	3	0	8	36
12	Ylmi Sorraj	3	0	1	4	0	13	6	1	0	1	29
13	Ergjola Shanaj	10	9	10	12	27	71	6	5	1	34	185
14	Qerim Tabaku	34	12	0	2	3	3	3	4	0	16	77
15	Hamit Thana	0	0	0	0	10	17	1	0	1	1	30
16	Sedio Zgjana	45	12	8	2	9	8	0	0	3	12	99
Gjithsej vota të vlefshme		283	238	131	230	296	790	207	73	132	345	2.725



ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR DEPUTETË
QARKU FIER



Lidhja 2

Partia Socialdemokrate

		ZAZ 55	ZAZ 56	ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	ZAZ 60	ZAZ 61	ZAZ 62	ZAZ 63	Me jasthtë	Gjithsej
Vota të vlefshme gjithsej për subjektin		136	54	102	586	331	685	245	136	126	115	2516
Nr.	Kandidatët për deputetë											
1	Erim Aliaj	13	2	16	24	15	28	8	4	10	3	123
2	Altin Basha	56	0	5	3	4	3	2	2	0	5	80
3	Limonera Bozha	2	0	5	68	5	68	17	11	1	15	192
4	Vojasava Bushi	4	3	2	3	1	3	0	1	1	1	19
5	Franci Çepele	9	2	0	22	19	21	6	67	1	4	151
6	Gazmend Gega	1	0	0	49	3	4	2	2	2	0	63
7	Floreta Gjino	0	0	1	8	41	33	1	0	0	5	89
8	Nertila Hamitaj	3	0	3	3	16	19	1	2	0	3	50
9	Tetem Hasimaj	0	0	0	5	0	1	0	0	28	0	34
10	Ilirjan Hoxha	2	7	3	24	13	45	21	1	40	9	165
11	Flugert Hoxhaj	6	6	11	104	85	225	58	9	15	16	535
12	Hava Hoxhaj	7	3	4	91	11	72	9	0	4	1	202
13	Kristian Marku	0	0	0	8	5	47	16	0	0	3	79
14	Elis Merhaj	0	1	1	102	2	4	13	4	6	5	138
15	Ylli Skëndëraj	1	1	17	3	37	49	60	19	3	5	195
16	Besmir Skëndëri	0	11	6	1	0	6	8	1	3	0	36
Gjithsej vota të vlefshme		104	36	74	518	257	628	222	123	114	75	2.151



MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE Shqipëri – Zgjedhjet Parlamentare, 11 maj 2025

DEKLARATË E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 ishin konkurruese dhe u zhvilluan në mënyrë profesionale, por u mbajtën në një mjedis tejet të polarizuar, ku garuesit nuk gëzuan mundësi të barabarta. Megjithatë, kandidatët në përgjithësi patën mundësinë të bëjnë fushatë lirshëm, megjithëse disa raportuan se u përballën me intimidim. Administrata zgjedhore e menaxhoi procesin në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Votimi jashtë vendit, i realizuar për herë të parë në këto zgjedhje, u menaxhua mirë, pavarësisht dakordësimit politik dhe miratimit të vonë të kësaj mase, si dhe disa problemeve organizative. Partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjerë i burimeve administrative gjatë fushatës, duke krijuar një avantazh të padrejtë për kandidatët që ishin ndërkohë në detyrë. Gjithashtu, pati shumë akuza për presion ndaj votuesve, veçanërisht ndaj punonjësve të administratës publike. Për më tepër, legjislacioni zgjedhor dhe interpretimi i tij i ngushtë nga administrata zgjedhore nuk parandaluan praktikën e abuzit. Përqendrimi i pronësisë së mediave, që minon pluralitetin e burimeve të lajmeve, së bashku me autocensurën mes gazetarëve dhe dominimin e mbulimit mediatic nga dy partitë më të mëdha, kufizuan mundësinë e zgjedhësve për të bërë një zgjedhje të informuar. Përdorimi aktiv i rrjeteve sociale nga garuesit amplifikoi diskursin e fortë konfrontues dhe asnjë autoritet nuk u caktua për të identifikuar përmbajtjen manipuluese të dëmshme. Mekanizmi i ri i koordinimit mes institucioneve për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet zgjedhore është një zhvillim pozitiv, por nevojitet zbatim i mëtejshëm për të adresuar shqetësimet e vazhdueshme lidhur me praktikën e gabuar zgjedhore. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e organizuar mirë, por pati shpesh mosrespektim të procedurave dhe procesi u karakterizua nga një numër incidentesh intimidimi të zgjedhësve dhe ndikimit tek ta, si dhe mangësi gjatë numërimit të votave lidhur me procedurat dhe transparencën.

Kuadri ligjor ofron një bazë të mjaftueshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, pavarësisht nga nevoja e vazhdueshme për një reformë të gjerë zgjedhore përmes konsultimeve publike gjithëpërfshirëse. Mangësitë dhe paqartësitë e vërejtura zvogëlojnë qartësinë e kuadrit ligjor dhe krijojnë pasiguri në zbatimin e frymës dhe gërmeve të ligjit. Ndonëse disa rekomandime të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës janë adresuar, shumica e rekomandimeve të bëra prej kohësh, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, raportimin e ndërmjetëm mbi financimin e fushatës, dhe sigurimin e një klime të favorshme mediatike, si dhe me heqjen e përgjegjësisë penale për shpifjen, nuk janë adresuar, duke treguar mungesë të vullnetit politik për reforma gjithëpërfshirëse.

Parlamenti zgjidhet përmes një sistemi të modifikuar zgjedhor me lista të mbyllura dhe lista preferenciale të kandidatëve, i cili u miratua para këtyre zgjedhjeve. Sipas disa partive më të vogla, ky sistem favorizon dy partitë më të mëdha dhe kufizon ndikimin e votimit preferencial, duke u dhënë mundësi drejtuesve të partive që të vazhdojnë të ruajnë një kontroll domethënës mbi përfaqësimin parlamentar, pjesërisht për shkak të mungesës së demokracisë së brendshme të partive. Pavarësisht këtyre argumenteve që disa prej këtyre partive paraqitën para Gjykatës Kushtetuese, Gjykata vendosi që ky sistem është kushtetues.

Në përgjithësi, përgatitjet teknike për zgjedhjet u zhvilluan në mënyrë efikase, transparente, sipas afateve të vendosura dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Megjithatë, disa aktorë i perceptuan si të politizuar disa anëtarë të KQZ-së. Mbledhjet e KQZ-së ishin të hapura për vëzhguesit dhe u transmetuan drejtpërdrejt. Sfidat në organizimin e votimit jashtë

vendit ishin të konsiderueshme dhe u vunë re disa probleme me dërgimin me postë të fletëve të votimit; megjithatë, procesi u menaxhua përgjithësisht mirë. Komisionet e niveleve më të ulëta e menaxhuan procesin në mënyrë efikente dhe transparente, pavarësisht disa ndërprerjeve të shkaktuara nga zëvendësimi me vonesë i anëtarëve të caktuar nga partitë politike, sidomos anëtarëve të qendrave të votimit në ditët para zgjedhjeve. KQZ-ja bëri përpjekje të përmirësonte aksesueshmërinë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, por në ditën e zgjedhjeve vëzhguesit raportuan disa probleme me aksesueshmërinë në disa qendra.

Shqipëria vazhdon të përdorë teknologjinë në zgjedhje përmes përdorimit të identifikimit biometrik të zgjedhësve dhe pilotimit të votimit elektronik. Votimi elektronik u zhvillua në dy zona, kurse identifikimi biometrik u përdor në të gjitha qendrat e votimit. Duke ndjekur praktikën e mirë zgjedhore, KQZ-ja reduktoi varësinë nga ofruesi i pajisjeve të identifikimit biometrik dhe votimit elektronik dhe përdorimi i teknologjisë u dokumentua dhe menaxhua si duhet në mënyrë transparente dhe të qëndrueshme. Partitë politike dhe media patën akses të plotë për të vëzhguar funksionimin e pajisjeve të identifikimit dhe votimit elektronik, por KQZ-ja nuk publikoi informacion lidhur me testimet e sigurisë, duke përfshirë qëllimin dhe metodat e përdorura në këto testime. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it shprehën përgjithësisht besim te teknologjia, por pati edhe shqetësime të shprehura lidhur me këtë kryesisht nga opozita.

Në regjistrin e zgjedhjeve ishin 3.7 milion zgjedhës, duke përfshirë 245,935 zgjedhës të regjistruar jashtë vendit për të votuar me postë. Subjektet zgjedhore kishin të drejtën të kërkonin kopjen e plotë të listës së zgjedhësve, gjë që rriti transparencën e procesit të regjistrimit të zgjedhësve, pavarësisht nga shqetësimet që kjo mund të krijojë lidhur me privatësinë e të dhënave. Zgjedhësve iu dhanë mundësi të mjaftueshme për të rishikuar informacionin në listën e zgjedhësve, si fizikisht, ashtu edhe *online*. Sa i përket votimit nga jashtë vendit, pavarësisht nga fushata e zgjeruar e KQZ-së për informimin e zgjedhësve dhe vendimi për të pranuar dokumente shqiptare biometrike të identifikimit, të cilave u kishte kaluar afati i vlefshmërisë, rreth 41,000 kërkesa për regjistrim u desh të refuzoheshin për shkak të mosparaqitjes së një dokumenti të përshtatshëm që vërtetonte vendbanimin e kërkuarit. Në përgjithësi, procesi i regjistrimit të zgjedhësve ishte transparent, listat e zgjedhësve u konsideruan gjithëpërfshirëse dhe përgjithësisht të sakta, dhe zgjerimi i të drejtës për të votuar për të mundësuar edhe votimin jashtë vendit, shënuan një hap përpara drejt pjesëmarrjes më të madhe në zgjedhje.

KQZ-ja regjistroi tetë parti dhe tre koalicione brenda afatit ligjor dhe miratoi 2,046 kandidatë gjithsej në një proces gjithëpërfshirës. Verifikimi i kandidatëve çoi në heqjen e 16 prej tyre për shkak të rekordeve kriminale, gjë që në asnjë rast nuk u kontestua dhe partitë patën mundësinë t'i zëvendësonin. Detyrimi ligjor i subjekteve zgjedhore për të dorëzuar lista të plota kandidatësh, të hapura dhe të mbyllura, për të gjitha zonat zgjedhore në të gjithë vendin ndikoi në mundësinë e tyre për të garuar.

Në përgjithësi, fushata ishte e qetë, por pavarësisht nga kjo, u karakterizua nga një diskurs konfrontues dhe polarizues, veçanërisht *online* dhe sidomos mes dy partive politike kryesore dhe drejtuesve të tyre. Kandidatët, në shumicën e rasteve, ishin në gjendje ta zhvillonin fushatën lirisht, por mundësitë e garimit nuk ishin të barabarta. Partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjerë i burimeve shtetërore dhe kapaciteteve institucionale, duke përfshirë edhe bërjen publike vetëm pak kohë para ditës së zgjedhjeve të faljes së një numri të madh gjobash, dhe zyrtarët e lartë qeveritarë u angazhuan në një numër të madh aktiviteteve zyrtare që shpesh përkonin me mesazhet e fushatës, duke e bërë të paqartë vijën ndarëse mes shtetit dhe partisë. Pati pretendime për presion ndaj nëpunësve të administratës publike, raste intimidimi të mbështetësve të opozitës, si dhe përdorim të rrjeteve të patronazhimit, çka bie ndesh me standardet ndërkombëtare. Çështje të tjera shqetësuese përfshijnë raportimet për shit-blerje votash, tentativat për të ndikuar pa të drejtë tek zgjedhësit e marxhinalizuar, si dhe pretendime për ndikim të elementëve kriminalë në disa parti politike.

Zhvillimi i fushatës në rrjetet sociale nuk ishte i rregulluar me ligj dhe nuk u caktua asnjë autoritet për monitorimin e saj. Pavarësisht se shumica e partive politike nënshkruan një Kod Etike për Fushatat Dixhitale, disa kandidatë shpërndanë përmbajtje përçarëse ose manipuluese, ndërkohë që disa llogari palësh të treta raportohet se përdorën një sjellje të koordinuar joautentike në platformat *online* për të amplifikuar sulmet ndaj opozitës. Kandidatët përdorën në mënyrë aktive rrjetet *Facebook* dhe *Instagram*. Ndalimi nga qeveria i platformës *TikTok* që prej 6 marsit kufizoi mundësitë e disa kandidatëve për fushatë. Megjithëse KQZ-ja identifikoi shkelje në disa postime të institucioneve publike, ajo i ndërpreu hetimet në një numër të vogël rastesh, dhe përpjekjet e saj monitoruese mbetën përgjithësisht të kufizuara sa i përket fushës së mbulimit dhe efikasitetit.

Pjesëmarrja e grave në politikë është rritur vitet e fundit e megjithatë ecja e tyre përpara vazhdon të pengohet nga barrierat e rrënjësura strukturore, sidomos nga niveli i ulët të demokracisë së brendshme dhe mundësitë e kufizuara për financim. Megjithëse gratë zënë aktualisht gjysmën e posteve ministrore, ato mbajnë vetëm 36 për qind të vendeve në parlament dhe mbeten të papërfaqësuar sa duhet në organet zgjedhore kyçe, me vetëm tre anëtare gra nga 12 anëtarë që ka KQZ-ja gjithsej dhe 31 për qind të anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), me një numër të vogël grash në role drejtuese. Gjithsej, 38.5 për qind e kandidatëve të regjistruar ishin gra, duke përmbyllur kuotën prej 30 për qind, gjë që tregon nevojën për një vullnet më të madh politik për promovimin e pjesëmarrjes së grave.

Që prej vitit 2020, në financimin e fushatës zgjedhore janë bërë vetëm disa ndryshime të kufizuara. Rekomandimet kyçe të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias vazhdojnë të mbeten të pazbatuara dhe mangësitë në kuadrin rregullator ndikojnë në transparencën e financimit të fushatës dhe në barazinë e mundësive për partitë dhe kandidatët. Mangësitë në këtë kuadër, si përjashtimi i shpenzimeve të kandidatëve nga kufiri i shpenzimeve të partisë apo mosrregullimi specifik për huatë, fushatat *online*, shpenzimet e palëve të treta, mund të lënë hapësirë për anashkalim të rregullave. Megjithëse kërkohet me ligj, asnjë prej kandidatëve nuk bëri publike të dhëna lidhur me donacione apo hua dhe KQZ-ja nuk mund të ndërmerre ndonjë veprim për shkak se nuk ka instrumente ligjore për të siguruar zbatueshmërinë e dispozitave ligjore përkatëse. Mungesa e raportimit të ndërmjetëm dhe shqetësimet lidhur me efikasitetin e auditimit e ulin edhe më shumë transparencën dhe llogaridhënien në financimin e fushatës.

Klima mediatike vazhdoi të ishte tejte e kufizuar, ku pavarësia, shumëllojshmëria dhe integriteti i përmbajtjes së lajmeve u dëmtua nga financimi jotransparent, përqendrimi i pronësisë së medias, ndërhyrjet në autonominë editoriale dhe ndikimet politike. Mungoi raportimi i pavarur, duke cenuar rolin mbikëqyrës të medias dhe mungesa e gazetarisë kritike dhe informacioneve solide bënë që shumica e organeve mediatike të perceptoheshin si mbështetëse të partisë në pushtet. Megjithëse Kushtetuta mbron lirinë e fjalës, shpifja vazhdon të përbëjë vepër penale dhe gazetarët vazhdojnë të përballen me çështje gjyqësore për shpifje. Procedurat e emërimit, si për transmetuesin publik, ashtu edhe për rregullatorin e mediave audiovizuale nuk garantojnë pavarësinë *de facto*. Kodi Zgjedhor nuk parashikon mbulim të barabartë të fushatës në edicionet informative për partitë joparlamentare. Në televizionet e monitoruara nga MVZ-ja e ODIHR-it, edicionet informative u dominuan nga Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD). Mbulimi mediatik që nuk i atribuohet qartazi një subjekti zgjedhor ishte mbizotërues, por asnjë masë nuk u mor për adresimin e tij.

Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) i trajtoi çështjet në mënyrë transparente, në seanca publike, me pjesëmarrjen e palëve të përfshira. Megjithatë, KAS-i zbatoi një interpretim të ngushtë të rregullave lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore, duke bërë që praktika të tilla të kalonin shpesh pa u bërë objekt sanksionesh. Kriteret e ngushta statutores lidhur me kush e ka legjitimitetin për t'u ankuar për një vendim e kufizon mundësinë për zgjidhje ligjore efikase. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) luajti rol pozitiv në hetimin e korrupsionit zgjedhor, dhe mekanizmi i ri i koordinimit midis SPAK-ut, KQZ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme mundësoi një

shkëmbim më të mirë informacioni lidhur me krimet zgjedhore dhe u pa si një mekanizëm që mund të ketë pasur një efekt frenues. Megjithatë, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën pikëpyetje lidhur me efikasitetin e policisë në trajtimin e krimeve zgjedhore dhe efikasitetin e përpjekjeve kundër krimit të organizuar të lidhur me politikën.

Kuadri ligjor parashikon të drejta të plota për pjesëmarrjen në politikë të pakicave kombëtare dhe bërja e fushatës prej tyre në gjuhën e vet lejohet me ligj. Sipas disa partive politike të pakicave, detyrimi ligjor për të dalë me kandidatë në të gjitha zonat zgjedhore përbën pengesë për partitë më të vogla. KQZ-ja prodhoi materiale zgjedhore dhe materiale për edukimin e zgjedhësve në gjuhët e pakicave kombëtare, por këto ishin të kufizuara dhe nga vëzhgimi nuk u duk se u shpërndanë gjerësisht.

Sipas Kodit Zgjedhor, vëzhguesit e zgjedhjeve kanë të drejtë ta ndjekin procesin në të gjitha nivelet dhe të drejtën për të caktuar vëzhgues e kanë edhe subjektet zgjedhore. Megjithatë, mungesa e financimit për organizatat vendase të shoqërisë civile, veçanërisht nga donatorët ndërkombëtarë, e kufizoi mundësinë e tyre për të ndërmarrë një vëzhgim gjithëpërfshirës të këtyre zgjedhjeve, duke ulur nivelin e mbikëqyrjes së këtij procesi zgjedhor.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë në shumicën e zonave dhe transparente, por me mosrespektim të procedurave në shumë qendra votimi. Megjithëse procesi i votimit u vlerësua përgjithësisht pozitivisht në 95 për qind të vëzhgimeve, pati një numër të lartë vlerësimesh negative, kryesisht për shkak të mangësive procedurale dhe një niveli presioni mbi votuesit. Parregullsitë serioze që u vërejtën përfshinin një numër të konsiderueshëm incidentesh të frikësimit dhe ndërhyrjes së vëzhguesve dhe përfaqësuesve të partive në proces, ndikim tek zgjedhësit dhe pretendime për shit-blerje votash. Përveç kësaj, fshehtësia e votës u komprometua shpesh për shkak të mënyrës së organizimit të qendrave të votimit, mbipopullimit dhe ndërhyrjeve. Më shumë se gjysma e qendrave të votimit të vëzhguara nuk ishin të përshtatshme si duhet për votim në mënyrë të pavarur nga personat me aftësi të kufizuara. Votimi elektronik në përgjithësi u zhvillua pa pengesa, megjithëse shumë zgjedhës dukeshin të pafamiljarizuar me procesin dhe disa zyrtarë zgjedhorë nuk ishin të trajnuar si duhet ose nuk ishin të qartë për rolet e tyre. Transmetimi elektronik i rezultateve nga qendrat e votimit elektronik u anulua, dhe votat do të dërgohen fizikisht në qendrat e numërimit të votave. Megjithëse numërimi në shumë vende vazhdoi në mënyrë të rregullt, jo të gjithë vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve patën akses të plotë në proces dhe vunë re disa mangësi procedurale dhe një atmosferë kaotike në disa prej qendrave të numërimit. Vëzhgimi i procesit të numërimit në qendrat e numërimit të votave vazhdon.

GJETJET PARAPRAKE

Konteksti

Zgjedhjet parlamentare të 11 majit u zhvilluan në një klimë politike tejet të polarizuar. Prosesi i anëtarësimit në BE zuri vend dominues në diskursin politik, ku Partia Socialiste (PS) në pushtet bëri fushatë duke u përqendruar tek anëtarësimi në 2030-ën si objektivin e saj dhe duke vënë në dukje arritjet në procesin e negociimit, ndërkohë që partitë opozitare kritikuan përdorimin e retorikës së integritetit në BE si mënyrë për të hequr vëmendjen nga problemet në vend, si standardi i jetesës, korrupsioni dhe hapat mbrapa në demokraci. Realizimi për herë të parë i votimit nga jashtë vendit (VJ) në këto zgjedhje u pa përgjithësisht si arritje e rëndësishme.

Peisazhi politik dominohet nga PS-ja, drejtuar nga Kryeministri Edi Rama, dhe partia kryesore opozitare, Partia Demokratike (PD), drejtuar nga Sali Berisha. PS-ja ka fituar tre zgjedhje parlamentare

radhazi që prej 2013-ës dhe e konsolidoi më tej pushtetin në zgjedhjet vendore të 2023-shit.¹ Konfliktet e brendshme në PD çuan në krijimin e partive më të vogla.²

Në tetor 2024, ish-Presidenti Ilir Meta, drejtuesi i Partisë së Lirisë (PL) u arrestua për shkak të akuzave për korrupsion. Në nëntor, u hoq masa e arrestit në shtëpi ndaj Sali Berishës, e cila ishte vendosur si masë sigurie që prej dhjetorit 2023 dhe ai pritet të gjykohet për akuza për korrupsion.³ Nga fundi i 2024-ës dhe fillimi i 2025-ës u zhvilluan disa protesta të drejtuara nga PD-ja dhe të motivuara nga shqetësimet për shkatërrimin e perceptuar të institucioneve demokratike, pretendimet për korrupsion të qeverisë dhe shpërdorim të burimeve shtetërore. Protesta u zhvilluan edhe si reagim ndaj arrestimeve të disa zyrtarëve të lartë, që disa grupe opozitare i panë si arrestime të motivuara politikisht. Në muajin shkurt, u arrestua edhe Erion Veliaj, Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe anëtar i rëndësishëm i PS-së mbi akuzat për korrupsion.

Angazhimi politik i grave është rritur vitet e fundit; megjithatë, ecja e tyre përpara vazhdon të pengohet nga barrierat e hershme në sistem, përfshirë edhe demokracinë e dobët brenda partive dhe mundësitë e kufizuara për financim. Gratë mbajnë gjysmën e posteve ministrore, por janë më pak të përfaqësuara në parlament, ku mbajnë 50 nga 140 vende gjithsej (36 për qind).

Kuadri ligjor dhe sistemi zgjedhor

Zgjedhjet parlamentare rregullohen kryesisht nga Kushtetuta e 1998-ës dhe Kodi Zgjedhor i 2008-ës, plotësuar me një sërë aktesh nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).⁴ Shqipëria është palë në instrumentet ligjore ndërkombëtare të rëndësishme lidhur me zgjedhjet demokratike.⁵

Kuadri ligjor shërben si bazë e mjaftueshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, por një sërë mangësish dhe dykuptimësish cenojnë qartësinë ligjore dhe krijojnë pasiguri në zbatim.⁶ Kodi Zgjedhor u ndryshua ndjeshëm në korrik 2024 dhe shkurt 2025, duke sjellë ndryshime në sistemin zgjedhor dhe në rregullat e financimit të fushatës, duke futur për herë të parë edhe votimin jashtë vendit (VJ), siç ka vendosur Gjykata Kushtetuese.⁷ Përveç kësaj, dispozitat ligjore të shpallura jokushtetuese në 2021-

¹ Në zgjedhjet parlamentare të 2021-shit, PS-ja fitoi 74 mandate; aleanca e drejtuar nga Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim" (PD) fitoi 59 mandate; Lëvizja Socialiste për Integritim (LSI) – 4 mandate; dhe Partia Social Demokratike (PSD) – 3 mandate. Në zgjedhjet vendore të 2023-shit, PS-ja fitoi 52 bashki, Koalicioni Bashkë Fitojmë – 7, dhe Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen – 1.

² Në 2024-ën u krijuan tre parti nga shkëputja nga PD-ja: Koalicioni Euroatlantik, i krijuar nga ish-drejtuesi i PD-së, Lulzim Basha; Partia Mundësia, drejtuar nga Agron Shehaj; dhe partia Djathtas 1912, krijuar nga Enkelejd Alibeaj.

³ Në vitin 2023, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit (SPAK) e akuzoi Sali Berishën për korrupsion lidhur me periudhën kur ishte kryeministër (2005–2013).

⁴ Të tjera ligje relevante janë Ligji për Partitë Politike i vitit 2000, Ligji për Tubimet dhe Demonstratat i vitit 2001, Ligji për Mediat Audiovizuale i vitit 2013, Ligji për Dekriminalizimin i vitit 2015, Ligji për Barazinë Gjinore i vitit 2008 dhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i vitit 2024.

⁵ Përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 (ICCPR), Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të vitit 1965, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të vitit 1979 (CEDAW), Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit të vitit 2003, Konventën për të Drejtat e Personave më Afërsi të Kufizuara të vitit 2006 (CRPD), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të vitit 1950 (ECHR), Konventën Kuadër për Pakicat Kombëtare të vitit 1995, Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit të vitit 2004 (UNCAC). Në vitin 2023, Shqipëria nënshkroi Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik. Shqipëria është anëtare e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

⁶ Për shembull, periudha e zbatimit të rregullave për përdorimin e burimeve shtetërore për qëllime zgjedhore është e paqartë; për rregullimin e fushatës zgjedhore *online* nuk ka rregullime ligjore; në rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore dhe për organet, vendimet e të cilave mund të ankimohen, ka pasaktësi.

⁷ Më 9 dhjetor 2022, Gjykata vendosi se mungesa e legjislacionit që do t'u jepte shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit mundësinë për të votuar përbënte shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese dhe e detyroi parlamentin që brenda një viti të miratonte disa dispozita që mundësojnë votimin nga jashtë vendit.

shin, më pas u shfuqizuan.⁸ Pas një marrëveshjeje PS-PD, sistemi zgjedhor u ndryshua, por, ndryshe nga praktika e mirë ndërkombëtare, ky ndryshim u miratua pa një konsultim publik gjithëpërfshirës.⁹

Janë adresuar disa rekomandime të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, duke përfshirë ato lidhur me rishikimin e pragut kombëtar për kandidatët e pavarur dhe heqjen e mundësisë së drejtuesve të partive politike për të kandiduar në më shumë se një zonë zgjedhore. Megjithatë, shumë rekomandime të bëra prej kohësh mbeten të paadresuara, duke përfshirë rekomandimet lidhur me përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, të drejtën e votës së personave me aftësi të kufizuar intelektuale apo psikosociale, përgjegjësinë penale të shpifjes, mbulimin e pavarur mediatik gjatë fushatave zgjedhore, raportimin e ndërmjetëm mbi financimin e fushatës dhe zgjerimin e fushës së zbatimit të rregullave të financimit për të përfshirë edhe palët e treta¹⁰. Kjo ngre shqetësime lidhur me mungesën e vazhdueshme të vullnetit politik për adresimin e mangësive të hershme të kuadrit ligjor zgjedhor dhe nxjerr në pah nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse përmes një procesi të gjerë konsultimi.

Parlamenti zgjidhet nëpërmjet një sistemi proporcional me lista shumë-emërore për dymbëdhjetë zona zgjedhore që përkrijnë me qarqet administrative. Numri i mandateve për zonë bazohet tek popullata e saj, duke synuar garantimin e barazisë së votës, megjithëse për shkak të detyrimit ligjor dhe përpjekjeve për ta bërë numrin e kërkuar të votave për zgjedhjen e një kandidati sa më të afërt që të jetë e mundur në të gjitha zonat, ka prapëseprapë disa devijime të vogla.¹¹ Në sistemin e ri zgjedhor, çdo parti dhe koalicion paraqet një listë të mbyllur dhe një listë preferenciale për secilin nga 12 qarqet.¹² Secila listë e mbyllur duhet të përmbajë një numër kandidatësh të barabartë me një të tretën e numrit të mandateve për atë zonë (rrumbullakosur në numrin më të afërt) dhe një listë preferenciale që përmban saktësisht aq kandidatë sa numri i mandateve për atë zonë. Kuota gjinore kërkon që një në çdo tre kandidatë, si në listën e mbyllur, ashtu edhe në listën preferenciale, t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar. Kuota gjinore duhet të respektohet edhe në shpërndarjen përfundimtare të mandateve në listën preferenciale.

Për të pasur të drejtën e marrjes së mandateve në cilëndo nga zonat zgjedhore, një parti apo koalicion duhet të tejkalojë pragun kombëtar prej një për qind të votave, dhe numri total i mandateve për parti në secilën zonë zgjedhore përcaktohet proporcionalisht. Për secilën parti, mandatet e fituara në një zonë u jepen fillimisht kandidatëve në listën e mbyllur (deri në shterimin e saj), ndërsa mandatet e tjera u shpërndahen kandidatëve nga listat preferenciale, në bazë të numrit të votave preferenciale që ata marrin. Disa parti më të vogla, duke përfshirë edhe disa që përfaqësojnë pakicat kombëtare, e kundërshtuan sistemin e ri zgjedhor në Gjykatën Kushtetuese me argumentin se ky sistem u shërben dy partive dominuese, cenon mundësinë reale të një kandidati nga listat e hapura për të fituar mandate dhe nuk përmbush kriteret kushtetuese të votimit preferencial. Megjithëse Gjykata Kushtetuese e vlerësoi këtë sistem si kushtetues, pasi ligji nuk cenon kriterin që ka të bëjë me listat e kandidatëve, ky sistem mundet prapëseprapë të rezultojë në një kontroll ose ndikim të konsiderueshëm të drejtuesve të partive në përfaqësimin parlamentar, pjesërisht për shkak të mungesës së demokracisë së brendshme, pasi

⁸ Gjykata Kushtetuese vendosi në vitin 2021 se kriteret për shpërndarjen e mandateve parlamentare ishin jokushtetuese, sidomos pragu i kërkuar për rirenditjen e kandidatëve të listave preferenciale dhe pragu kombëtar prej një për qind për kandidatët e pavarur.

⁹ Shih, për shembull, paragrafin 25 të Udhëzimeve të ODIHR-it për Ligjbërjen Demokratike të vitit 2023, sipas të cilave “Të gjitha palët dhe aktorët e interesuar duhet të kenë mundësinë e përfshirjes në procesin e ligjvënies, të informohen rreth tij dhe të kenë mundësi të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë kuptimplotë.” Shih gjithashtu Seksionin II.A.5.IV të Listës së Kontrollit për Sundimin e Ligjit të Komisionit të Venecias në lidhje me aksesin publik në projektligje.

¹⁰ Shihni raportet e mëparshme të ODIHR-it të lidhura me zgjedhjet në Shqipëri. Shihni gjithashtu opinionet e përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias mbi ndryshimet në Kushtetutë dhe Kodin Zgjedhor në vitin 2020 dhe mbi ligjin zgjedhor dhe praktikën në vitin 2011.

¹¹ Aktualisht, Kukësi është e vetmja zonë që devijon më shumë se 10 për qind nga mesatarja kombëtare, megjithatë për shkak të përmasave më të vogla të kësaj zone (me vetëm 3 mandate të zgjedhura), transferimi i një tjetër mandati kësaj zone do të çonte në një devijim edhe më të madh.

¹² Renditja e kandidatëve në listat e mbyllura bëhet nga partitë, kurse në listat preferenciale renditja bëhet sipas rendit alfabetik, dhe çdo zgjedhës mund të zgjedhë një kandidat.

shumica e mandateve do t'u shkojnë pashmangshmërisht kandidatëve nga listat e mbyllura, pavarësisht nga numri i votave preferenciale që marrin kandidatët në listat e hapura.¹³

Administrata zgjedhore

Zgjedhjet administrohen nga KQZ-ja, 93 Komisione të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe 5,225 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi bëhet në nivel qarku nga Grupet e Numërimit të Votave (GNV) në 93 Qendra të Numërimit të Votave (QNV), një në secilën zonë, plus edhe një qendër për numërimin e votave nga jashtë vendit. KQZ-ja përbëhet nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet dhe Zëvendëskomisioneri, Komisioni Rregullator (KRR), si dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS).¹⁴ Anëtarët e KQZ-së zgjidhen nga parlamenti me jo më pak se tre të pestat e votave. Nga 12 anëtarë të KQZ-së gjithsej, vetëm tre janë gra.

KQZ-ja i administroi zgjedhjet në mënyrë transparente dhe përmbushi afatet e parashikuara me ligj. Mbledhjet e KQZ-së u njoftuan në kohë, ishin të hapura për aktorët e interesuar, duke përfshirë partitë politike, të cilat morën pjesë rregullisht, si dhe u transmetuan drejtpërdrejt në kohë reale. Gjithashtu, KQZ-ja i miratoi vendimet në kohë, por pati raste kur vija e ndarjes së kompetencave midis Komisionerit dhe Rregullatorit dukej e megjullt. KQZ-ja u tregua e hapur ndaj aktorëve të ndryshëm të interesuar, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe partitë politike dhe ndarjen me ta të versioneve paraprake të akteve nënligjore para miratimit. Megjithatë, për shkak të përditësimeve të konsiderueshme që bëheshin vazhdimisht, informacionet e ndryshme zgjedhore nuk ishin menjëherë të disponueshme për publikun në faqen zyrtare të KQZ-së. Disa akte nënligjore u ndryshuan deri një javë para ditës së zgjedhjeve, si ndryshimet lidhur me udhëzuesin për procedurat e numërimit të votave, përpunimin dhe numërimin e votave të ardhura me postë nga jashtë vendit, duke ngritur shqetësime se disa informacione kyçe mund të mos u shkonin në kohë zyrtarëve të qendrave të votimit, partive dhe aktorëve të tjerë, si dhe duke sjellë konfuzion mes zyrtarëve të zgjedhjeve dhe vëzhguesve të partive lidhur me procedurat.¹⁵ Në përgjithësi, KQZ-ja veprroi në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe gëzoi një nivel të lartë besimi, megjithëse disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it i perceptuan si të politizuar disa anëtarë të KQZ-së.

Për herë të parë, Shqipëria realizoi votimin nga jashtë vendit (VJ) përmes votimit me postë, gjë që u konsiderua gjerësisht si një zhvillim i rëndësishëm zgjedhor. Në përgjithësi, VJ-ja u organizua teknikisht mirë, duke pasur parasysh edhe që numri i regjistrimeve rezultoi të ishte shumë më i madh sesa pritej nga KQZ-ja. Për VJ-në pati një kuadër rregullator të përshtatshëm, megjithëse disa akte nënligjore në këtë fushë u miratuan me vonesë.¹⁶ Zgjedhësve iu dërguan me postë fletët e votimit për zonat zgjedhore ku figuronin të regjistruar për herë të fundit në Shqipëri dhe që vota e tyre të numërohej, duhej që ajo të kthehej në KQZ deri më 11 maj, ora 7 e pasdites.¹⁷ Qendra e përpunimit të VJV-së në Tiranë ishte e

¹³ Gjykata e hodhi poshtë ankesën, duke u shprehur se sistemi ishte në përputhje me nenin 64.3 të Kushtetutës, sipas të cilit "ligji për zgjedhjet garanton që jo më pak se dy të tretat e listës shumë-emërore duhet të jenë objekt i votimit preferencial dhe të garantojë përfaqësim gjinor."

¹⁴ Komisioneri ka autoritet të gjerë ekzekutiv dhe përfaqëson KQZ-në. Zëvendëskomisioneri ka funksionin specifik të mbikëqyrjes së përdorimit të teknologjisë së identifikimit të zgjedhësve. Rregullatori miraton akte nënligjore, ndërkohë që KAS-i shqyrton ankesat kundër vendimeve të Komisionerit dhe KZAZ-ve, rregullave për pavlefshmërinë e votimit dhe rezultateve të zgjedhjeve, dhe mund të vendosë sanksione me kërkesë të Komisionerit.

¹⁵ Seksioni II. Paragrafi B, pika 3 e Deklaratës Interpretuese të Rishikuar të Komisionit të Venecias për Stabilitetin e Ligjit Zgjedhor të vitit 2024 thotë se "Në fushën zgjedhore, siguri juridike do të thotë që besimi tek zgjedhjet demokratike në përputhje me standardet ndërkombëtare nuk duhet të cenohet nga ndryshimet e vonuara në aktet ligjore dhe nënligjore, duke përfshirë edhe nga organet zgjedhore."

¹⁶ Ndryshimet në ligjin zgjedhor në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e votave me postë u miratuan vetëm në shkurt 2025, tre muaj para zgjedhjeve. Më pas, KQZ-ja miratoi disa akte nënligjore në lidhje me votimin jashtë vendit, kurse disa edhe më vonë (dy akte nënligjore u miratuan në mars 2025).

¹⁷ Me ligj, numërohen fletët e votimit që kanë vulën e hyrjes ose informacion gjurmues që konfirmon mbërritjen e tyre në Shqipëri brenda afatit. Dërgimi i fletëve të votimit u bë përmes DHL-së, e cila u përzgjedh si ofruesi i këtij shërimi përmes procedurës së duhur të prokurimit nga KQZ-ja.

aksesueshme për zgjedhësit dhe aktiviteti i saj u transmetua drejtpërdrejt në kohë reale. Gjithashtu, zgjedhësit nga diaspora patën mundësinë që, nëse nuk u kishte ardhur fleta e votimit, të interesoheshin duke kontaktuar KQZ-në. Në përgjithësi, KQZ-ja arriti ta organizojë VJV-në brenda afateve shumë të shkurtra, pavarësisht nga disa vonesa të raportuara në mbërritjen e fletëve të votimit në disa vende, disa raste të izoluara, ku zgjedhësve nuk u mbërriti fleta e votimit ose u mbërritën dy fletë votimi dhe etiketa e adresës e printuar dy herë.

KQZ-ja trajnoi 36,000 anëtarë të administratës zgjedhore përmes një programi trajnimi kaskadë.¹⁸ Megjithatë trajnerët ishin përgjithësisht të përgatitur, në seancat e vëzhguara nga Vëzhguesit Afatgjatë (VAGJ) të MVZ-së së ODIHR-it, u pa se nuk kishte një metodologji të standardizuar dhe, në disa raste, nuk kishte materiale trajnimi të mjaftueshme. Ajo që është pozitive për t'u theksuar është se KQZ-ja ndërmoi një fushatë gjithëpërfshirëse për edukimin e zgjedhësve në rrjetet sociale, radio-televizion, duke përfshirë edhe lidhur me VJV-në, pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara. KQZ-ja përdori formate të aksesueshme si interpretimin në gjuhën e shenjave për spotet televizive dhe ofroi informacione në alfabetin *Braille*. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime lidhur me mungesën e edukimit të drejtpërdrejtë të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, si dhe për mosinformimin e komunitetit rom lidhur me sistemin e ri zgjedhor dhe për mënyrën se si duhet të bëhej shënimi te fleta e votimit, duke e kufizuar, me gjasë, aftësinë e disa zgjedhësve për të votuar në mënyrë korrekte dhe të pavarur.¹⁹

KZAZ-të janë përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve në zonat e tyre përkatëse, emërimin e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve, si dhe të stafit që bën nxjerrjen e rezultateve.²⁰ KZAZ-të dhe zyrtarët zgjedhorë të niveleve më të ulëta emërohen nga partitë politike, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për të lejuar emërimin e komisionerëve zgjedhorë në mënyrë jopartiake.²¹ KZAZ-të vepruan në mënyrë profesionale dhe organizuan takime të vazhdueshme të hapura për publikun. MVZ-ja e ODIHR-it vuri re se KZAZ-të, në pjesën më të madhe të tyre, përbëheshin nga anëtarë me përvojë që kishin shërbyer edhe në zgjedhje të mëparshme.²²

Deri më 7 maj, partitë politike tërhoqën ose zëvendësuan më shumë se 209 anëtarë të KZAZ-ve nga 744 gjithsej (28 për qind), por në ditët para ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se kishte pasur edhe deri dyqind zëvendësime të tjera.²³ Në shumicën e rasteve, partitë i zëvendësuan anëtarët e tyre në KZAZ në diskrecionin e vet; megjithatë, PD-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se disa prej anëtarëve të tyre ishin ndryshuar për shkak të kërcënimeve që PD-ja pretendoi se kishin pasur.²⁴ Disa KZAZ informuan vëzhguesit afatgjatë të ODIHR-it se zëvendësimi i një numri të madh anëtarësh kishte krijuar probleme, por që kjo nuk kishte ndikuar në përgatitjet e përgjithshme.²⁵ KZAZ-të e plotësuan kuotën e kërkuar gjinore prej 30 për qind për gjininë më pak të përfaqësuar, ku gratë përbënin 31 për qind të anëtarëve; megjithatë, numri i grave në role drejtuese ishte i kufizuar, gjë që tregon natyrën minimaliste të përmbushjes së këtij detyrimi ligjor.²⁶ KZAZ-të u përballën me disa sfida në

¹⁸ Katër trajnerët kryesorë dhe 76 trajnerë rajonalë përdorën një kombinim të stilit të mësimdhënies në formë leksioni dhe seancave ndëraktive.

¹⁹ Mungesë informimi e zgjedhësve nga komunitetet e pakicave u vu re në bashkitë Elbasan, Berat dhe Lezhë.

²⁰ Sipas KQZ-së, u ngritën 18 qendra të posaçme votimi, 16 në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe dy në shtëpi të moshuarish.

²¹ U emëruan 741 anëtarë të KZAZ-ve gjithsej: 279 nga PD-ja, 279 nga PS-ja, 93 nga PSD-ja, dhe 90 nga PL-ja.

²² Nga anëtarët aktualë të KZAZ-ve, 57 për qind kanë shërbyer në zgjedhje të mëparshme, 251 anëtarë shërbyen për herë të parë në këto zgjedhje.

²³ Kjo bie në kundërshtim me Seksionin II.3.1.f të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të vitit 2002, i cili përcakton se "organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të kenë lirinë për t'i shkarkuar ata sipas dëshirës".

²⁴ Për shembull, PD-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se 20 staf të KQV-ve në Njësinë 8 në Tiranë janë tërhequr për shkak të presionit.

²⁵ Shumë anëtarë zëvendësues kishin shërbyer në zgjedhje të mëparshme si anëtarë të KQV-ve ose GNV-ve.

²⁶ Nga të gjithë kryetarët, zëvendëskryetarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, 26.5 për qind janë gra.

finalizimin e përbërjes së KQV-ve në disa zona të largëta dhe në kontraktimin e personelit të nevojshëm, kryesisht për shkak të numrit të pamjaftueshëm të anëtarëve të emëruar kryesisht nga PD-ja, PSD-ja dhe PL-ja.²⁷

Sipas ligjit, zgjedhësit në vend mund të votojnë vetëm duke u paraqitur fizikisht në qendrën e votimit, kurse votimi në shtëpi nuk lejohet. Personat më aftësi të kufizuar mund të kërkojnë ndihmë nga një familjar ose nga një zgjedhës tjetër në qendrën e votimit.²⁸ KQZ-ja ofroi fletë votimi të printuara me relief për personat që kanë dëmtime të shikimit dhe dhoma të fshehta votimi të aksesueshme në të gjitha qendrat e votimit për të mundësuar votimin në mënyrë të pavarur. KQZ-ja punoi për të përmirësuar aksesueshmërinë e qendrave të votimit, duke i udhëzuar KZAZ-të që të merrnin masa për të vendosur rampa dhe shenja treguese në hyrje të qendrave të votimit, pa pengesa fizike për zgjedhësit, si dhe trajnoi personelin e KZAZ-ve dhe KQV-ve lidhur me ndihmën për zgjedhësit me aftësi të kufizuar. Korniza ligjore nuk parashikon votimin me postë për personat e shtruar në spital, personat që nuk mund të dalin nga shtëpia ose personat me mundësi të kufizuara lëvizjeje, një çështje që u ngrit nga disa bashkëbisedues të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ).

Përdorimi i teknologjisë në zgjedhje

Sikurse edhe në zgjedhjet e mëparshme, identifikimi biometrik i zgjedhësve u përdor në të gjitha qendrat e votimit.²⁹ Megjithatë shumica e zgjedhësve votuan në letër, votimi dhe numërimi elektronik i votave vazhdoi të pilotohet në dy zona. Kodi Zgjedhor kërkon që pilotimi i votimit të mbulojë jo më pak se 10 për qind të zgjedhësve. Megjithatë, pas një ngërçi politik mbi këtë çështje dhe një kërkesë nga PD-ja, Komisioni Rregullator i KQZ-së sanksionoi përdorimin e dy pilotimeve që përfshiu vetëm 1.4 për qind të numrit total të zgjedhësve të regjistruar, në kundërshtim me ligjin.³⁰ Secila KQV u pajis me dy pajisje me ekran me prekje, një për secilën fletë votimi dhe pas votimit, secila pajisje printonte një fletushkë që zgjedhësi mund ta shihte përmes një dritareje transparente para se fletushka e printuar të binte në një kuti të vulosur.³¹ Pas mbylljes së qendrës së votimit, secila pajisje numëron votat, i transferon rezultatet elektronikisht dhe printon një raport. Më pas, 10 për qind e kutive të votimit rinumërohen manualisht. KQZ-ja organizoi demonstrime të votimit elektronik në rrugë për të rritur ndërgjegjësimin e zgjedhësve, por, nga vlerësimet e MVZ-së së ODIHR-it, këto demonstrime nuk u dukën të ishin edhe aq proaktive.³² Partitë politike dhe media patën mundësinë t'i vëzhgonin këto demonstrime dhe të testonin funksionet e ndryshme të pajisjeve të identifikimit dhe votimit elektronik. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-

²⁷ Në rastet kur partitë nuk mund të propozojnë staf të mjaftueshëm për KQV-të, i emëron KQZ-ja nga një listë rekrutimi. Më 7 maj, KQZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se ishin konstituuar vetëm 80 për qind e KQV-ve.

²⁸ KQZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se kishte regjistruar rreth 26,000 persona me aftësi të kufizuar, në bazë të të dhënave të siguruar nga bashkitë.

²⁹ Çdo qendër votimi ka një pajisje të palidhur me internetin (*offline*) që përmban listën e zgjedhësve të të gjitha qendrave të votimit. Zgjedhësit identifikohen përmes skanimit të dokumentit biometrik të identitetit, të dhënat e kartës së identitetit krahasohen me ato në këtë pajisje. Për t'u verifikuar me sy, printohet një fletë letrë me informacionin dhe foton e zgjedhësit dhe në vend të firmës skanohen shenjat e gishtave.

³⁰ Kodi Zgjedhor kërkon futjen në përdorim me faza të TIK përmes pilotimeve që mbulojnë jo më pak se 10 për qind të zgjedhësve. Pilotimi i vitit 2025 mbuloi 75 KQV me 51,505 zgjedhës të regjistruar, (31 QV me 22,290 zgjedhës të regjistruar gjithsej në Tiranë, 44 me 29,215 zgjedhës në Vorë). Kjo krahasohet me 23,597 zgjedhës të regjistruar (32 KQV në Tiranë) në 2021-shin dhe 310,846 zgjedhës (401 QV në Elbasan, Kamëz, Vorë) në zgjedhjet vendore të 2023-shit.

³¹ Zgjedhësit patën mundësinë ta linin fletën e votimit bosh dhe mund të rivotonin një herë (në këtë rast, fleta e parë e votimit printohet si votë e pavlefshme). Kishte edhe fletë votimi për rast emergjence, por ato nuk u përdorën paralelisht.

³² Duke marrë parasysh ankesat në të shkuarën lidhur me kërkesat e zgjedhësve për ndihmë në ditën e zgjedhjeve dhe interesin e pakët për demonstrimet në QV, u kryen demonstrime të përditshme në pesë rrugë të zonës së votimit elektronik për dy javë.

it shprehën përgjithësisht besim tek teknologjia, por pati edhe shqetësime në lidhje me mungesën e besimit, sidomos nga opozita.³³

Përpara zgjedhjeve parlamentare të 2021-shit, KQZ-ja prokuroi pajisjet e identifikimit biometrik për të gjitha qendrat e votimit dhe më shumë se 800 pajisje për votimin dhe numërimin elektronik të votave përmes tenderëve të hapur ndërkombëtarë.³⁴ KQZ-ja menaxhoi identifikimin biometrik, pilotimin e votimit elektronik dhe disa sisteme informacioni lidhur me zgjedhjet përmes kontraktorëve privatë dhe personelit të KQZ-së, duke u mbështetur në masë të vogël në shërbimet e Teknologjisë së Informacionit të qeverisë.³⁵ Krahasuar me zgjedhje të mëparshme dhe në përputhje me praktikën e mirë zgjedhore, KQZ-ja që më pak e varur nga ofruesi i pajisjeve, i cila në zgjedhjet e mëparshme konfiguronte pajisjet dhe ofronte mbështetje të plotë teknike. Kriteret teknike qenë në përputhje me ligjin dhe përdorimi i teknologjisë u dokumentua si duhet dhe u menaxhua në mënyrë transparente dhe të qëndrueshme.³⁶

Me ligj, zgjedhjet konsiderohen infrastrukturë informacioni e rëndësishë së veçantë.³⁷ Konkretisht, KQZ-ja i është nënshtruar certifikimit për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit.³⁸ Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike mbështeti KQZ-në me testime të sigurisë, vlerësime teknike dhe rekomandime për përmirësim, duke u fokusuar veçanërisht në vitin 2025 tek siguria e platformave të regjistrimit OCV dhe të dhënave personale të zgjedhësve nga diaspora. Megjithatë disa institucione kanë qenë në shënjestër të disa sulmeve kibernetike të motivuara politikisht vitet e fundit, bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it nuk raportuan ndonjë shqetësim lidhur me ndërhyrjet kibernetike nga jashtë vendit në këto zgjedhje.

Kodi Zgjedhor nuk parashikon ndonjë detyrim për auditim apo certifikim të pavarur të teknologjisë. Megjithatë, përveç testeve të brendshme, nga një kontraktor u bënë edhe testimet e sigurisë së serverëve të KQZ-së, faqes së saj të internetit dhe pajisjeve të identifikimit biometrik dhe votimit elektronik, në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Përveç informacionit në tenderët publikë, KQZ-ja nuk bëri publike informacione të tjera në lidhje me testimet e sigurisë. Megjithatë është e kuptueshme që KQZ-ja të mos nxjerrë informacione të ndjeshme lidhur me sigurinë, ajo nuk komunikoi në mënyrë transparente qëllimin, metodologjinë dhe një përmbledhje të rezultateve të këtyre testeve.

Regjistrimi i zgjedhësve

Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtën e votës. Shtetasit që me vendim gjykatë janë shpallur të paafte ligjërisht nuk kanë të drejtë të votojnë, çka bie

³³ Gjatë testimit funksional të pajisjeve të verifikimit të zgjedhësve më 28 prill, aktivisti politik Altin Goxhaj ngriti pikëpyetje rreth besueshmërisë së tyre. KQZ-ja deklaroi në vitin 2024 se PD-ja vazhdon të jetë skeptike dhe se duhet të bjerë dakord para zgjerimit të përdorimit të tyre. Në vitin 2023, Kryetari i PD-së denoncoi pilotimin si “një manipulim monstruo, të gatuar dixhitalisht.”

³⁴ *Smartmatic* fitoi tenderat e hapur për të dyja pajisjet në vitin 2021. Në vitin 2025, kjo kompani kishte për detyrë vetëm përditësimin e programit kompjuterik (software) dhe mbështetjen e KQZ-së gjatë periudhës zgjedhore.

³⁵ KQZ-ja ofron menaxhimin e teknologjisë dhe logjistikën, mbështetjet teknike, rekruton dhe trajnon operatorët e pajisjeve dhe menaxhon infrastrukturën e vet.

³⁶ MVZ-ja e ODIHR-it shqyrtoi raportet e testimit dhe certifikimit, kriteret e pajisjeve dhe dokumentet e prokurimit. Partitë politike dhe publiku kanë akses në dokumentet ku përshkruhet hollësisht teknologjia e përdorur, si dhe procesi i prokurimit dhe menaxhimit.

³⁷ Detyrimet e parashikuara në Ligjin për Sigurinë Kibernetike të vitit 2024, ku përcaktohen institucionet e pavarura si institucionet me infrastrukturë informacioni kritike fokusohen në raportimin tek Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike.

³⁸ Certifikimi ISO27001 bazohet në auditimin e pavarur të kontrolleve të sigurisë së informacionit, dokumenteve dhe proceseve. Në të nuk përfshihet vlerësimi teknik apo testimi.

ndesh me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar.³⁹ Shtetasit që janë duke vuajtur një dënim me burg për kryerjen e veprave të caktuara penale nuk kanë të drejtë të votojnë.⁴⁰

Regjistrimi i zgjedhësve për të votuar brenda vendit bëhet në mënyrë pasive, duke u bazuar tek regjistri i gjendjes civile. Në përgjithësi, regjistrimi i zgjedhësve ishte transparent, dhe aktorët e ndryshëm zgjedhorë patën besim tek gjithëpërfshirja dhe saktësia e përgjithshme e listave të zgjedhësve. Megjithatë, për të siguruar saktësinë e listave të zgjedhësve dhe për të kufizuar në lista numrin e personave që nuk jetojnë më, zgjedhësit që kanë mbushur moshën 100 vjeç hiqen automatikisht nga listat dhe që të futen përsëri duhet të konfirmojnë statusin e tyre, gjë që mund të përbëjë një barrë të panevojshme për këta zgjedhës. Përveç kësaj, zgjedhësit mund të hiqen nga regjistri kombëtar vetëm në rast vdekjeje ose me kërkesën e tyre.

Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të kërkojnë kopjen e plotë të listës së zgjedhësve, gjë që rriti transparencën e procesit të regjistrimit të zgjedhësve, pavarësisht nga shqetësimet që kjo mund të ngrejë lidhur me privatësinë e të dhënave.⁴¹ Zgjedhësve iu dhanë mundësi të mjaftueshme deri në ditën e zgjedhjeve për të rishikuar informacionet e tyre në listën e zgjedhësve, si fizikisht ashtu edhe online.⁴² Siç e kërkon ligji, KQZ-ja emëroi dy auditues për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve si për zgjedhësit brenda, ashtu edhe për zgjedhësit jashtë vendit. Audituesit rishikuan çdo muaj caktimin e zgjedhësve në qendra votimi, duke filluar gjashtë muaj para ditës së zgjedhjeve dhe raportuan se ky proces u menaxhua me sukses. KQZ-ja publikoi më 2 prill listat përfundimtare të zgjedhësve me 3,713,761 zgjedhës të regjistruar, duke përfshirë edhe zgjedhësit që jetonin jashtë vendit.⁴³

Zgjedhësit që kanë të drejtë vote dhe që kanë një leje zyrtare qëndrimi jashtë vendit, mund të regjistrohen për VJV. Pas një fushate të gjerë informimi të zgjedhësve që kishte në fokus diasporën, KQZ-ja bëri regjistrimin e zgjedhësve nga 11 janari deri në 4 mars. Zgjedhësit duhet të ngarkonin dokumentin e tyre biometrik të identitetit të lëshuar pas 2009-ës, lejen e qëndrimit të lëshuar nga një autoritet në vendin e qëndrimit dhe një dokument që vërtetonte adresën e vendbanimit, që mund të ishte një faturë shërbimesh ose një deklaratë bankare në rast se adresa nuk shënohej në lejen e qëndrimit.⁴⁴ Fillimisht, KQZ-ja kërkoj dokumente shqiptare identiteti të vlefshme, por e ndryshoi më pas këtë vendim me qëllim që t'u jepte mundësinë të regjistroheshin edhe personave, dokumenteve të identitetit të cilëve u kishte mbaruar afati.⁴⁵ Lista përfundimtare e zgjedhësve jashtë vendit u publikua më 11 mars, me 245,935 zgjedhës nga 85 vende.⁴⁶ Rreth 41,000 persona që kishin kërkuar të regjistroheshin

³⁹ Nenet 12 dhe 29 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) të vitit 2006 kërkon që shtetet palë t'u "garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si të tjerët". Shih gjithashtu paragrafin 48 të Komentit të Përgjithshëm Nr. 1 të nenit 12 të CRPD-së.

⁴⁰ Në përputhje me nenin 45 të Kushtetutës, Ligji për Dekriminalizimin ia mohon të drejtën e votës personave që janë duke vuajtur një dënim me burg për kryerje të disa veprave të caktuara penale të parashikuara në më shumë se 80 nene të Kodit Penal (që variojnë nga veprat penale zgjedhore deri te krimet e rënda).

⁴¹ Paragrafi 4.1.3. i Udhëzimeve të Këshillit të Evropës të vitit 2024 mbi mbrojtjen e individit sa i përket përpunimit të dhënave personale "Në përputhje me parimin e minimizimit të të dhënave, të dhënat e përpunuara në regjistrat e zgjedhësve dhe listat e zgjedhësve duhet të kufizohen në ato të dhëna që janë të domosdoshme për regjistrimin dhe autentifikimin e zgjedhësve".

⁴² Megjithatë kërkesa mund të merret maksimumi 24 orë para ditës së zgjedhjeve, gjykata duhet të marrë vendim jo më vonë se 6 orë para mbylljes së votimit.

⁴³ Sipas censusit të vitit 2023 të Institutit të Statistikës (INSTAT), numri i personave që jetojnë në Shqipëri ka rënë në 2.4 milion nga 2.8 në 2011-ën.

⁴⁴ Vendbanimi i fundit i zgjedhësit në Shqipëri, sipas të cilit zgjedhësit i caktohet zona zgjedhore, merret nga regjistri kombëtar i gjendjes civile.

⁴⁵ KQZ-ja mori disa pyetje nga zgjedhësit jashtë vendit në lidhje me dokumentet biometrike shqiptare të identitetit, të cilave u kishte kaluar afati, gjë që bëri që qeveria të vendoste më 5 shkurt që të lejonte përdorimin e dokumente të identitetit të cilave u kishte kaluar afati i vlefshmërisë.

⁴⁶ Grupet më të mëdha të zgjedhësve të regjistruar jashtë vendit janë në Itali, me 91,223 zgjedhës (37.1 për qind), dhe Greqi, 68,386 zgjedhës (27.8 për qind). Ndër të tjerë, ka edhe grupe të mëdha zgjedhësish në Gjermani 25,499 (10.4 për qind), Shtetet e Bashkuara 20,653 (8.4 për qind) dhe në Mbretërinë e Bashkuar 17,227 (7 për qind).

u refuzuan kryesisht për shkak të mosparaqitjes së një lejeje zyrtare qëndrimi ose një dokumenti që vërtetonte adresën e tyre në vendin ku jetonin, siç ishte përcaktuar nga KQZ-ja.

Ligji kërkon që zgjedhësit me të drejtë vote, për të votuar, duhet të paraqesin një pasaportë biometrike ose një kartë identiteti të vlefshme. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm shtetasish, disa prej të cilëve banojnë dhe votojnë brenda vendit, kanë dokumente identifikimi të cilave u ka mbaruar afati, një çështje që është vërejtur edhe në zgjedhje të mëparshme.⁴⁷ Më 7 maj, Këshilli i Ministrave zgjati vlefshmërinë e të gjitha dokumenteve biometrike të identifikimit deri më 31 maj, duke u mundësuar kështu zgjedhësve të prekur nga kjo çështje që të votojnë.

Regjistrimi i kandidatëve

Të drejtën për të kandiduar në zgjedhje e ka çdo zgjedhës me të drejtë vote, përveç atyre që janë duke vuajtur një dënim me burg në bazë të një vendimi gjykatë të formës së prerë për kryerjen e veprave të caktuara penale.⁴⁸ Gjithashtu, në Kushtetutë përcaktohen disa kategori zyrtarësh, pozicionet e të cilëve konsiderohen se bien ndesh me të drejtën për të kandiduar në zgjedhje.⁴⁹

Kandidatët mund të caktohen nga parti dhe koalicione që janë regjistruar në KQZ si subjekte zgjedhore ose mund të garojnë si të pavarur. KQZ-ja i regjistroi të teta partitë politike dhe tre koalicionet që paraqitën dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të 12 marsit.⁵⁰ Nga këta, vetëm një prej tyre, Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare, drejtohet nga një grua. Partitë dhe koalicionet ishin të detyruara të paraqisnin dy lloje listash kandidatësh, një listë të mbyllur me renditje të paracaktuar të kandidatëve dhe një listë më vete për votim preferencial, ku kandidatët renditën sipas rendit alfabetik. Kandidatët nuk mund të vendosen në disa zona zgjedhore njëherësh apo në të dyja llojet e listave. Në përputhje me një rekomandim të mëhershëm të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, u hoq mundësia që drejtuesit e partive të konkurronin në disa zona zgjedhore. Disa parti më të vogla dhe disa parti të pakicave e informuan MVZ-në e ODIHR-it se e kishin pasur të vështirë të identifikonin një numër të mjaftueshëm kandidatësh në të gjitha zonat. Megjithatë mosparaqitja e një numri të mjaftueshëm kandidatësh në një zonë mund të çojë në mosregjistrimin si subjekt zgjedhor, të njëmbëdhjetë subjektet zgjedhore dorëzuan dokumentacionin e kërkuar ligjor dhe u regjistruan. Në përgjithësi, bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it nuk ngritën shqetësime lidhur me procesin e regjistrimit.

KQZ-ja regjistroi 2,046 kandidatë në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kodi Zgjedhor kërkon që një në çdo tre kandidatë në të dyja listat të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Në total, 787 (38.47 për qind) ishin gra, që është shumë pak mbi minimumin ligjor, megjithatë të gjitha listat e kandidatëve qenë në përmbushje të detyrimit të parashikuar me ligj. Në këto zgjedhje nuk u paraqit për regjistrim asnjë kandidat i pavarur. Gjatë verifikimit të kandidatëve, KQZ-ja hoqi 16 kandidatë nga listat e partive të ndryshme, që të gjitha të bazuara në informacione të dhëna në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve në lidhje me rekordet e tyre kriminale dhe të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

⁴⁷ Sipas MPB-së, më 11 maj, 360,809 shqiptarë kishin karta identiteti biometrike të skaduar dhe 550,633 pasaporta biometrike të skaduar.

⁴⁸ Ligji për Dekriminalizimin i referohet deportimit nga Shtetet Anëtare të BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara. Shtetasit e dënuar për vepra të caktuara penale ose të deportuar nga këto shtete, madje edhe në mungesë të një vendimi gjykatë të formës së prerë, nuk lejohen të kandidojnë për zgjedhje, ashtu sikurse edhe ata që janë objekt i një urdhri kërkimi ndërkombëtar.

⁴⁹ Presidenti, gjykatësit, prokurorët, ushtarakët dhe oficerët e sigurisë kombëtare, oficerët e policisë, diplomatët, kryetarët e bashkive, prefektët, anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe disa zyrtarë të caktuar të administratës shtetërore.

⁵⁰ Koalicioni "Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore" (PD-ASHM), Partia "Lëvizja Bashkë", "Lëvizja Atdheu", Partia e "Koalicioni Euro-Atlantik" (KEA), Partia Socialiste Shqiptërisë, Koalicioni "Shqipëria Bëhet – Iniciativa Adriatik Lapaj", Partia "Aleanca Shqiptare Kombëtare", Partia "Aleanca e Re për Demokraci", Koalicioni "Djathtas për Zhvillim", Partia "Mundësia", Partia Social Demokrate.

Partitë e prekura nuk u ankuan kundër këtyre vendimeve dhe patën mundësinë të paraqisnin kandidatë të tjerë për zëvendësimin e tyre.

Mjedisi i fushatës

Fushata zyrtare filloi më 11 prill dhe vazhdoi deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Fushata ishte në përgjithësi e qetë, e fokusuar në aktivitete të vogla me pjesëmarrje fizike, vizita derë më derë dhe postime në rrjetet sociale.⁵¹ PS-ja dhe PD-ja organizuan disa aktivitete më të mëdha, bashkë me një numër të kufizuar tubimesh nga partitë më të vogla. Disa nga çështjet që u ngritën gjatë fushatës përfshinin sigurimin e anëtarësimit në BE, zhvillimin ekonomik, luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e institucioneve demokratike. Toni i fushatës ishte shpesh konfrontues, me sulme personale midis dy partive kryesore dhe drejtuesve të tyre.⁵² PS-ja synonte të diskreditonte opozitën, kurse PD-ja akuzonte qeverinë për korrupsion dhe për lidhje me grupe të krimit të organizuar.

Megjithëse kandidatët patën përgjithësisht mundësinë të bënin fushatë në mënyrë të lirë dhe zgjedhësit mundësinë të zgjidhnin mes alternativave të ndryshme politike, mundësitë ishin të pabarabarta, në kushtet që partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i burimeve administrative dhe pushteti institucional. Ligji e ndalon përdorimin e burimeve shtetërore për qëllime të fushatave të kandidatëve në zgjedhje, por i lejon ata që bëjnë fushatë që të kryejnë detyrat e tyre zyrtare gjatë fushatës. Konkretisht, pak kohë para periudhës së fushatës dhe gjatë saj, ministrat dhe Kryeministri u angazhuan në aktivitete zyrtare, bënë inspektime të disa objekteve, promovuan disa investime dhe projekte infrastrukturore, duke kontribuar në përgjithësi në avantazh të partisë në pushtet dhe, hera-herës, duke bërë fushatë haptazi.⁵³

Me ligj, për katër muaj para ditës së zgjedhjeve, nuk lejohet propozimi apo miratimi i asnjë akti ligjor, nga i cili përfitojnë segmente specifike të popullsisë. Megjithëse ligji formalisht u respektua, disa politika të miratuara para kësaj periudhe çuan në përfitime për disa grupe zgjedhësish gjatë periudhës zgjedhore dhe po gjatë kësaj periudhe u mbajtën disa aktivitete me përmasa të mëdha.⁵⁴ Më 9 maj, me qëllimin, në dukje, që të ndikonte tek zgjedhësit, qeveria vendosi të falte gjrobat për ndërtime pa leje, shkelje të kufizimeve të vendosura lidhur me COVID-19, si dhe gjoba të vendosura fermerëve dhe blegtorëve në periudhën 2015-2024. Përveç kësaj, institucionet publike dhe organet shtetërore janë të detyruara të raportojnë në KQZ çdo aktivitet publik për katër muajt para ditës së zgjedhjeve, të cilat KQZ-ja mund të vendosë t'i ndalojë si shpërdorim të mundshëm të burimeve shtetërore. Nga 4,522

⁵¹ MVZ-ja e ODIHR-it vëzhgoi 44 aktivitete fushate, nga të cilat 69 nxirrnin në pah folëse gra. 67 e këtyre aktiviteteve ishin të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, por në asnjë prej tyre nuk pati përkthim në gjuhën e shenjave.

⁵² Më 14 prill, Zëvendëskryeministria Belinda Balluku postoi, duke iu referuar PD-së: “Vjedhin, vrasin, shpifin e mallkojnë”; Më 23 prill, z. Berisha deklaroi, duke iu referuar aleatëve të Ramës: “Soji juaj do të shpallet terrorist vend në tokë nuk do të ketë për ju”; më 24 prill, z. Berisha akuzoi z. Rama dhe znj. Balluku për orkestrimin e një “gllabërimi mafioz toke”. Agron Shehaj, drejtuesi i Partisë Mundësia akuzoi Adriatik Lapajn, drejtuesin e Lëvizjes Shqipëria Bëhet, për përfitime përmes marrëveshjeve të brendshme në kapacitetin e tij si avokat. Në përgjigje të këtyre akuzave, sipas raportimeve mediatike, z. Lapaj depozitoi një padë për shpifje.

⁵³ Për shembull, më 18 prill, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale promovoi investimin e qeverisë në Spitalin Rajonal të Lezhës; më 19 prill, Kryeministri, Zëvendëskryeministria dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë prezantoi projektin e ri të gazifikimit në qytetin e Korçës. Më 28 prill, Ministri i Brendshëm prezantoi një projekt të ri për prodhimin e njetëve ushtarake. Gjithashtu, Kryeministri bëri një tur të Spitalit të saporinovuar Bashkiak të Mirditës më 18 prill, Spitalit Psikiatrik në Vlorë më 27 prill, kantierit të ndërtimit të një shkolle të re në Tiranë më 28 prill, prezantoi ndërtimin e një godine të teknologjisë modern në Shkozë më 28 prill, dhe promovoi investimet në rajonin e Gjirokastrës më 3 maj.

⁵⁴ Një Vendim i Këshillit të Ministrave të 9 janarit o ofroi pensionistëve në Shqipëri një bonus në pranverë bashkë me pensionin e tyre mujor. Shpërndarja e pagesës prej 10,000 lekësh (afërsisht 100 euro) ose 5,000 lekësh (50 euro), në varësi të nivelit të pensionit, filloi më 1 mars. Projektet e buxhetuara nga bashkitë në vitin 2024 që filluan fill para zgjedhjeve ose gjatë fushatës zgjedhore përfshinin: punime rrugësh në Durrës, Himarë, dhe Librazhd; ftesë për tender në Himarë, Mat, Roskovec, dhe Shkodër; dhe subvencione në Lezhë, Klos, dhe Tirana. Aktivitetet e mëdha ose me shumë vizibilitet përfshinin aktivitete si Panairin e Turizmit të muajit mars në Berlin, ku morën pjesë disa ministra dhe Kryeministri dhe që u raportua gjerësisht, si dhe segmentin shqiptar të ciklizmit *Giro d'Italia* që ishte planifikuar të zhvillohej nga 9 deri në 11 maj, që përkoj me heshtjen zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

aktivitetet zyrtare të regjistruara gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja ndaloj vetëm 18 si aktivitete që kishin të bënin me shpërdorimin e burimeve shtetërore, duke ngritur dyshime rreth kapacitetit të saj për shqyrtimin e të gjitha aktiviteteve të raportuara dhe qasjes së saj të ngushtë në interpretimin e ligjit në këtë aspekt. Megjithatë shumica e këtyre aktiviteteve ishin formalisht në përputhje me dispozitat ligjore, numri i madh i tyre i dha mundësi partisë në pushtet t'i shfrytëzonte për qëllime fushate, sidomos në zonat ku zyrtarë të lartë të qeverisë shërbyen si koordinatorë të PS-së.⁵⁵ Përdorimi i gjerë i këtyre aktiviteteve publike për qëllime zgjedhore, përforcoi edhe më shumë avantazhin e padrejtë të partisë në pushtet, dhe e megjulloi vijën ndarëse mes shtetit dhe partisë, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990.⁵⁶

KQZ-ja mund t'i hetojë shkeljet administrative lidhur me zgjedhjet *ex officio* ose në bazë të ankesave të paraqitura online ose nga çdo palë e interesuar. Nga 139 ankesa të tilla të marra nga KQZ-ja, një pjesë e konsiderueshme kishin të bënin me burimet shtetërore, shtrimin e rrugëve, partneritetet e ndaluara publik-privat dhe fillimin e dhënies së asistencës sociale, subvencioneve dhe tenderët e prokurimit publik, të bëra në lidhje me titullarët e institucioneve publike, kryetarët e bashkive dhe ministrat. Në shumicën e vendimeve të marra deri më 9 maj për këto çështje, KQZ-ja konstatoi se, duke qenë se buxhetet ishin caktuar që përpara se të fillonte periudha katër-mujore, këto masa nuk përbënin shkelje të ligjit, dhe në 37 raste, KQZ-ja nuk nisi hetim administrativ. Në total, KQZ-ja mori vendim vetëm për 118 të ankesave deri në ditën e zgjedhjeve. Mungesa e një procedure të përsheptuar për shqyrtimin e ankesave ngre shqetësime për eficientësinë e sistemit aktual të hetimit dhe vendimmarrjes në lidhje me kundërvajtje administrative nga KQZ-ja lidhur me zgjedhjet.

Në MVZ-në e ODIHR-it mbërritën disa pretendime dhe raportime, sipas të cilave punonjësve të bashkive u bëhej presion nga eprorët për të marrë pjesë ose për të mbështetur fushatën e PS-së.⁵⁷ Megjithatë PS-ja organizoi një sërë aktivitete fushate që kishin në qendër gratë, edhe në këto aktivitete u ngritën shqetësime se disa nga pjesëmarrësit ishin aty, sepse ishin udhëzuar nga punëdhënësit e tyre në sektorin publik që të merrnin pjesë.⁵⁸ Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime rreth ndikimit të rrjeteve të patronazhimit në të gjithë vendin, duke pretenduar se për të siguruar vota, ata përdornin si mjet premtimet për punësim në sektorin publik, favore administrative dhe leje të ndryshme. MVZ-së së ODIHR-it iu raportuan edhe raste zgjedhësish që pretendonin se kishin frikë nga hakmarrja nëse shiheshin në aktivitete të partive opozitare dhe raste të intimidimit të kandidatëve të opozitës dhe të disa kandidatëve të partisë në pushtet.⁵⁹ Disa bashkëbisedues u shprehën se veçanërisht të prekshme nga presioni i ushtruar nga administrata publike

⁵⁵ Numri më i madh i aktiviteteve ishin në bashkitë e qarkut të Fierit, ku Zëvendëskryeministrja ishte drejtuese politike e PS-së. një numër i madh aktiviteteve u regjistrua edhe në Lezhë, drejtuar nga Ministri i Drejtësisë dhe në Gjirokastrë, drejtuar nga Ministri i Turizmit. Në bashkitë e drejtuara nga opozita nuk pati fare aktivitete ose një numër i kufizuar aktiviteteve të tilla.

⁵⁶ Në paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan për një "ndarje të qartë mes shtetit dhe partive politike".

⁵⁷ Pretendime dhe raporte të dorës së parë për presion ndaj punonjësve të bashkive nga eprorët për të marrë pjesë në aktivitete të fushatës të PS-së pati në Durrës, Fier, Has, Korçë, Peshkopi, Shkodër, Tiranë, dhe Vlorë. Pretendime për presion ndaj punonjësve të bashkive për të marrë pjesë ose për të mbështetur fushatën e PS-së, duke përfshirë edhe financiarisht, u bënë në Devoll, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Pukë, Shkodër, dhe Tropojë. Akuzat për ushtrim presioni mbi punonjësit e sektorit publik për të dhënë informacion rreth familjarëve ose miqve të tyre që jetojnë jashtë shtetit u ngritën në Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë. Më 7 maj në Elbasan, gjatë tubimit përmbyllës të Partisë Demokratike, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it u informua nga zyrtarët e partisë se pjesëmarrësit ishin dërguar me autobuzë nga komunat përreth Cërrikut dhe Belshit.

⁵⁸ Në 16 aktivitete të organizuara nga PS-ja për gratë, që u vëzhguan nga MVZ-ja e ODIHR-it, shumica e pjesëmarrësve ishin punonjës të sektorit publik. Në katër prej këtyre aktiviteteve, disa pjesëmarrës e informuan MVZ-në e ODIHR-it se merrnin pjesë në ato aktivitete me udhëzimin e punëdhënësve përkatës.

⁵⁹ Raportime të dorës së parë për kërcënime u bënë në Berat, Durrës, dhe Fier. Pretendime për mosmarrje pjesë në aktivitete të partive opozitare nga frika e hakmarrjes pati në të gjithë vendin, sidomos në Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, dhe Tiranë, ku këto raste u raportuan në mënyrë konkrete dhe të hollësishme. Përveç kësaj, u raportuan akuzat për intimidim të votuesve nga policia në Fier. Më 4 maj, anëtarë të familjes së një kandidati të PS-së u kërcënuan në Lezhë.

për të votuar për PS-në ishin komunitetet e marxhinalizuara. Kjo bie ndesh me standardet ndërkombëtare, sipas të cilave zgjedhësit duhet të jenë të lirë, pa u shtrënguar dhe pa u ndikuar në mënyrë të panevojshme.⁶⁰

Gjatë fushatës u vërejtën disa pretendime për shit-blerje votash dhe në 37 raste nisi hetimi.⁶¹ Një numër bashkëbiseduesish të MVZ-së së ODIHR-it ngritën pretendime për lidhje mes partive politike dhe krimin të organizuar në disa zona, intimidim dhe kërcënim nga ana e grupeve të krimin të organizuar ndaj zgjedhësve dhe, ndonjëherë, edhe ndaj kandidatëve.⁶²

Fushata në rrjetet sociale nuk është e rregulluar shprehimisht dhe nuk ka asnjë autoritet rregullator të ngarkuar me ligj për monitorimin e aktiviteteve të fushatës në rrjetet sociale dhe për të identifikuar rastet e dizinformimit, përmbajtjeve manipuluese apo të shfaqjes së sjelljeve joautentike.⁶³ Megjithatë, KQZ-ja ngriti një njësi të posaçme për monitorimin e llogarive në rrjetet sociale të 50 institucioneve publike gjatë fushatës dhe e trajnoi këtë njësi lidhur me identifikimin e keqinformimit në lidhje me zgjedhjet. Në bazë të këtij monitorimi, nga 11 prilli deri në 9 maj, KQZ-ja konstatoi 10 postime të institucioneve publike që ishin potencialisht në shkelje të ligjit dhe i referoi ato për hetim administrativ. Në disa raste të ngjashme të paraqitura në KQZ në lidhje me përdorimin e llogarive zyrtare të institucioneve publike për fushatë, KQZ-ja zgjodhi të ndalojë hetimet. KQZ-ja bëri disa përpjekje për t'u koordinuar me platformën *Meta*, por kjo nuk çoi në ngritjen e një mekanizmi përmes të cilit KQZ-ja të mund të identifikonte përmbajtje që mund të ishin manipuluese apo që të kërkonte heqjen e përmbajtjeve të caktuara nga kjo platformë.⁶⁴ Fusha e mbulimit dhe efikasiteti në përgjithësi i monitorimit nga KQZ-ja të fushatës *online* mbeti i kufizuar.

Gjatë periudhës zgjedhore, MVZ-ja e ODIHR-it ndoqi aktivitetet e fushatës së 23 llogarive të partive politike, koalicioneve dhe kandidatëve kryesorë në *Facebook* dhe *Instagram*.⁶⁵ Kandidatët u angazhuan në mënyrë aktive në të gjitha këto platforma, duke u fokusuar tek video-mesazhet, duke shpërndarë përmbajtje nga aktivitetet e fushatës, si dhe duke promovuar premtime zgjedhore. Megjithëse shumica e partive politike nënshkruan para fushatës Kodin e Etikës për Fushatat Dixhitale, duke përfshirë edhe PD-në dhe PS-në, disa kandidatë shpërndanë përmbajtje përçarëse, diskriminuese dhe manipuluese.⁶⁶ Disa organizata të shoqërisë civile monitoruan fushatën në rrjetet sociale, duke përfshirë Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Investigative, i cili raportoi disa raste sjelljesh të koordinuara joautentike për të amplifikuar angazhimin në mënyrë artificiale, sidomos të llogarive të palëve të treta që shpërndanin

⁶⁰ Shih paragrafin 19 të Komentit të Përgjithshëm 25 të vitit 1996 deri në nenin 25 të ICCPR-së, ku thuhet se “[p]ersonat me të drejtë vote duhet të jenë të lirë për të votuar për cilindo kandidat [...] dhe për të mbështetur apo kundërshtuar qeverinë, pa ndikimi të panevojshëm dhe pa shtrëngim të asnjë lloji që mund të shtrembërojë ose të pengojë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësit.”

⁶¹ Pretendime specifike për shit-blerje votash u bënë në Elbasan, Korçë, Mirditë, Shkodër, dhe Tiranë.

⁶² Këto pretendime u bënë MVZ-së së ODIHR-it në Durrës, Elbasan, dhe Tiranë, personi i dyshuar si autori u raportua se kishte lidhje me një grup të organizuar kriminal.

⁶³ Para zgjedhjeve, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) zhvilloi një trajnim për KQZ-në në lidhje me metodat e monitorimit të gjuhës së urrejtjes, dizinformimit dhe shpenzimeve në rrjetet sociale. Shih seksionin II.3 të Raportit Shpjegues të Deklaratës Interpretuese të Komisionit të Venecias të vitit 2024 mbi Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, sa i përket teknologjive dixhitale dhe inteligjencës artificiale.

⁶⁴ Në përgatitjet për zgjedhjet, më 16 prill, KQZ-ja organizoi një takim me përfaqësuesit e platformës *Meta*. MVZ-ja e ODIHR-it kontaktoi Meta-n për të diskutuar aktivitetet e saj në lidhje me zgjedhjet e ardhshme, por nuk mori përgjigje.

⁶⁵ KQZ-ja deklaroi se monitoroi llogaritë e kandidatëve në *Facebook* për reklamat e paguara politike.

⁶⁶ Për shembull, Kryeministri Edi Rama bëri një postim nga fushata e tij më 18 prill në Dibër, ku tha: “gjysma e burrave në vend janë çyrykë”. Në një postim nga një takim i datës 22 prill me pensionistët në Gjirokastrë, z. Rama tha: “Nëse duhet të zgjidhni mes BE-së dhe kënetës, dhe ju zgjidhni kënetën, do të thotë se s’je mirë — politikisht, je autik.” Sipas mediave, z. Rama iu referua në mënyrë të përsëritur kundërshtarit të tij, z. Berisha si ‘buf kënete’, dhe drejtuesve të tjerë të opozitës si ‘krijesa të kënetës’. Nga ana tjetër, z. Berisha iu referua z. Rama ai ‘Anti-Krisht’, ‘monstër’, kurse qeverisë si ‘narko-diktaturë’. Z. Rama përdori shpesh video të prodhuara me inteligjencë artificiale, ku vinte në shënjestër z. Berisha.

reklama postime që godisin opozitën, si dhe Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, i cili monitoroi reklamën politike në rrjetet sociale.⁶⁷

Financimi i fushatës

Financimi i fushatës rregullohet kryesisht nga Kodi Zgjedhor dhe ligji për partitë politike. Pavarësisht nga disa ndryshime të kohëve të fundit, që prej 2020-ës nuk ka pasur ndonjë reformë gjithëpërfshirëse. Kuadrit ligjor aktual i mungon efikasiteti dhe mangësitë e tij ndikojnë negativisht në transparencën e financimit të fushatës dhe në barazinë e mundësive për partitë dhe kandidatët.

Partitë politike mund t'i financojnë fushatat e tyre me fonde publike dhe private, duke përfshirë edhe me fondet e veta, hua bankare dhe donacione nga shtetas dhe persona juridikë vendas. Më 21 mars, mjaftueshëm në kohë para fushatës, KQZ-ja shpërndau 131,201,816 lekë (afërsisht 1.3 milion euro) nga fondet publike mes njëmbëdhjetë subjekteve zgjedhore në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të kaluara. Në vitin 2025, kufiri i vetëfinancimit u ngrit nga 1 milion në 3 milion lekë (afërsisht 30,000 euro). Kufiri për donacionet, përfshirë ato në natyrë, është 1 milion lekë (afërsisht 10,000 euro) për donacion, por nuk ka një limit për shumën totale. Vetëm kontributet mbi 50,000 lekë (afërsisht 500 euro) duhet të bëhen përmes një llogarie bankare të dedikuar. Për huatë nuk ka ndonjë kufi specifik dhe as nuk janë të rregulluara me ligj, për shembull, sa i përket detyrimeve për shlyerjen e tyre. Megjithatë kërkohet me ligj, asnjë nga kandidatët nuk publikoi të dhëna për donacionet, huatë apo kreditë e marra, duke e dëmtuar edhe më shumë transparencën; megjithatë, KQZ-ja nuk u kërkoi të ndërmerrnin asnjë veprim, pasi KQZ-ja nuk ka instrumente ligjore për të siguruar përmbushjen e parashikimeve ligjore.

Periodha e rregulluar mbulon shpenzimet e partive politike dhe koalicioneve që nga data kur shpallet zyrtarisht data e zgjedhjeve deri në fund të fushatës, duke përfshirë edhe shpenzimet e bëra para periudhës zyrtare të fushatës. Megjithatë, ligji nuk specifikon qartë se cilat aktivitete parazgjedhore duhet të klasifikohen si shpenzime fushate dhe duhet të jenë objekt i mbikëqyrjes dhe sanksioneve potenciale, çka bie ndesh me praktikën e mira ndërkombëtare.⁶⁸

Kufiri aktual për shpenzimet e një partie apo koalicioni është 326,456,950 lekë (afërsisht 3.3 milion euro).⁶⁹ Ndryshimet ligjore të 2025-ës nuk i përfshinë shpenzimet e kandidatëve në kufirin e shpenzimeve për partitë dhe nuk vendosën një kufi më vete për shpenzimet e kandidatëve. Ky boshllëk ligjor mund të lejojë anashkalimin e kufirit të shpenzimeve nga ana e partive dhe koalicioneve, duke cenuar transparencën dhe llogaridhënien dhe duke krijuar mundësi për një avantazh joproporcional të partive më të mëdha.⁷⁰ Shpenzimet për aktivitetet *online* të fushatës duhet që, parimisht, të përfshihen në shumën e përgjithshme nën kufirin e shpenzimeve dhe të raportohen, duke u nisur nga detyrimi ligjor për raportimin e të gjitha shpenzimeve të mundshme të fushatës. Megjithatë, pavarësisht nga një rekomandim i mëparshëm I ODIHR-it, shpenzimet për fushatat *online*, reklamën politike të paguara në platformat e rrjeteve sociale dhe shpenzimet e palëve të treta nuk janë të rregulluara qartë, gjë që mund

⁶⁷ Shih artikullin e 5 majit në [raportin e BIRN-it](#).

⁶⁸ Paragrafi 262 i Udhëzimeve të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2020 për Rregullimin e Partive Politike "Legjislacioni duhet të ofrojë udhëzimet të qarta në lidhje me cilat aktivitete janë të ndaluara gjatë fushatës parazgjedhore, dhe të ardhurat dhe shpenzimet e përdorura për këto aktivitete gjatë kësaj kohe duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe sanksioneve të duhura."

⁶⁹ Për këto zgjedhje, limitet e shpenzimeve për fushatë u rritën tre deri pesë herë krahasuar me shumën më të madhe të marrë nga një subjekt zgjedhor nga fondet publike.

⁷⁰ Paragrafi 19 i the [Kommentit të Përgjithshëm Nr. 25 të ICCPR-së](#) thotë se "kufizimet e arsyeshme të shpenzimeve të fushatës mund të justifikohen në rastet kur kjo është e nevojshme për të garantuar moscenimin e zgjedhjes së lirë të zgjedhësve ose mosshtrëmbërimin e procesit demokratik nga shpenzimet joproporcionale në emër të cilitdo kandidat apo parti". Paragrafi 248 i [Udhëzimeve të Përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Rregullimin e Partive Politike](#) të vitit 2020 thotë "Është e arsyeshme për një shtet që të përcaktojë kriteret për shpenzimet zgjedhore dhe një kufi për shpenzimet maksimale për pjesëmarrësit në zgjedhje."

të çojë në përdorimin e pakontrolluar të fondeve në fushatë.⁷¹ Këto boshllëqe mund t'i hapin rrugën përdorimit të fondeve të paligjshme dhe të pagjurmueshme, si dhe anashkalimit të rregullave në fuqi.

Kandidatët janë të detyruar të dorëzojnë në KQZ raporte për financimin e fushatës përmes një Platforme elektronike për Raportimin Financiar Brenda 60 ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve. Mungesa e raportit të ndërmjetëm financiar para ditës së zgjedhjeve kufizon transparencën, i privon zgjedhësit nga informimi në kohë dhe bie ndesh me praktikën e mirë zgjedhore ndërkombëtare lidhur me mbikëqyrjen e financimit të fushatës.⁷² Bashkëbisedues të ndryshëm të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime lidhur me disa kufizime teknike të platformës *online* të KQZ-së dhe për disa probleme në kërkimin dhe krahasimin e të dhënave. Disa parti vunë në dukje se kishin marrë trajnim dhe mbështetje të vazhdueshme nga KQZ-ja në lidhje me detyrimet për raportim. Brenda pesë ditësh nga shpallja e rezultateve, KQZ-ja duhet të emërojë audituesit për shqyrtimin e këtyre raporteve. Disa bashkëbisedues të ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me kapacitetin e audituesve për identifikimin e financimeve të paligjshme ose shpenzimeve të padeklaruara, duke përfshirë edhe shpenzimet për fushatën *online*.

Media

Pavarësia, shumëllojshmëria dhe integriteti i lajmeve në dispozicion të zgjedhësve cenohen nga fakti që shumica e mediave varen nga financime jotransparente të interesave politike dhe interesave të biznesit, duke u mbështetur shpesh tek kontratat qeveritare. Përqendrimi i pronësisë së medias e cenon edhe më shumë pluralizmin e burimeve informative, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.⁷³ Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, fakti që disa prej agjencive të rëndësishme të marketingut zotërohen nga interesa politike cenon shpërndarjen e drejtë të të ardhurave nga reklamat, ndërkohë që mungesa e matjeve të besueshme të audiencës nuk lejon shpërndarjen transparente dhe të përgjegjshme të reklamave publike.⁷⁴ Shumica dërmuese e organeve mediatike perceptohen si mbështetëse të PS-së në pushtet.⁷⁵ Transmetuesi publik, Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) nuk konsiderohet se gëzon audiencë të madhe, dhe procedura bipartizane e emërimit të organeve drejtuese si të RTSH-së, ashtu edhe të Autoritetit Audio-vizual Media (AMA) nuk garanton pavarësinë e tyre *de facto*.⁷⁶

⁷¹ Sipas të dhënave nga *Meta Ad Library*, nga 11 prilli deri më 11 maj, partitë, koalicionet dhe kandidatët shpenzuan gjithsej 21,410,830 lekë (217,870 euro) për reklamat politike. "Nga këto, PD shpenzoi 2,746,960 lekë (27,950 euro), Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut 1,173,220 lekë (11,940 euro), Lëvizja Shqipëria Bëhet 490,050 lekë (4,990 euro). Ndër kandidatët, Ilogaria me shpenzimin më të lartë ishte ajo e Agron Shehajt, liderit të Partisë Mundësia, me 1,909,780 lekë (19,430 euro), Belind Këlliçi i PD-së me 763,100 lekë (7,770 euro), dhe Vullnet Sinaj i PS-së me 748,960 lekë (7,620 euro).

⁷² Neni 7.3 i *UNCAC* thotë se shtetet marrin masa "për rritjen e transparencës në financimin e kandidatëve garues". Paragrafi 247 i *Udhëzimeve të Përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Rregullimin e Partive Politike* të vitit 2020 thotë se "Zgjedhësit duhet të kenë informacion relevant lidhur me mbështetjen financiare dhënë partive politike, pasi kjo ndikon në vendimmarrje dhe është një mjet për t'i bërë partitë që të japin llogari". Shih gjithashtu paragrafin 261 që thotë se "Është praktikë e mirë që të kërkohen këto raporte: [...] Raportet që u japin organeve mbikëqyrëse dhe publikut informacion paraprak lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e partive dhe kandidatëve për fushatë disa ditë para ditës së zgjedhjeve".

⁷³ Sipas *Monitorimit të Pluralizmit Mediatik të vitit 2024* të Institutit të Universitetit Evropian, katër pronarët kryesorë në tregun e transmetimit kontrollojnë 72 për qind të të ardhurave dhe 87 për qind të audiencës. Paragrafi 40 i *Komentit të Përgjithshëm Nr. 34 të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së (UNHRC)* parashikon që shtetet palë të ndërmarrin masat e duhura "për të parandaluar dominimin apo përqendrimin e panevojshëm të mediave përmes grupeve mediatike të kontrolluara privatisht në situata monopoliste që mund të dëmtojnë shumëllojshmërinë e burimeve dhe pikëpamjeve."

⁷⁴ Shih gjithashtu *vlerësimin* nga Kryetari i Shoqatës së Gazetarëve Shqiptarë.

⁷⁵ Sipas *Rrjetit Ballkanik të Gazetarise Investigative (BIRN)*, mes 10 stacioneve më të mëdha televizive (bazuar në deklaratat financiare) *TV Klan* dhe *Top Channel* zënë 64 për qind të tregut. I vetmi stacion televiziv mes këtyre 10, që perceptohet se është në linjë me PD-në, *Syri TV*, në vitin 2023, "vlerësohej se kishte 1.7% të të ardhurave totale të tregut televiziv, ose 113 milion lekë. Të ardhurat e deklaruara ranë me 22% krahasuar me 2022-shin."

⁷⁶ Më 6 shtator 2024, Drejtori i RTSH-së dha dorëheqjen pas shqetësimeve të ngritura rreth pozicioneve që kishte mbajtur me PS-në në të shkuarën. Më 17 shkurt 2025, Parlamenti shpërndau Këshillin Drejtues të RTSH-së për parregullsitë në përzgjedhjen e drejtorit të ri të RTSH-së. Një Këshill i ri Drejtues u emërua më 17 mars, i cili zgjodhi drejtorin e ri më 25 prill 2025.

Ndërhyrja e gjerë nga pronarët e mediave në autonominë editoriale, bashkë me autocensurën mes gazetarëve, ndikon negativisht në informacionet që i vihen në dispozicion publikut. Përveç kësaj, gazetarët ekspozohen në mënyrë të përsëritur ndaj sulmeve verbale dhe, hera-herës edhe fizike, nga zyrtarët publikë.⁷⁷ Gjithashtu, gazetarët raportojnë për akses në rënie tek përfaqësuesit e qeverisë, përfshirë edhe Kryeministrin, dhe për zvogëlim të numrit të konferencave për shtyp të organizuara, si dhe për moslejim të gazetarëve në disa raste në aktivitete, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.⁷⁸ Mbulimi editorial i lajmeve zëvendësohet shpesh nga materiale të përgatitura nga organet qeveritare, duke cenuar integritetin editorial. Agjencia e Medias dhe Informacionit (AMI), në varësi të Kryeministrit, i centralizon dhe filtron informacionet e nxjerra rreth qeverisë dhe institucioneve publikë.⁷⁹ Disa organe mediatike të financuara nga shoqëria civile dhe nga donatorët ofrojnë gazetari investigativ dhe në interes të publikut, por janë prekur nga shkurtimet së fundmi të fondeve ndërkombëtare.⁸⁰

Në përgjithësi, Kushtetuta dhe legjislacioni parashikojnë mbrojtjen e lirisë së fjalës. Megjithatë, pavarësisht nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, shpifja vazhdon të mbetet vepër penale. Një numër i konsiderueshëm çështjesh gjyqësore civile dhe penale janë hapur vitet e fundit kundër gazetarëve për shpifje, duke përfshirë edhe disa padi strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut (SLAPP), kundër gazetarëve.⁸¹

Kodi i Transmetimit i vitit 2023 kërkon që të gjitha lajmet të jenë objektive dhe të paanshme. Kodi Zgjedhor, ndryshe nga çfarë kërkohet nga angazhimet e OSBE-së, nuk parashikon mbulim të barabartë në edicionet informative për partitë joparlamentare në një mjedis mediatik tashmë disavantazhues për to.⁸² Më 6 mars, Këshilli i Ministrave ndaloi përkohësisht platformën *TikTok*, ndalim që nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare.⁸³ Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, ky ndali pati edhe një ndikim tjetër të dëmshëm ndaj aftësisë së të gjithë kandidatëve, duke përfshirë edhe atyre të partive joparlamentare, për të bërë fushatë në kushte të barabarta.

⁷⁷ Qendra Evropiane për Shtypin dhe Lirinë e Medias raportoi 45 incidente kundër lirisë së medias në vitin 2024. Më 27 mars 2024, Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve u bëri thirrje zyrtarëve publikë, duke përfshirë edhe Kryeministrin Edi Rama, për t'i dhënë fund gjuhës abuzive dhe sjelljes intimiduese ndaj gazetarëve. Më 26 mars 2025, safejournalists.net raportoi një sulm fizik të kryer së fundmi ndaj një gazetari nga një zyrtar në Tiranë.

⁷⁸ Paragrafi 13 i the Komentit të Përgjithshëm 34 të UNHRC-së thotë se “[k]omunikimi lirshëm i informacionit dhe ideve rreth çështjeve publike dhe politike mes qytetarëve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur është thelbësor. Kjo nënkupton që të ketë shtyp të lirë dhe media të tjera që kanë mundësinë të komentojnë për çështje publike pa censurë dhe pa kufizim, si dhe të informojnë opinionin publik.”

⁷⁹ Në tetor 2021, pikërisht para se AMI të niste punën, gjashtë organizata mediatike ndërkombëtare bënë thirrje që të anulohet ngritja e saj, pasi mund “të përdorej për të konsoliduar edhe më tej kontrollin mbi rrjedhën e informacionit publik”.

⁸⁰ Sipas Qendrës për Gazetari Cilësorë, gjashtë projekte të financuara nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së u pezulluan ose u ndërprejnë. Ndër to ishin Rrjeti Investigativ Shqipëri (INA), i cili financonte dhe publikonte investigime, dhe programi televiziv investigativ “31 minuta”, i transmetuar në të gjitha televizionet kryesore.

⁸¹ Një studim i Safejournalists.net raportoi gjithsej 8 çështje penale dhe 65 çështje civile për shpifje në vitin 2023.

⁸² Partitë që fituan mbi 20 për qind të vendeve në zgjedhjet e mëparshme parlamentare duhet të marrin dyfishin e mbulimit në lajme krahasuar me partitë e tjera parlamentare. Mbulimi i partive jashtëparlamentare është në diskrecionin e transmetuesve, por nuk mund të tejkalojë mbulimin e dhënë për partitë parlamentare që kanë më pak se 20 për qind të vendeve. Paragrafi Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 kërkon që Shtetet pjesëmarrëse të “Sigurojnë që asnjë pengesë ligjore apo administrative të mos qëndrojë në rrugën e aksesit të papenguar dhe jo-diskriminues në media për të gjitha grupimet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor”.

⁸³ Paragrafi 43 i UN Komentit të Përgjithshëm Nr. 34 të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së (UNHRC) përcakton se çdo kufizim mbi faqet e internetit, blogjet apo platformat e tjera të komunikimit *online* duhet të jetë i kufizuar ngushtë dhe i lidhur posaçërisht me përmbytjen. Ndalesat e gjera apo të përgjithshme, “ndalesat totale”, për funksionimin e këtyre sistemeve, përfshirë ofruesit e shërbimeve të internetit apo motorët e kërkimit, janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Tre organizata të shoqërisë civile e kontestuan këtë vendim në Gjykatën Kushtetuese më 25 mars.

Sipas shumicës së bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, materialet filmike për edicionet informative mbi fushatën u ofruan nga partitë politike. Në stacionet televizive të monitoruara nga MVZ-ja e ODIHR-it, asnjë prej mbulimeve në edicionet informative, nuk u identifikua si i tillë, siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor dhe nga KQZ-ja nuk u ndërmor asnjë masë për adresimin e kësaj praktike.⁸⁴ Gjithashtu, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it raportuan se disa intervista me disa kandidatë të transmetuara në programet e aktualitetit kishin qenë të paguara, në shkelje të ligjit. Materialet filmike të prodhuara nga kandidatët zgjedhorë në edicionet informative, si dhe mbulimi mediatik i paguar, është *de facto* i barabartë me reklamat politike dhe vë në disavantazh kandidatët me më pak mundësi financiare.

Monitorimi i MVZ-së së ODIHR-it tregoi se në dy stacionet televizive të monitoruara, PS-ja mori më shumë mbulim të fushatës në edicionet informative sesa PD-ja – ASHM.⁸⁵ Në RTSH, A2 CNN, Top Channel dhe TV Klan, PS-ja mori përkatësisht 45, 46, 48 dhe 57 për qind, ndërsa PD- ASHM mori 41, 48, 45 dhe 43 për qind.⁸⁶ Mbulimi, në 83 për qind të rasteve ishte me ton neutral ose pozitiv. Asnjë prej subjekteve të tjera nuk mori më shumë se 5 për qind të mbulimit në ndonjë prej stacioneve televizive të monitoruara. Megjithatë disa programe debati u transmetuan rregullisht, ato nuk sollën kandidatë shumë të njohur apo drejtues partish nga parti të ndryshme. RTSH-ja përmbushi detyrimin e saj ligjor të ofrimit të minutazhit falas subjekteve zgjedhore. Reklama politike me pagesë në televizion u blenë vetëm nga dy partitë dominuese. Përfundimisht, mjedisi i kufizuar mediatik dhe mosrespektimi në mirëbesim i parashikimeve ligjore, bëri që zgjedhësve t'u mohohet informimi i pavarur, i shumëllojshëm dhe solid lidhur me garën zgjedhore.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve zgjedhore

Kuadri ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore përfshin procedurat administrative të pasuara nga mundësia për ankimim gjyqësor. Vëzhguesit mund të ankohen vetëm për mosmarrje të akreditimit, ndërsa zgjedhësit mund të ankohen vetëm për përjashtim nga lista e zgjedhësve duke iu drejtuar gjykatave të rretheve. Kjo qasje e ngushtë lidhur me legjitimitetin e ankimit është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë zgjedhore, që kërkon akses më të gjerë në zgjidhje ligjore efikase për mosmarrëveshjet zgjedhore.⁸⁷

Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) shqyrton ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së dhe KZAZ-ve, duke përfshirë edhe vendimet për rezultatet e zgjedhjeve, të cilat duhet të gjykohen brenda 10 ditësh. Me kërkesë të KQZ-së, KAS-i mund edhe të vendosë sanksione. Deri më 11 maj, KAS-i ka shqyrtuar 17 ankime ndaj vendimeve të Komisionerit, të cilat që të gjitha kishin të bënin me pretendime për parregullsi para fillimit të fushatës zgjedhore. Në 11 raste pranoi ankimimet, në dy raste prishi vendimet e Komisionerit dhe vendosi katër gjopa administrative prej 3,000 lekësh për parregullsi në raportimin e institucioneve publike lidhur me aktivitetet e tyre dhe neglizhencën e anëtarëve të KZAZ-së. Ankimimet

⁸⁴ AMA (Autoriteti i Mediave Audiovizive) i dërgoi KQZ-së raporte monitorimi ditore dhe javore, në përputhje me ligjin. Megjithatë, monitorimi përfshinte vetëm edicionet e lajmeve dhe nuk vlerësonte tonin e mbulimit. Deri në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja mori 20 vendime, kryesisht për shkelje të rregullave për reklama me pagesë dhe sondazhet e opinionit publik. Nuk u morën masa lidhur me mbulimin e barabartë në edicionet informative.

⁸⁵ Nga 8 prilli deri më 9 maj, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it kreu një monitorim sasior dhe cilësor të katër stacioneve televizive dhe tre mediave online të lajmeve: RTSH, TV Klan, Top Channel dhe A2 CNN, si dhe *panorama.al*, *lapsi.al* dhe *reporter.al*

⁸⁶ Shifrat nuk përfshijnë mbulimin e aktorëve politikë në cilësinë e tyre institucionale. Programet informative dhe ato të debatit treguan më shumë mungesë balancimi.

⁸⁷ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 angazhon Shtetet pjesëmarrëse të ofrojnë për të gjithë “mjete efektive për ankimim kundër vendimeve administrative, me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave themelore dhe sigurimin e integritetit ligjor.” Seksioni II.3.3.f i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias rekomandon: “Të gjithë kandidatët dhe të gjithë votuesit e regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse duhet të kenë të drejtë ankimi. Mund të vendoset një kuorum i arsyeshëm për ankimet e votuesve mbi rezultatet e zgjedhjeve”.

e tjera nuk u pranuan. Procesi që transparent, të gjitha çështjet u shqyrtuan në seanca publike dhe me pjesëmarrjen e palëve të përfshira. Megjithatë vendimet e KAS-it ishin përgjithësisht të mirëarsyetuara, ato reflektuan një interpretim të ngushtë të rregullave për përdorimin e burimeve administrative në fushatë, duke e kufizuar zbatimin e tyre rreptësisht në periudhën zyrtare të fushatës,⁸⁸ në kundërshtim me praktikën e mirë zgjedhore.⁸⁹

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (Kolegji Zgjedhor) është autoriteti më i lartë për gjykimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore, por operon me staf administrative të kufizuar, dhe me trajnime dhe burime financiare të pamjaftueshme.⁹⁰ Deri më 11 maj, Kolegji Zgjedhor ka gjykuar dhe ka rrëzuar tre ankimime.⁹¹ Seancat ishin publike, vendimet të arsyetuara dhe të publikuara në faqen zyrtare, pavarësisht se me vonesë.

Në Kodin Penal jepet përkufizimi i 15 veprave penale në lidhje me zgjedhjet, shumica e të cilave janë në kompetencën e Prokurorit të Përgjithshëm. Deri më 11 maj, ka nisur procedimi penal në 25 nga 44 raste të pretendimeve për krime zgjedhore, ku përfshihen raste të akuzave për shpërdorim detyre për qëllime zgjedhore dhe pengim të subjekteve zgjedhore.⁹²

SPAK-u ka juridiksion mbi rastet e korrupsionit zgjedhor që kanë të bëjnë me kategori të zyrtarëve të lartë publikë ose krimin e organizua. Për herë të parë, SPAK-u ngriti një task forcë hetimore dhe një platformë *online* për raportimin e veprave penale zgjedhore.⁹³ Deri më 10 maj, nga 138 raportime për pretendime për krime zgjedhore janë nisur 39 procedime penale, shumica e të cilave kanë të bëjnë me akuza për korrupsion pasiv dhe aktiv. Konkretisht, SPAK-u ka nisur tetë procedime *ex officio*. Bashkëpunimi midis SPAK-ut, KQZ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme, bazuar në një protokoll ndërinstitucional mundësoi shkëmbimin e informacioneve lidhur me krimet zgjedhore, përcaktimin e prioritetëve dhe u vlerësua përgjithësisht pozitivisht nga bashkëbiseduesit e ODIHR-it. SPAK-u perceptohej përgjithësisht si një institucion i besuar nga bashkëbiseduesit e MNVZ-së dhe si institucion që mund edhe të kishte një efekt frenues. Megjithatë, disa bashkëbisedues ngritën shqetësime lidhur me efikasitetin e policisë në trajtimin e veprave penale të lidhura me zgjedhjet edhe kur ato lidheshin me rrjete të krimit të organizuar. (shih gjithashtu seksionin mbi *Mjedisin e fushatës*).

Pjesëmarrja e pakicave kombëtare

Kushtetuta shqiptare parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat, dhe Kodi Zgjedhor garanton të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur për të gjithë shtetasit shqiptarë pavarësisht nga origjina etnike, raca, besimi fetar apo gjuha. KQZ-ja prodhoi materiale zgjedhore në

⁸⁸ Neni 91, paragrafi 1 i Kodit Zgjedhor parashikon se: "Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia." Ky nen nuk përcakton qartë një periudhë kohore për zbatimin e këtij parashikimi, dhe KQZ-ja e interpretoi atë si të zbatueshëm vetëm gjatë periudhës zyrtare njëmuajore të fushatës.

⁸⁹ Neni 13 i Udhëzimeve të përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2016 përcakton një përkufizim më të gjerë të procesit zgjedhor, i cili "përfshin mënyrat e shumta në të cilat burimet administrative mund të keqpërdoren gjatë gjithë procesit zgjedhor, dhe jo vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore."

⁹⁰ Palët e treta me interes legjitim mund të paraqesin gjithashtu një ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë

⁹¹ Këto kishin të bënin me regjistrimin e partive politike, dizajnin e fletëve të votimit dhe përdorimin e pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik.

⁹² Pesë procedura janë regjistruar në Prokurorinë e Fierit, katër në Elbasan, dy në Gjirokastrë, Shkodër dhe Sarandë dhe një në in Korçë, Durrës, Vlorë dhe Kukës. Tetë u iniciuan *ex officio*, 2 pas raportimeve nga qytetarët dhe 19 nga policia.

⁹³ Nga janari 2025 deri më 7 maj, janë regjistruar 123 raportime për krime, 51 prej të cilave përmes platformës *online* të SPAK, pjesa tjetër kryesisht nga policia dhe PD, dhe disa janë referuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

gjuhën e pakicave kombëtare të njohura zyrtarisht, me përjashtim të pakicës egjiptiane (*shih administratën zgjedhore*),⁹⁴ megjithëse shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it pretenduan se materialet nuk u shpërndanë gjerësisht.⁹⁵ Gjatë fushatës nuk u vunë re kufizime të përdorimit të gjuhëve të pakicave. Në fushatë nuk pati probleme të theksuara lidhur me pakicat kombëtare apo etninë dhe kandidatët e pakicave kombëtare shpesh bënë fushatë për çështje që prekin popullatën në tërësi, me përjashtim të një numri të vogël kandidatësh nga pakica greke që bënë fushatë lidhur me të drejtat e pronësisë.

Pakicat patën përgjithësisht mundësinë të merrnin pjesë lirisht si zgjedhës dhe si kandidatë, duke kandiduar si me dy partitë kryesore kombëtare, ashtu edhe me dy parti të pakicave kombëtare në koalicionin e udhëhequr nga PD-ja. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, sistemi zgjedhor aktual që e bën të detyrueshëm daljen me kandidatë në të gjitha zonat zgjedhore, ishte pengesë për marrjen e mandateve në parlament nga ana e partive të pakicave kombëtare. Ata gjithashtu theksuan se anëtarët e komunitetit rom ishin përgjithësisht të pafamiljarizuar me procedurat zgjedhore dhe se nuk kishte pasur ndonjë informim specifik për ta në këtë drejtim.⁹⁶ Përveç kësaj, vëzhguesve afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it iu raportua edhe se ndaj komuniteteve romë dhe egjiptiane kishte pasur presion për shitje votash.⁹⁷ Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it vunë re se zgjedhësit romë në disa zona ishin të paqartë për vendndodhjen e saktë të qendrave të tyre të votimit, pjesërisht për shkak të komunikimit zyrtar të pamjaftueshëm.⁹⁸

Vëzhgimi i zgjedhjeve

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. KQZ-ja akreditoi gjithsej 47 organizata vendase dhe 56 organizata ndërkombëtare. OSHC-të informuan MNVZ-në se mungesa e financimit, veçanërisht nga donatorët ndërkombëtarë, uli kapacitetin e tyre për një vëzhgim gjithëpërfshirës dhe për të dërguar një numër të përshtatshëm vëzhguesish në ditën e zgjedhjeve. Partitë parlamentare dhe koalicionet mund të caktojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ. Subjektet zgjedhore mund të caktonin një vëzhgues në KZAZ dhe KQV, si dhe për çdo GNV, duke përfshirë edhe për fletët e votimit nga jashtë vendit.

Dita e zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe u menaxhua në mënyrë transparente, por në shumë vende me mosrespektim të procedurave gjatë hapjes dhe votimit, si dhe me disa raportime për frikësim dhe ndikim tek zgjedhësit. Në përgjithësi, vëzhguesve iu dha akses i mjaftueshëm për të monitoruar të gjithë procesin. Numri i madh i ndryshimit të vonë të disa anëtarëve të emëruar nga partitë politike në Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), madje edhe në prag të zgjedhjeve, pati ndikim negativ në respektimin e procedurave të votimit dhe reduktoi efektivisht transparencën e përbërjes së KQV-ve. Në orën 20:00 në ditën e zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) njoftoi se pjesëmarrja në zgjedhje ishte 42.3 për qind.

⁹⁴ Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, në fuqi që nga viti 2017, njeh pakicat kombëtare arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, romë dhe serbe.

⁹⁵ KQZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se posterat në gjuhën maqedonase ishin vendosur krahas atyre në shqip në QV-të e Pustecit, dhe në greqisht në QV-të e Dropullit dhe Finiqit. Video edukative për votuesit u përkthyen në tetë gjuhë pakicash për rrjetet sociale. Fletushkat informuese për votuesit u prodhuan në tetë gjuhë pakicash dhe u dorëzuan në Komitetin Shtetëror për Pakicat Kombëtare, për t'u shpërndarë në rajonet përkatëse për çdo grup pakice nga përfaqësuesit e tyre.

⁹⁶ Për shembull, siç u raportua në Tiranë. Megjithatë, KQZ-ja bashkëpunoi me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për të mbajtur takime informuese me anëtarë të pakicave romë dhe egjiptiane në disa bashki.

⁹⁷ Kjo u raportua në MVZ-në e ODIHR-it në Korçë dhe Tiranë.

⁹⁸ Kjo u raportua në MVZ-në e ODIHR-it në Tiranë.

MNVZ-ja vëzhgoi hapjen në 122 qendra votimi, duke e vlerësuar procesin negativisht në një të tretën e rasteve. Numri i madh i vlerësimeve negative ishte kryesisht për shkak të mosrespektimit të disa procedurave. Në shumicën e qendrave të votimit të vëzhguara, votimi filloi me vonesë, ku në 28 prej tyre vonesa ishte mbi 30 minuta, shpesh për shkak të problemeve teknike ose mungesës së materialeve. Në 26 raste, anëtarët e KQV-ve nuk ishin të njohur me procedurat e hapjes, dhe në 17 raste, të pranishmëve nuk iu demonstrua kutia e votimit bosh. Në 9 raste u konstatua se nuk u ndoqën procedurat për vendosjen e pajisjes për identifikimin biometrik. Në 12 KQV, persona të paautorizuar jepnin udhëzime ose ndërhynin në punën e komisionit. Në qendrat e votimit elektronik, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në shumë raste nuk u ndoqën procedurat.

Në shumicën e rasteve, votimi u vlerësua pozitivisht. Megjithatë, në 4.6 për qind të 995 vëzhgimeve, një numër i lartë, procesi u vlerësua negativisht, kryesisht për shkak të mangësive procedurale dhe një niveli presioni mbi zgjedhësit. Vëzhguesit e partive ishin të pranishëm në 79 për qind të qendrave të votimit, ndërsa vëzhgues vendas u konstatuan vetëm në 8 për qind, dhe mungesa e tyre në shumë qendra uli nivelin e mbikëqyrjes së procesit. Në total, 30 për qind e anëtarëve të KQV-ve ishin gra, ndërsa gratë ishin kryetare të KQV-ve në 25.5 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara.

Vëzhguesit e MNZHZ raportuan se në 23 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, votuesit nuk mund të identifikoheshin gjithmonë nga pajisjet për identifikim të votuesve, dhe në 24 për qind të qendrave të votimit nuk u kontrolluan gjithmonë për shenja të bojës në duar. Disa pajisje për identifikim biometrik pësuan defekte, duke shkaktuar ndërprerje në proces. Në 23 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, shenjat e gishtërinjve të disa votuesve nuk u lexuan siç duhet. Kodet e sigurisë nuk u regjistruan në Librin e Procesverbalit të Mbledhjes së KQV-ve në 5 për qind të rasteve të vëzhguara. Organizimi fizik i qendrave të votimit u vlerësua si i papërshtatshëm për votim në 5 për qind të vëzhgimeve, kryesisht sepse kontribuoi në komprometimin e fshehtësisë së votës, e cila në 12 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara nuk u respektua gjithmonë. Fshehtësia e votës u komprometua gjithashtu nga ndërhyrjet e vëzhguesve të partive ose të anëtarëve të KQV-ve. Votimi në grup, kryesisht votimi familjar, u vëzhgua në 11 për qind të qendrave të vizituara dhe votimi përfaqësues, shpesh për anëtarë të familjes, në 3 për qind. Kuptimi i votuesve për procedurat e votimit u vlerësua negativisht në 13 për qind të vëzhgimeve, duke treguar për nevojën e shtuar për edukim të votuesve mbi procedurat e reja të votimit pas futjes së listave preferenciale.

Gjatë gjithë ditës u vëzhguan disa raste shkeljesh të rëndësishme dhe incidentesh. MNZHZ vërejti tension ose frikësim në 4 për qind të qendrave të votimit të vizituara, që shpesh përfshinte vëzhgues ose përfaqësues partie të cilët qëndronin në hyrje të qendrave të votimit, ndërvepronin me votuesit ose ndërhynin në punën e KQV-ve. Persona të paautorizuar, përfshirë aktivistë partiakë, ishin të pranishëm në 2 për qind të vendeve të vizituara dhe ndërhynin në disa raste. Në 2.4 për qind të qendrave të votimit kishte indikacione se votuesit nxiteshin të votonin për një kandidat të caktuar, përfshirë pretendime për blerje votash. Në 3 për qind të qendrave të votimit, vëzhguesit raportuan për persona të paautorizuar që mbanin shënim se kush kishte votuar. Pas mbylljes së votimeve, KQZ raportoi se rastet që lidhen me pesë incidente janë referuar në prokurori: dy në Tiranë dhe nga një në Elbasan, Korçë dhe Berat.

Në lidhje me votimin elektronik, vëzhguesit e MNZHZ vërejtën se, megjithëse në përgjithësi procesi kaloi pa probleme të mëdha, disa shqetësime ishin të dukshme. Shumë votues dukeshin të panjohur me mënyrën e përdorimit të pajisjes së votimit, dhe shumë prej tyre nuk arritën të votojnë brenda kufirit të kohës prej tre minutash. Disa anëtarë të KQV-ve dhe operatorë të teknologjisë nuk ishin të trajnuar në mënyrë adekuate për procedurat përkatëse ose nuk kishin qartësi për rolet e tyre. Në disa vende të vëzhguara, votuesit nuk mundën të votojnë në mënyrë të pavarur, dhe u ofrua ndihmë atyre që e kërkuan, ndërkohë që mbipopullimi për shkak të kohës që mori votimi në disa raste, komprometoi fshehtësinë e votës.

Nuk kishte aksesueshmëri të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara në 50 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Numri i madh i qendrave të votimit që ishin të paaksesueshme për votim të pavarur tregon qartë nevojën e madhe për përpjekje të mëtejshme për të siguruar aksesueshmëri për të gjithë votuesit. Gjithashtu, mënyra e organizimit brenda qendrave të votimit u pa si jo e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara në 24.4 për qind të qendrave të vizituara. Kjo, së bashku me mungesën e një mënyrë votimi për votuesit që janë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi, që janë të shtruar në spital apo me probleme me lëvizjen, mund të ketë pasur një ndikim negativ në pjesëmarrjen e tyre.

Mbyllja e qendrave të votimit u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit e MNVZ-së në 75 nga 89 raportime. KQV-të ndoqën procedurat e mbylljes në shumicën e rasteve, megjithatë, në katër raste u raportuan tensione. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan shumë pozitivisht për pranimin e materialeve në Qendrat e Numërimit të Votave, megjithëse pati mbipopullim në 10 nga 50 qendrat e vëzhguara. Transmetimi i rezultateve të votimeve elektronike nga pajisjet direkt tek KQZ-ja në mbyllje të procesit të votimit u shty për shkak të një kërkesë nga PD-ja për të mos transmetuar votat elektronike në mbyllje të votimit, për të shmangur njohjen e rezultateve të parakohshme, duke treguar gjithashtu edhe mungesë besimi tek sistemi. Pajisjet e votimit, bashkë me kutitë e fletëve të votimit që janë pjesë e tyre, u dorëzuan në KZAZ-të përkatëse në Tiranë dhe Vorë, ku u krye pilotimit, për të filluar numërimin mëngjesin e datës 12 maj.

Vëzhguesit e MNVZ-së kanë raportuar nga 66 nga 93 Qendrat e Numërimit të Votave, dhe raportimi vazhdon. Vëzhguesit e vlerësuan negativisht procesin në 7 nga këto 66 raste. Problemet në përgjithësi lidheshin me tensionet (9 raste), mbipopullimin (7 raste), mungesë të aksesit të plotë në proces (12 raste) dhe disa ndërhyrje nga vëzhguesit e partive (6 raste).

Megjithëse procesi i numërimit vazhdoi në mënyrë të rregullt në shumë qendra numërimi, vëzhguesit vërejtën një atmosferë kaotike dhe kontestime lidhur me vlefshmërinë e fletëve të votimit në disa qendra. Gjetjet fillestare bazohen në numërimin e 97 kutive votimit. Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan negativisht numërimin individual të votave në 8 raste, kryesisht për shkak të mangësive procedurale dhe mungesës së transparencës, si mosnumërimi fillimisht i fletëve të papërdorura të votimit, mosdemonstrimi i fletëve të votimit si duhet para kamerave të instaluara për këtë qëllim. Vëzhguesve të partive nuk iu dhanë kopje të rezultateve në 19 raste, duke kufizuar transparencën. Për 8 numërimet u kërkua rinumërimi. Tabela e rezultateve për numërimin e votave u dorëzua në KZAZ menjëherë pas përfundimit të numërimit në 89 vëzhgime. Në Dibër dhe Elbasan, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se zyrtarët e KQZ-së kishin shkuar në zonë për të trajnuar anëtarët e qendrave të numërimit në mesnatë, para se të fillonte numërimi i votave, duke treguar mungesë trajnimi që ndoshta lidhet me zëvendësimin me vonesë të disa anëtarëve të caktuar nga partitë. Një vonesë në numërimin e votave të VCV u vu re në qendrën kryesore të numërimit në Tiranë, për shkak të një ankese nga PD në lidhje me verifikimin e disa fletëve të votimit.

Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.

Versioni i ofruar në gjuhën shqipe është versioni jozyrtar i këtij raporti.

INFORMACION PËR MISIONIN & FALËNDERIME

Tiranë, 12 maj 2025 – Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSE-së (PA OSBE), Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) dhe Parlamentit Evropian (PE). Ky vlerësim pati për qëllim të shihte nëse zgjedhjet ishin në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standardet e Këshillit të Evropës dhe detyrime dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin vendas.

Farah Karimi (deputete) u emërua nga Kryetari i Radhës i Kryesisë së OSBE-së si Koordinatorja e Posaçme dhe Drejtuese e misionit të vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së. Ambasadori Lamberto Zannier është Shefi i MVZ-së së ODIHR-it, i dërguar që prej 2 prillit 2025. Björn Söder (deputet) është drejtuesi i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Simone Billi (deputet) është Shefi i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Michael Gahler (anëtar i Parlamentit Evropian) është Shefi i delegacionit të Parlamentit Evropian.

Secili prej institucioneve të përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) ka miratuar Deklaratën e vitit 2005 të Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve. Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake bëhet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të tjera të procesit zgjedhor, përfshirë numërimin, nxjerrjen dhe shpallje e rezultateve, si dhe nga mënyra e trajtimit të ankesave dhe apeliave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. ODIHR-i do të nxjerrë një raport të plotë përfundimtar, duke përfshirë edhe rekomandime për përmirësime të mundshme, në një fazë të mëvonshme. Asambleja Parlamentare e OSBE-së do ta paraqesë raportin në Sesionin e Përvitshëm në Porto në muajin korrik. PACE do të paraqesë raportin e saj gjatë sesionit të saj të qershorit 2025 në Strasburg. Delegacioni i Parlamentit Evropian për marrëdhëniet me Shqipërinë do të diskutojë rezultatet e misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve në takimin e tij në muajin qershor.

MVZ-ja e ODIHR-it përfshin 16 ekspertë në kryeqytet dhe 26 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në të gjithë vendin. Në ditën e zgjedhjeve, u dërguan 350 vëzhgues nga 47 vende, duke përfshirë 214 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të dërguar nga ODIHR-i, si dhe një delegacion me 96 anëtarë nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së, 12 nga Parlamenti Evropian dhe 22 nga PACE. Hapja e votimit u vëzhgua në 1,343 qendra votimi. Numërimi i vëzhgua në 97 qendra numërimi.

Vëzhguesit dëshirojnë të falënderojnë autoritetet për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për asistencën. Ata dëshirojnë, gjithashtu, të shprehin vlerësimin për institucione të tjera shtetërore, parti politike dhe organizata të shoqërisë civile dhe për përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar për bashkëpunimin.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:

- Ambasador Lamberto Zannier, Shefi i MVZ-së së ODIHR-it, në Tiranë ((+355 68 209 3925);
- Katya Andrusz, Zëdhënëse e ODIHR-it ((+48 609 522 266), ose Goran Petrov, Këshilltar për Zgjedhjet i ODIHR-it në Varshavë (+48 697 990 989)
- Andreas Nothelle, Këshilltar Ligjor, Asambleja Parlamentare e OSBE-së (+43 676 3200 568)
- Bogdan Torcatoriu, Këshilltar i Lartë për Zgjedhjet, PACE (+33 6 50 39 29 40)
- Raffaele Luise, Administrator, Parlamenti Evropian, Drejtorja e Përgjithshme për Politikën e Jashtme (+32 470 880 101)

Adresa e MVZ-së së ODIHR-it: MAK Hotel, Sheshi Italia 2, Tirana

Tel: +355 682 093 925

Email: office@odihr.al

Faqja e internetit: www.osce.org/odihr/elections/albania

RAPORT I NDËRMJETËM

1 prill – 21 prill 2025

28 prill 2025

I. PËRMBLEDHJE

- Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 zhvillohen në kontekstin e ndryshimeve në sistemin zgjedhor dhe të futjes për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, duke i bërë kthyer zgjedhje në një moment të rëndësishëm për vendin. Këto zgjedhje konsiderohen gjithashtu si një tjetër provë e rëndësishme për zhvillimin e proceseve dhe institucioneve demokratike në Shqipëri, veçanërisht në kontekstin e negociatave të vazhdueshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Mjedisi politik karakterizohet nga një shkallë e lartë polarizimi dhe mosbesimi midis dy partive kryesore.
- Ndryshimet në kuadrin ligjor në vitet 2024 dhe 2025 modifikuan sistemin zgjedhor dhe futën votimin nga jashtë vendit, por nuk u ndërmor një rishikim i plotë i këtij kuadri. Në sistemin e ri zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor paraqet si lista të mbyllura, ashtu edhe lista preferenciale. Mandatet e fituara nga një parti ose koalicion në një zonë zgjedhore u caktohen fillimisht kandidatëve nga listat e mbyllura. Megjithatë rekomandimet e ODIHR-it për ndryshimin e pragut kombëtar për kandidatët e pavarur dhe heqjen e mundësisë që liderët e partive politike të kandidojnë në disa zona zgjedhore janë adresuar, shumë prej rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it mbeten të pazbatuara.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përgjegjës për mbikëqyrjen e administrimit të zgjedhjeve. Përgatitjet për zgjedhjet po ecin sipas planit, përfshirë edhe votimin nga jashtë vendit, dhe deri më tani administrata zgjedhore ka respektuar në masë të madhe afatet ligjore. Votimi nga jashtë vendit do të zhvillohet me anë të votimit postar dhe KQZ-ja ka zhvilluar një fushatë të gjerë informuese për regjistrimin e zgjedhësve jashtë vendit. KQZ-ja ka nisur gjithashtu fushata të targetuara për edukimin e zgjedhësve, duke iu drejtuar popullsisë së përgjithshme, pakicave kombëtare dhe personave me aftësi të kufizuara. Votimi dhe numërimi elektronik do të pilotohet në disa bashki të përzgjedhura, duke bërë teste dhe demonstrime publike që planifikohen të kryhen përpara ditës së zgjedhjeve.
- Për këto zgjedhje janë regjistruar rreth 3.7 milionë zgjedhës, përfshirë rreth 246 mijë për votimin nga jashtë vendit. Për të mundur një regjistrim gjithëpërfshirës të zgjedhësve jashtë vendit, KQZ-ja vendosi të zgjasë vlefshmërinë e dokumenteve të identifikimit, të cilave u kishte përfunduar afati i vlefshmërisë. Zgjedhësit patën mundësinë të verifikonin të dhënat e tyre dhe të kërkonin korrigjime, përfshirë edhe *online*, gjatë periudhës së shqyrtimit publik. Identifikimi i zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve do të bëhet përmes pajisjeve të identifikimit elektronik.
- Zgjedhjet mund të kontestohen nga kandidatët e propozuar nga partitë politike, koalicionet e partive ose nga kandidatët e pavarur të propozuar nga grupe zgjedhësish. KQZ-ja regjistroi njëmbëdhjetë subjekte zgjedhore – tetë parti politike dhe tre koalicione, me një numër total prej 2,046 kandidatësh. Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore, e cila kërkon që një në çdo tre kandidatë në të dyja listat të jetë i gjinisë më pak të përfaqësuar.
- Gratë janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë në poste ministrore, duke mbajtur gjysmën e posteve në qeverinë aktuale. Megjithatë, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në parlament, ku zënë 50 nga 140 vendet (36 për qind). Tre nga 12 anëtarët e KQZ-së dhe rreth 31 për qind e anëtarëve të Komisioneve të Administrimit Zgjedhor të Zonës janë gra. Nga kandidatët e regjistruar, 787 (38.47 për qind) janë gra. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë

në dukje se stereotipizimi gjinor dhe retorika diskriminuese ndaj grave aktive në politikë vazhdojnë të jenë pengesa të rëndësishme për pjesëmarrjen e tyre.

- Fushata zyrtare filloi më 11 prill. Pas disa aktiviteteve të profilit të lartë për të shënuar hapjen e fushatës, ajo ka vijuar në mënyrë të qetë. Sulmet personale midis liderëve të partive kryesore janë të zakonshme, përfshirë edhe në internet. Keqpërdorimi i burimeve shtetërore dhe fushata brenda institucioneve publike janë të ndaluara, por shqetësimet lidhur me presionin ndaj nëpunësve civilë, ndikimin e padrejtë mbi zgjedhësit dhe keqpërdorimin e aseteve publike vazhdojnë të jenë të pranishme. KQZ-ja ka marrë një numër të konsiderueshëm ankesash në lidhje me shkeljet gjatë fushatës dhe vazhdon të monitorojë në mënyrë aktive respektimin e ligjit, përfshirë aktivitetet *online* të 50 institucioneve publike. Megjithatë fushata në rrjetet sociale nuk është formalisht e rregulluar, partitë politike janë angazhuar vullnetarisht për zbatimin e një Kodi Sjelljeje që promovon fushatën dixhitale etike. Për mbrojtjen e informacionit në lidhje me zgjedhësit janë miratuar ligje dhe udhëzime të reja për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe autoritetet kanë bërë thirrje për vigjilencë kundër keqpërdorimit të të dhënave personale gjatë fushatës.
- Fushata mund të financohet nga fonde publike dhe private, përfshirë huatë. Ligji përcakton kufij për donacionet dhe shpenzimet. KQZ-ja mbikëqyr respektimin e rregullave për financimin e fushatës. Nuk janë ndërmarrë ndryshime të rëndësishme në kuadrin rregullator që nga zgjedhjet e fundit. Rekomandimet e ODIHR-it lidhur me raportimin e ndërmjetëm, rregullimin e financimit nga palët e treta dhe zgjerimin e financimit publik për të përfshirë edhe kandidatët e pavarur mbeten të paadresuara.
- Kuadri ligjor mbron lirinë e shprehjes, megjithatë shpifja vazhdon të përbëjë vepër penale dhe ndaj gazetarëve vazhdon të ketë çështje gjyqësore civile dhe penale për shpifje. Pavarësia e medias dhe diversiteti në raportim ndikohet nga përqendrimi i pronësisë së mediave dhe varësia e pronarëve nga tenderët publikë për qëllimet e tyre më të gjera të biznesit. Vazhdon të ketë shqetësime në lidhje me pavarësinë e bordeve drejtuese të rregullatorit të transmetimeve dhe transmetuesit të shërbimit publik. Kodi Zgjedhor parashikon që partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në zgjedhjet e mëparshme përfitojnë dy herë më shumë kohë transmetimi në edicionet informative krahasuar me partitë e tjera parlamentare që marrin pjesë në zgjedhje.
- Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS) shërben si organi i shkallës së parë për ankimet kundër vendimeve të KQZ-së dhe komisioneve të niveleve më të ulëta, ndaj të cilave mund të bëhet ankim bë shkallën e parë të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë. Subjektet zgjedhore kanë tre ditë afat për paraqitjen e ankesës, përveç rasteve që lidhen me rezultatet e zgjedhjeve, për të cilat afati është pesë ditë. Palët e treta me interes të ligjshëm mund të paraqesin ankesë administrative. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka krijuar një task-forcë për hetimin e disa veprave penale zgjedhore dhe një platformë *online* për raportimin nga publiku.
- Kushtetuta garanton të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat. Lejohet zhvillimi i fushatës në gjuhët e pakicave kombëtare. KQZ-ja deklaroi se do të prodhojë disa materiale zgjedhore në gjuhët e pakicave kombëtare dhe ka nisur një sërë aktiviteteve informuese për zgjedhësit me qëllim promovimin e pjesëmarrjes së grupeve të nënpërfaqësura.
- Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë në të gjitha nivelet. Deri më 11 prill, ishin akredituar 26 organizata vendase dhe 10 organizata ndërkombëtare. OSHK-të kanë informuar MVZ-në e ODIHR-it se mungesa e fondeve do të ndikojë në kapacitetin e tyre për të kryer një vëzhgim gjithëpërfshirës në ditën e zgjedhjeve. Përfaqësuesit e partive, koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur mundet gjithashtu të kryejnë vëzhgim.

II. HYRJE

Me ftesë të autoriteteve vendase, ODIHR-i ngriti në Tiranë, më 1 prill, një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ). MVZ-ja e ODIHR-it, e drejtuar nga Ambasador Lamberto Zannier, përbëhet nga një ekip qendror prej 12 anëtarësh me bazë në Tiranë dhe 26 vëzhgues afatgjatë të vendosur më 10 prill në të gjithë vendin. Anëtarët aktualë të misionit vijnë nga 22 Shtete Pjesëmarrëse të OSBE-së dhe 50 për qind e tyre janë gra. ODIHR-i u ka kërkuar Shteteve Pjesëmarrëse të dërgojnë 300 vëzhgues afatshkurtër.

III. KONTEKSTI

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit, të shpallura nga Presidenti Bajram Begaj më 5 dhjetor 2024, klima politike karakterizohet nga polarizim i thellë, përçarje brenda partive, raste të bujshme korrupsioni, dhe shqetësime në rritje lidhur me qeverisjen demokratike dhe lirinë e shprehjes.¹ Në të njëjtën kohë, përparimi lidhur me negociatat për kandidaturën në BE dhe zbatimin për herë të parë i votimit nga jashtë vendit kanë qenë temat kryesore në diskursin publik.

Skena politike mbetet e dominuar nga dy partitë kryesore: Partia Socialiste (PS) e Kryeministrit Edi Rama, e cila ka fituar tre zgjedhje parlamentare radhazi që nga viti 2013, dhe Partia Demokratike (PD) e opozitës, e drejtuar aktualisht nga ish-Kryeministri Sali Berisha.² Megjithatë, PD-ja ka përjetuar konflikte të rëndësishme të brendshme, të cilat kanë çuar në krijimin e një partie të re të shkëputur, Demokratët Euro-Atlantikë.

Në tetor 2024, ish-Presidenti Ilir Meta, lider i Partisë së Lirisë (PL), u arrestua nën akuzat për korrupsion. Muajin pasardhës, kryetari i PD-së, Sali Berisha, u lirua nga arresti shtëpiak, por akuzat për korrupsion ndaj tij vazhdojnë të jenë në fuqi. Një seri protestash kundër qeverisë, të cilat filluan në fund të vitit 2024 dhe vijuan gjatë vitit 2025, kritikuan dobësimin e institucioneve demokratike dhe akuzuan qeverinë për korrupsion dhe keqpërdorim të burimeve shtetërore. Protesta pati edhe si reagim ndaj arrestimeve që disa grupe opozitare i perceptuan si të motivuara politikisht. Në shkurt, nën akuzat për korrupsion, u arrestua edhe Erion Veliaj, Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe anëtar i spikatur i PS-së.³

Më 17 shkurt, Parlamenti votoi për shkarkimin e 11 anëtarëve të këshillit drejtues të Radio-Televizionit Publik Shqiptar, pas pretendimeve për parregullsi në përzgjedhjen e Drejtorit të ri të Përgjithshëm. Një këshill i ri u emërua më 17 mars. Më 6 mars, Këshilli i Ministrave ndaloi përkohësisht aksesin në TikTok. Tre organizata të shoqërisë civile e kundërshtuan këtë vendim në Gjykatën Kushtetuese më 25 mars, për shkak të mundësisë së cenimit të lirisë së shprehjes.⁴

Gratë janë të mirëpërfaqësuar në postet ministrore, duke mbajtur gjysmën e posteve në qeverinë aktuale, por mbeten të nënpërfaqësuar në parlament, ku zënë 50 nga 140 mandate (36 për qind). Disa bashkëbisedues vunë në dukje stereotipet gjinore të vazhdueshme dhe retorikën diskriminuese ndaj grave aktive në politikë si një pengesë për hyrjen e grave në jetën politike. Ata theksuan gjithashtu demokracinë

¹ Pushteti legjislativ ushtrohet nga një parlament njëdhomësh prej 140 anëtarësh, i zgjedhur për një mandat katërvjeçar. Pushteti ekzekutiv i takon qeverisë, e cila drejtohet nga kryeministri. Presidenti është kreu i shtetit.

² Në zgjedhjet e mëparshme parlamentare të mbajtura në vitin 2021, PS-ja siguroi 74 mandate; aleanca e drejtuar nga Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim" (PD) fitoi 59 mandate; Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) 4; dhe Partia Socialdemokrate (PSD) 3 mandate. Në zgjedhjet vendore të vitit 2023, PS-ja fitoi në 52 bashki, Koalicioni "Bashkë Fitojmë" 7, dhe Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen 1.

³ Pas këtij arrestimi, Kryeministri Edi Rama bëri komente kritike ndaj Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Më 12 shkurt, Këshilli i Lartë Gjyqësor publikoi një deklaratë duke theksuar se komentet e bëra nga persona në pozita ekzekutive ose politike kundër SPAK-ut cenojnë pavarësinë e gjyqësorit.

⁴ Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese në Shqipëri dhe Qendra për Fuqizim Ligjor kërkuan gjithashtu që ky ndalim të hiqej deri në marrjen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese.

e dobët të brendshme partiake si një shqetësim kyç për përfaqësimin dhe avancimin e grave brenda disa partive.

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet parlamentare rregullohen kryesisht nga Kushtetuta e vitit 1998 dhe Kodi Zgjedhor i vitit 2008, të plotësuar nga një sërë rregulloresh të nxjerra nga KQZ-ja.⁵ Shqipëria është palë në instrumentet kryesore ndërkombëtare ligjore që lidhen me zgjedhjet demokratike.⁶

Kodi Zgjedhor u ndryshua në korrik 2024 dhe shkurt 2025, duke sjellë ndryshime në sistemin zgjedhor dhe në disa rregulla të financimit të fushatës, si dhe duke parashikuar votimin nga jashtë vendit, në zbatim të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, dispozitat ligjore të shpallura antikushtetuese në vitin 2021 u shfuqizuan më pas.⁷ Megjithatë, nuk u ndërmor një rishikim gjithëpërfshirës i kuadrit ligjor zgjedhor, i bazuar në një proces konsultimi gjithëpërfshirës. Edhe pse disa rekomandime të ODIHR-it, si rishikimi i pragut kombëtar për kandidatët e pavarur dhe heqja e mundësisë që drejtuesit e partive politike të kandidojnë në disa zona zgjedhore, u adresuan, shumë rekomandime të mëparshme të ODIHR-it mbeten të pazbatuara. Këtu përfshihen, ndër të tjera, rekomandimet që lidhen me përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, të drejtat zgjedhore të personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose psikosociale, heqja e përgjegjësisë penale për shpifjen, mbulimi i pavarur mediatik gjatë fushatave zgjedhore, raportimi i ndërmjetëm mbi financimin e fushatës dhe zgjerimi i rregullave të financimit të fushatës për të përfshirë edhe palët e treta.

Pas një marrëveshjeje midis dy partive më të mëdha, ndryshimet e vitit 2024, krahas listave ekzistuese të votimit preferencial, shtuan edhe komponentin e listave të mbyllura.⁸ Disa parti më të vogla, përfshirë disa që përfaqësojnë pakicat, e kundërshtuan sistemin e ri në Gjykatën Kushtetuese, duke argumentuar se ai favorizon dy partitë dominuese, minon mundësinë reale që një kandidat nga lista e hapur të fitojë mandat dhe nuk respekton kërkesat kushtetuese për votim preferencial.⁹ Gjykata e rrëzoi ankesën, duke deklaruar se sistemi ishte në përputhje me Kushtetutën.¹⁰

Parlamenti zgjidhet përmes një sistemi proporcional nga 12 zona zgjedhore shumë-emërore që korrespondojnë me rajonet administrative. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore bazohet në popullsinë e saj. Sipas sistemit të ri zgjedhor, çdo parti ose koalicion paraqet një listë të mbyllur, me një numër kandidatësh të barabartë me një të tretën e numrit të mandateve në zonë, dhe një listë preferenciale, me një numër kandidatësh të barabartë me numrin e mandateve në zonë. Mandatet e fituara në një zonë u ndahen fillimisht kandidatëve nga lista e mbyllur, ndërsa mandatet e mbetura u shpërndahen kandidatëve nga listat preferenciale, bazuar në numrin e votave preferenciale që ata marrin. Një parti ose

⁵ Aktet nënligjore përfshijnë Ligjin për Partitë Politike të vitit 2000, Ligjin për Tubimet të vitit 2001, Ligjin për Median Audiovizive të vitit 2013, Ligjin për Garantimin e Integritetit të Personave të Zgjedhur, të Emëruar ose që Ushtrijnë Funksione Publike (Ligji për Dekriminalizimin) të vitit 2015, Ligjin për Barazinë Gjinore të vitit 2008 dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të vitit 2024.

⁶ Në vitin 2023, Shqipëria nënshkroi Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik mbi bashkëpunimin e zgjeruar dhe dhënien e provave elektronike. Shqipëria është anëtare e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

⁷ Gjykata Kushtetuese vendosi që kriteret për shpërndarjen e mandateve parlamentare ishin antikushtetuese, konkretisht pragu i kërkuar për riorganizimin e kandidatëve në listën preferenciale dhe pragu kombëtar prej një për qind i vendosur për kandidatët e pavarur. Një vendim i Gjykatës Kushtetuese i dhjetorit 2022 i kërkoi Parlamentit të ndryshojë brenda një viti kuadrin ligjor për të garantuar zbatimin e të drejtës kushtetuese të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit për të votuar në zgjedhje.

⁸ Ligji për ndryshimin e Kodit Zgjedhor u miratua me 106 vota pro dhe dy kundër, pa konsultim publik.

⁹ Një nga koalicionet më të vogla ka bërë të ditur se kandidatët në listën e saj të mbyllur, nëse zgjidhen, do të japin dorëheqjen për t'i lënë vendin kandidatëve nga lista preferenciale.

¹⁰ Neni 64.3 i Kushtetutës parashikon se "Ligji për zgjedhjet garanton që jo më pak se dy të tretat e listës shumë-emërore t'i nënshtrohen votimit preferencial dhe siguron përfaqësimin gjinor."

koalicion duhet të kalojë pragun kombëtar prej një për qind për t'u kualifikuar për shpërndarjen e mandateve. Kuota gjinore prej një të tretës duhet të respektohet si në të dyja listat ashtu edhe në shpërndarjen përfundimtare të mandateve. Një kandidat i pavarur fiton mandat nëse numri total i votave të vlefshme të marra është i barabartë me një herës elektoral.¹¹

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet administrohen nga KQZ-ja, 93 Komisione të Administrimit Zgjedhor të Zonave (KAZ), dhe 5,225 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi kryhet në nivel rajonal nga Ekipet e Numërimit (EN) në 93 Qendra të Numërimit të Fletëve të Votimit (QNFV), me një QNFV për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ).

KQZ-ja përbëhet nga tre struktura: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) dhe Zëvendëskomisioneri, Komisioni Rregullator (Rregullatori) dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS).¹² Të gjithë anëtarët e KQZ-së zgjidhen nga parlamenti me jo më pak se tre të pestat e votave¹³. Aktualisht, tre nga 12 anëtarët e KQZ-së janë gra. KQZ-ja publikon vendimet dhe të dhënat e saj online dhe transmeton drejtpërdrejt seancat e saj. Ajo i ndan projektaktet me partitë dhe shoqërinë civile përpara miratimit formal dhe kërkon mendimet dhe komentet e tyre për shqyrtim.

KZAZ-të janë përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve në zonat përkatëse, emërimin e anëtarëve të KQV-ve dhe GN-ve, si dhe për nxjerrjen e rezultateve.¹⁴ Çdo KZAZ përbëhet nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote, të propozuar nga shumica dhe opozita parlamentare.¹⁵ Partitë politike mund të tërheqin ose zëvendësojnë anëtarët e tyre në komision sipas dëshirës dhe pa nevojën për arsyetim.¹⁶ Deri më 12 prill, rreth 31 për qind e anëtarëve të KAZ-eve janë gra, çka përmbush kërkesën ligjore. Për të rritur koordinimin në adresimin e shkeljeve të mundshme nëpër KQV, KAZ-et do të caktojnë dy anëtarë të secilës KQV si koordinatorë sigurie.¹⁷

¹¹ Mandatet shpërndahen duke renditur herësit që dalin nga ndarja e numrit të votave të çdo subjekti zgjedhor me pjesëtues të njëpasnjëshëm (1, 2, 3, etj.) deri në numrin total të mandateve në zonën zgjedhore. Garuesit fitojnë aq mandate sa herës të tyre renditen brenda numrit të mandateve të disponueshme. Për kandidatët e pavarur, votat ndahen vetëm me një.

¹² Komisioneri ka kompetenca të gjera ekzekutive dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet e jashtme. Zëvendëskomisioneri mbikëqyr teknologjinë e identifikimit të zgjedhësve, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë. Rregullatori miraton aktet nënligjore, ndërsa KAS shqyrtton ankesat kundër vendimeve të Komisionerit dhe KAZ-eve, vendos mbi pavlefshmërinë e votimit dhe rezultateve të zgjedhjeve, si dhe mund të vendosë sanksione me kërkesë të Komisionerit.

¹³ Neni 13.2 i Kodit Zgjedhor parashikon se të drejtën për të kandiduar ose për t'u propozuar për Komisioner e gëzojnë shtetasit shqiptarë që vijnë nga radhët e ish-zyrtarëve politikë ose të kabinetit, ish-drejtuesve të lartë të administratës ose ish-drejtuesve të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në fushën e zgjedhjeve dhe të të drejtave të njeriut. Kohëzgjatja e mandateve të tyre ndryshon: Komisioneri dhe Zëvendëskomisioneri zgjidhen përkatësisht për mandate shtatëvjeçare dhe katërvjeçare, ndërsa Rregullatori dhe KAS-i përkatësisht për mandate pesëvjeçare dhe nëntëvjeçare.

¹⁴ Qendra të Veçanta të Votimit (QVV) do të ngrihen nëse një KZAZ ka në zonën e saj një institucion penal ose një spital. KQZ-ja ka identifikuar 18 QVV, nga të cilat 16 ndodhen në institucione të vuajtjes së dënimit dhe dy në shtëpi kujdesi për të moshuarit.

¹⁵ KZAZ-të u konstituuan në shkurt 2025 dhe morën trajnim fillestar deri më 8 mars. Tre anëtarë u propozuan nga shumica parlamentare dhe tre nga opozita parlamentare (dy nga partia kryesore në pushtet/opozitë dhe një nga partia e dytë e shumicës/opozitës parlamentare). Anëtari i shtatë propozohet nga partia kryesore në pushtet në gjysmën e KZAZ-ve, dhe nga partia kryesore e opozitës në gjysmën tjetër. Në 93 KZAZ, u emëruan gjithsej 741 anëtarë: 279 nga PD-ja, 279 nga PS-ja, 93 nga PSD-ja dhe 90 nga PL-ja.

¹⁶ Deri më 19 prill, 156 anëtarë të KAZ-eve janë zëvendësuar. Neni II.3.1.f i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, miratuar në vitin 2002, parashikon se "organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lira t'i shkarkojnë ata sipas dëshirës".

¹⁷ Një anëtar do të jetë nga partia më e madhe në parlament dhe një tjetër nga partia e dytë më e madhe.

Përgatitjet zgjedhore janë në proces, dhe deri më tani administrata zgjedhore ka respektuar në masë të madhe afatet e saj ligjore. Pas ndryshimeve të vitit 2024, për herë të parë, shqiptarët që jetojnë jashtë vendit mund të votojnë në zgjedhjet parlamentare. KQZ-ja ka përgjegjësinë për regjistrimin e zgjedhësve jashtë vendit dhe organizimin e procesit.¹⁸

Votimi nga jashtë vendit do të zhvillohet përmes votimit postar dhe KQZ-ja ka zgjedhur DHL-në si ofrues të shërbimit. Zgjedhësit jashtë vendit do të marrin fletët e votimit për zonën zgjedhore të adresës së tyre të fundit të regjistruar në Shqipëri. Shpërndarja e fletëve të votimit është në proces dhe, deri më 19 prill janë dërguar mbi 170,000 nga 245,000 fletë votimi për zgjedhësit jashtë vendit. Që fletët e votimit të numërohen, ato duhet të mbërrijnë në Shqipëri deri më 11 maj, në orën 19:00. Qendra e votimit për votimin nga jashtë vendit pranë KQZ-së në Tiranë është përgjegjëse për përpunimin e fletëve të votimit që vijnë me postë dhe tashmë ka filluar të pranojë fletët e para të votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë vendit. Megjithatë konsiderohet gjerësisht si një reformë historike, përmasat e kësaj nisme kanë ngritur shqetësime të KQZ-ja dhe aktorë të ndryshëm lidhur me sfidat logjistike dhe cenueshmëritë e mundshme në administrimin e këtij procesi.

KQZ-ja ka nisur një strategji gjithëpërfshirëse për edukimin e zgjedhësve me tre fusha kryesore: një fushatë të përgjithshme për të gjithë zgjedhësit, një fushatë të dedikuar për pakicat kombëtare dhe një tjetër për personat me aftësi të kufizuara.¹⁹ Përveç kësaj, KQZ-ja po zhvillon një fushatë informuese për zgjedhësit jashtë vendit. Përmbajtja e edukimit të zgjedhësve shpërndahet përmes televizionit, radios dhe kanaleve të rrjeteve sociale të institucionit.²⁰ KQZ-ja po përdor formate të aksesueshme, si interpretimin në gjuhën e shenjave për spotet televizive dhe ofrimin e informacionit në alfabetin *Braille*.

Sipas Kodit Zgjedhor, zgjedhësit mund të votojnë vetëm duke u paraqitur personalisht në Qendrën e Votimit (QV); votimi me kuti votimi lëvizëse nuk parashikohet. Zgjedhësit me aftësi të kufizuara mund të kërkojnë ndihmë nga një anëtar i familjes ose nga një zgjedhës tjetër brenda qendrës së votimit. Për të asistuar zgjedhësit me aftësi të kufizuara, KQZ-ja do të sigurojë modele fletësh votimi të printuara me relief për zgjedhësit me dëmtim të shikimit dhe kabina votimi të aksesueshme në të gjitha QV-të.²¹ Përveç kësaj, KQZ-ja vazhdon të trajtojë stafin e KZAZ-eve për asistimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

¹⁸ Në total, Rregullatori miratoi pesë rregullore në lidhje me votimin nga jashtë vendit, prej të cilave tre u miratuan në kohë, kurse dy u miratuan me një vonesë prej katër muajsh në mars 2025. Sipas KQZ-së, kjo erdhi si rezultat i përpjekjeve për harmonizimin e këtyre rregulloreve me kuadrin rregullator dhe për të siguruar përputhshmërinë me afatet zgjedhore brenda vendit.

¹⁹ Për të mbështetur informimin e zgjedhësve nga komunitetet e pakicave, KQZ-ja ka përkthyer një pjesë të informacionit zgjedhor në tetë nga nëntë gjuhët e pakicave dhe ka pajisur video-spotet zgjedhore informuese me titra. KQZ-ja deklaroi se materialet nuk u përkthyen në gjuhën egjiptiane për shkak të njohjes së mirë të gjuhës shqipe nga ky komunitet.

²⁰ Fushata informuese e KQZ-së synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi regjistrimin e zgjedhësve, parandalimin e krimeve zgjedhore si shitblerja e votës, qartësimin mbi llojet e veprimtarive të ndaluara, keqpërdorimin e burimeve publike, procedurat e ditës së zgjedhjeve dhe përdorimin e pajisjeve të votimit elektronik. Fushata i kushton gjithashtu vëmendje votimit nga të rinjtë dhe gratë, si dhe nevojave të veçanta të grupeve të cenueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat kombëtare.

²¹ KQZ-ja i ka udhëzuar KZAZ-të që të marrin masa për sigurimin e rampave, sinjalistikën e përshtatshme dhe hyrjen pa pengesa në qendrat e votimit, kudo ku është e mundur. KQZ-ja do të sigurojë sinjalistikë për personat me aftësi të kufizuara në çdo qendër votimi.

Për këto zgjedhje, pajisjet për votim elektronik dhe numërim elektronik të fletëve të votimit do të përdoren në një njësi administrative në secilën nga bashkitë Tiranë dhe Vorë.²² Disa pajisje me ekran të ndjeshëm ndaj prekjes, të cilat funksionojnë *offline*, regjistrojnë votën dhe gjenerojnë kuponë letre për zgjedhësit. Kodi Zgjedhor nuk kërkon shprehimisht auditime apo certifikime të pavarura të sistemeve elektronike. KQZ-ja bashkëpunon ngushtë me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për zbatimin dhe monitorimin e teknologjisë zgjedhore. KQZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se testet e sigurisë për pajisjet e identifikimit elektronik dhe votimit elektronik kanë përfunduar, kurse testimi funksional është planifikuar dy javë para ditës së zgjedhjeve. Demonstrime publike të pajisjeve të votimit janë planifikuar 10 deri në 14 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë. Shtetasit që janë shpallur të paaftë me vendim gjykatë nuk mund të votojnë, gjë që bie ndesh me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin bazuar në aftësinë e kufizuar.²³ Shtetasit që vuajnë një dënim penal për kryerjen e veprave penale të caktuara nuk kanë të drejtë vote.²⁴

Regjistrimi i zgjedhësve për procesin brenda vendit është pasiv. Zgjedhësit mbi 100 vjeç hiqen automatikisht nga listat e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë të dhënat e tyre për t'u përfshirë sërish. Listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) pranë Ministrisë së Brendshme (MB). Zgjedhësit mund të verifikojnë të dhënat e tyre fizikisht në bashki, në shkollë, si dhe *online* deri në ditën e zgjedhjeve. Më pas, kësaj, çdo kërkesë për ndryshim ose përfshirje në listat e zgjedhësve mund të bëhet vetëm përmes gjykatës së rrethit deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve. KQZ-ja publikoi listat përfundimtare të zgjedhësve më 1 prill, me 3,713,761 zgjedhës të regjistruar, përfshirë ata që banojnë jashtë vendit.

Të gjithë zgjedhësit me të drejtë vote që kanë vendbanim jashtë vendit mund të regjistrohen për votimin nga jashtë. Pas një fushate të gjerë informuese përmes internetit dhe televizionit që synonte diasporën, KQZ-ja zhvilloi regjistrimin e zgjedhësve nga 11 janari deri më 4 mars. Për t'u regjistruar, zgjedhësve u kërkohej të ngarkonin dokumentin biometrik shqiptar të identifikimit të lëshuar pas vitit 2009 dhe një dokument që vërtetonte statusin e tyre të vendbanimit jashtë vendit.²⁵ Fillimisht, KQZ-ja kërkonte dokumente identifikimi të vlefshme, por e ndryshoi më pas vendimin në mënyrë që të kishin mundësi të regjistroheshin edhe zgjedhësit me dokumente identifikimi, të cilave u kishte mbaruar afati i vlefshmërisë.²⁶ Lista përfundimtare e zgjedhësve jashtë vendit u publikua më 11 mars me 245,935

²² Votimi dhe numërimi elektronik do të përdoren në gjithsej 75 KQV (31 në Tiranë dhe 44 në Vorë) në vitin 2025. Në vitin 2021, pajisjet u pilotuan për herë të parë në një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) të Tiranës (32 KQV), ndërsa në zgjedhjet vendore të vitit 2023, pajisjet e votimit elektronik u pilotuan në 401 QV në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë. Kodi Zgjedhor (Neni 22, pika 1) përcakton që teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) të zbatohet përmes projekteve pilot, në jo më pak se 10 për qind të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të zbatimit.

²³ Neni 29 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) u kërkon Shteteve Palë të "garantojnë për personat me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët". Shih gjithashtu Paragrafin 48 të Komentit të Përgjithshëm Nr. 1 të nenit 12 të KDPAK-së.

²⁴ Në përputhje me Nenin 45 të Kushtetutës, Ligji për Dekriminalizimin ndalon të drejtën e votës për personat që po vuajnë një dënim penal për kryerjen e veprave të listuara në më shumë se 80 nene të Kodit Penal (duke filluar nga veprat penale që lidhen me zgjedhjet deri te krimet e rënda).

²⁵ Pasaporta shqiptare dhe karta e qëndrimit.

²⁶ KQZ-ja mori një numër të madh kërkesash nga zgjedhësit jashtë vendit në lidhje me skadimin e dokumenteve biometrike të identifikimit shqiptar. Si pasojë, Këshilli i Ministrave, me aktet normative nr. 1 dhe 2, datë 5.2.2025, ndryshoi kriteret e regjistrimit. Rreth 41,000 aplikantë u refuzuan, ndër të tjera, sepse nuk arritën të vërtetojnë adresën e tyre në vendin e banimit.

zgjedhës nga 85 vende.²⁷ KQZ-ja emëroi dy auditues për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Ashtu si në zgjedhjet e mëparshme, identifikimi i zgjedhësve në të gjitha KQV-të në të gjithë Shqipërinë do të bëhet përmes pajisjeve *offline* të identifikimit elektronik që përmbajnë listat e zgjedhësve të të gjitha qendrave të votimit. Zgjedhësit verifikohen duke përdorur pasaportat ose kartat biometrike të identitetit, ku skanimi i gjurmës së gishtit zëvendëson nënshkrimin në letër.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE LISTAT E KANDIDATËVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të kandidojë në zgjedhje, përveç atyre që janë duke vuajtur një dënim penal me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra të caktuara penale. Kjo e drejtë mund t'u kufizohet edhe qytetarëve të dënuar me vendim gjyqësor ende jo të formës së prerë në disa juridiksione, si dhe për individët ndaj të cilëve është lëshuar një urdhër ndërkombëtar arresti ose që janë dëbuar nga shtete të caktuara.²⁸ Përveç kësaj, Kushtetuta përcakton disa kategori zyrtarësh, funksioni i të cilëve është i papajtueshëm me të drejtën për të kandiduar.²⁹

Kandidatët mund të propozohen nga parti dhe koalicione të regjistruara pranë KQZ-së si subjekte zgjedhore, ose të kandidojnë në mënyrë të pavarur. KQZ-ja regjistroi 11 subjekte zgjedhore (tetë parti politike dhe tre koalicione) brenda afatit të 12 marsit. Partitë dhe koalicionet ishin të detyruara të dorëzonin dy lloje listash kandidatësh: një listë të mbyllur me renditje numerike të paracaktuar dhe një listë të veçantë për votimin preferencial. Kandidati mund të paraqitet vetëm në një listë. Kandidatët e pavarur mund të kandidojnë përmes propozimit nga grupe zgjedhësish, por në këto zgjedhje nuk është regjistruar asnjë kandidat i pavarur.³⁰

Kandidatët verifikohen nga KQZ-ja në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Dekriminalizimin.³¹ Subjektet zgjedhore mund të tërheqin dhe zëvendësojnë kandidatë përpara se KQZ-ja të finalizojë listat e kandidatëve. KQZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se gjatë procesit të regjistrimit, 16 kandidatë u skualifikuan mbi bazën e informacionit të paraqitur në formularët e tyre të vetëdeklarimit. Palët e prekura paraqitën kandidatë të rinj pranë KQZ-së.³² Deri në afatin ligjor të 25 marsit, KQZ-ja regjistroi 2,046

²⁷ Grupet më të mëdha të zgjedhësve të regjistruar jashtë vendit ndodhen në Itali, me 91,223 (37.1 për qind), dhe në Greqi, me 68,386 (27.8 për qind). Ndër të tjerët, numër i madh zgjedhësish ndodhet në Gjermani, 25,499 (10.4 për qind), Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 20,653 (8.4 për qind), dhe Mbretërinë e Bashkuar, 17,227 (7 për qind).

²⁸ Ligji për Dekriminalizimin i referohet dëbimit nga një Shtet Anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai gjithashtu përfshin qytetarët e dënuar për disa vepra penale ose të dëbuar, edhe në mungesë të një vendimi përfundimtar gjyqësor nga një Shtet Anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara. Këta persona nuk lejohen të kandidojnë në zgjedhje, ashtu si edhe personat ndaj të cilëve është lëshuar një urdhër ndërkombëtar kërkimi.

²⁹ Presidenti i Republikës, gjyqtarët, prokurorët, ushtarakët, punonjësit e policisë, të sigurisë kombëtare, diplomatët, kryetarët e bashkive, prefektët, kryetarët dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore, si dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj.

³⁰ Një grup prej të paktën nëntë zgjedhësish duhet të regjistrohet pranë KQZ-së për të mbledhur nënshkrime nga një për qind e zgjedhësve në zonën e tyre zgjedhore, por jo më shumë se 3,000. Një kandidat i propozuar nga një grup i tillë nuk mund të jetë i lidhur me ndonjë parti politike apo koalicion që merr pjesë në zgjedhje dhe as ta mbështesë një të tillë. Deputetët aktualë mund të kandidojnë si kandidatë të pavarur, por nuk kanë detyrimin të propozohen nga një grup zgjedhësish.

³¹ Çdo kandidat duhet të dorëzojë një formular vetëdeklarimi, së bashku me dokumente të tjera mbështetëse për kandidaturën. Procesi i verifikimit nga KQZ-ja zhvillohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (Zyra e Gjendjes Gjyqësore) dhe Zyrën e Gjendjes Civile. Procedurat rregullohen nga Ligji për Dekriminalizimin, një akt nënligjor i Kuvendit, si dhe udhëzimet e Komisionerit.

³² Gjastëmbledhjetë kandidatë kishin kryer vepra penale që përbënin pengesë ligjore për kandidim sipas Ligjit nr. 138/2015, pas paraqitjes së informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Pesë nga kandidatët ishin nga Aleanca për Demokracinë e Re, një nga Partia Socialdemokrate, dy nga Lëvizja për Atdheun, një nga Partia e Mundësisë, katër nga Aleanca Kombëtare Shqiptare, dy nga E Djalta për Zhvillim dhe një nga Partia Demokratike.

kandidatë, nga të cilët 787 (38.47 për qind) janë gra. Kodi Zgjedhor kërkon që një në çdo tre kandidatë në të dyja listat t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar.

VIII. MJEDISI I FUSHATËS

Periudha zyrtare e fushatës filloi më 11 prill dhe zgjat 29 ditë, pasuar nga një periudhë heshtjeje 24-orëshe përpara dhe gjatë ditës së zgjedhjeve. Megjithëse jo e ndaluar me ligj, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dukje se fushatë ka pasur edhe në muajt paraardhës, përfshirë edhe jashtë vendit. Për të shënuar fillimin zyrtar të fushatës, disa parti organizuan aktivitete në të gjithë vendin.

Deri tani, fushata ka qenë e qetë, me vizibilitet të kufizuar, përveç materialeve zgjedhore të vendosura në hapësirat publike të përcaktuara. Si PS-ja, ashtu edhe PD-ja kanë organizuar një sërë aktivitete në mëdha në mbarë vendin për të nisur fushatat e tyre. Gjithashtu, ka pasur edhe aktivitete nga parti më të vogla.³³ Sulmet personale mes drejtuesve të partive kryesore janë të zakonshme, përfshirë në rrjetet sociale, ashtu si edhe akuzat e ndërsjella për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar. Partitë më të vogla deklaruan se do të përqendroheshin te kontakti derë më derë dhe rrjetet sociale, megjithatë kanë qenë më pak aktive në këto platforma krahasuar me PS-në ose PD-në.

Temat kryesore në tubime dhe në rrjetet sociale kanë qenë anëtarësimi në BE, ekonomia dhe lufta kundër korrupsionit, ku PD-ka ka akuzuar mazhorancën për keqpërdorim të burimeve shtetërore, blerje votash dhe krime të tjera zgjedhore. PS-ja ka organizuar një sërë aktivitete elektorale të fokusuara te zgjedhëset gra, ku ka pasur pjesëmarrje të gjerë të kandidateve gra. Si PS-ja ashtu edhe PD-ja kanë premtuar rritje të pagës minimale, pensione dhe zgjerim të shërbimeve sociale, ndërsa partitë më të vogla, si Partia Mundësia, Lëvizja "Shqipëria Bëhet", Lëvizja Bashkë dhe Koalicioni Euroatlantik, janë përqendruar te masat kundër korrupsionit, përmirësimi i shërbimeve sociale, pabarazia dhe reformat ekonomike.

Kuadri ligjor ndalon përdorimin e burimeve shtetërore në mbështetje të kandidatëve, partive politike dhe koalicioneve dhe ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore në institucionet publike. Gjatë katër muajve përpara ditës së zgjedhjeve nuk mund të propozohet apo miratohet asnjë akt ligjor që parashikon përfitime.³⁴ Gjatë kësaj periudhe, institucionet publike dhe entitetet shtetërore duhet të raportojnë pranë KQZ-së çdo aktivitet me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe mediave, të cilin KQZ-ja mund ta shpallë si përdorim të mundshëm të burimeve shtetërore. Nëpunësit civilë nuk lejohet të marrin pjesë në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar dhe u ndalohet të shprehin publikisht preferencat e tyre politike. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime lidhur me keqpërdorimin e burimeve shtetërore (përfshirë për votimin nga jashtë vendit), presionin ndaj punonjësve të sektorit publik dhe ndikimin e të ashtuquajturave "rrjete patronazhimi" në votim.³⁵

KQZ-ja informoi gjithashtu MVZ-në e ODIHR-it se, deri më 11 prill, nga aktorë zgjedhorë dhe sinjalizues, ka marrë 94 ankesa për shkelje të lidhura me zgjedhjet, 6 prej të cilave kishin të bënin me përdorimin e aseteve publike, dhe që përfshijnë gjithsej 219 subjekte. KQZ-ja ka nisur hetim

³³ MVZ-ja e ODIHR-it ka vëzhguar 28 aktivitete elektorale, ku 18 ishin folëse gra. 19 nga këto aktivitete ishin të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, por në asnjë prej tyre nuk kishte interpretim në gjuhën e shenjave.

³⁴ Një Vendim i Këshillit të Ministrave i datës 9 janar parashikonte që të gjithë pensionistët në Shqipëri të përfitonin një bonus së bashku me pensionin mujor. Shpërndarja e pagesave prej 10,000 lekësh (afërsisht 100 euro) ose 5,000 lekësh (50 euro), në varësi të nivelit të pensionit, filloi më 1 mars. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it e kritikuan këtë masë si një përpjekje për të ndikuar votën.

³⁵ Vëzhguesit afatgjatë të ODIHR-it morën raportime për keqpërdorim të burimeve administrative. Në Gjirokastrë, Lezhë, Pukë, Shkodër dhe Tropojë u ngritën pretendime për ushtrim presioni ndaj punonjësve të bashkive nga eprorët për të kryer punë në kuadër të fushatës së PS-së. Në 4 nga 13 aktivitetet e hapjes së fushatës të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it (Vlorë, Fier, Peshkopi dhe Has), punonjës të administratës publike deklaruan se u ishte rekomanduar nga eprorët të merrnin pjesë në miting.

administrativ për 70 prej këtyre ankesave, nga të cilat 42 janë përfunduar dhe në 3 raste KQZ-ja i ka propozuar KAS-it vendosjen e gjobave.

KQZ-ja ka emëruar 96 persona për të monitoruar zbatimin e rregullave të fushatës në të 12 zonat zgjedhore. Monitoruesit dorëzojnë raporte javore mbi aktivitetet e garuesve politikë në të gjithë vendin, të cilat përdoren si referencë për verifikimin e deklaratave financiare të tyre, si dhe raportojnë mbi shkeljet e fushatës. Sipas KQZ-së, për periudhën 11 janar - 15 prill, monitoruesit kanë dorëzuar 1,160 raporte. Në këto raporte janë identifikuar 23 shkelje: 12 lidhen me funksionimin e zyrave elektorale brenda një distance prej 300 metrash nga qendrat e votimit, kurse 11 kishin të bënin me materiale të fushatës të paemërtuara qartë si të tilla.

Fushata në rrjetet sociale nuk është e rregulluar shprehimisht dhe nuk ka një autoritet rregullator të përcaktuar me ligj për të monitoruar aktivitetet e fushatës në këto platforma.³⁶ Asnjë nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it nuk ka ngritur shqetësime domethënëse lidhur me ndërhyrje nga jashtë vendit në procesin zgjedhor, pasi ky shihet si një rrezik relativisht i ulët. KQZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se kishte ngritur një njësi të posaçme për të monitoruar llogaritë në rrjetet sociale të 50 institucioneve publike gjatë fushatës.³⁷ Për herë të parë, disa parti politike nënshkruan në mënyrë vullnetare një Kod Sjelljeje për Fushatat Dixhitale, duke u angazhuar të respektojnë standardet etike gjatë fushatës, të mos përdorin gjuhë urrejtjeje, të luftojnë keqinformimin dhe dezinformimin dhe të ruajnë transparencën në reklamat politike.³⁸ Disa OSHC bënë të ditur se do të monitorojnë në shkallë të kufizuar fushatën *online* për të parë nëse do të përdoret gjuhë diskriminuese dhe gjuha e urrejtjes.

Një numër bashkëbiseduesish të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime lidhur me keqpërdorimin e të dhënave personale. Një Ligj për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u miratua në vitin 2024 dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikoi udhëzime mbi përpunimin e të dhënave personale gjatë fushatave zgjedhore. Komisioneri gjithashtu publikoi një deklaratë së bashku me KQZ-në duke u bërë thirrje partive politike për të respektuar detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke ftuar zgjedhësit dhe subjektet zgjedhore të raportojnë shkeljet ose abuzimet përkatëse.³⁹

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës rregullohet kryesisht nga Kodi Zgjedhor në bashkërendim me Ligjin për Partitë Politike. Me përjashtim të vendosjes së një kufiri për vetëfinancimin, dispozitës që përjashton shpenzimet e kandidatëve nga tavani i shpenzimeve totale të subjektit zgjedhor, dhe disa rregullave për raportimin financiar të përfshira në një akt të Komisionit Rregullator, që prej vitit 2020 nuk janë miratuar ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor që lidhet me financimin e fushatës. Në veçanti, rekomandimet kyçe të ODIHR-it lidhur me raportimin e ndërmjetëm financiar, rregullimin e financimit nga palë të treta dhe zgjerimin e financimit publik për të përfshirë edhe kandidatët e pavarur, mbeten të paadresuara.

Subjektet garuese mund të financojnë fushatat e tyre nga fonde publike dhe private. Partitë politike me përfaqësim në parlament marrin fonde nga buxheti i shtetit çdo vit. Partitë që kanë siguruar të paktën një për qind të votave në zgjedhjet parlamentare të mëparshme kanë gjithashtu të drejtë për të përfituar fonde publike për fushatën zgjedhore. Këto fonde shpërndahen në mënyrë proporcionale bazuar në përqindjen

³⁶ Që prej 6 prillit, MVZ-ja e ODIHR-it ka ndjekur aktivitetet e fushatës së 23 garuesve në *Facebook* dhe *Instagram*.

³⁷ Bazuar në këtë monitorim të KQZ-së, për periudhën nga 11 prilli deri më 20 prill, tre postime u konstatua se ishin në kundërshtim me rregulloret e KQZ-së dhe, sipas KQZ-së, u referuan për hetim administrativ.

³⁸ Ky Kod u hartua nga International IDEA, Qendra për Sundimin e Ligjit pranë Universitetit të Helsinkit dhe Instituti Kombëtar Demokratik, në bashkëpunim me KQZ-në, pas konsultimeve me partitë dhe aktorët e interesuar.

³⁹ Shih Deklaratën e Përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të publikuar më 3 shkurt.

e votave të marra. Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të përfitojnë fonde publike. Më 21 mars, KQZ-ja shpërndau 131,301,816 lekë (afërsisht 1,313,000 euro) për njëmbëdhjetë subjekte garuese.

Garuesit mund t'i financojnë fushatat e tyre edhe me fonde të vetat, donacione nga shtetas shqiptarë dhe persona juridikë, si dhe nga kredi bankare. Pas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në vitin 2025, tavanin për përdorimin e fondeve personale nga një garues u rrit nga 1 milion lekë në 3 milion lekë (afërsisht 30,000 euro). Donacionet, përfshirë kontributet në natyrë, kufizohen në 1 milion lekë (afërsisht 10,000 euro), pa kufi për shumën totale të donacioneve që një parti ose kandidat mund të pranojë. Çdo garues duhet të regjistrojë donacionet dhe të identifikojë donatorët në një regjistër të miratuar nga KQZ-ja. Kontributet mbi 50,000 lekë (afërsisht 500 euro) duhet të bëhen përmes një llogarie bankare të dedikuar. Për huatë nuk ka ndonjë tavan dhe as rregullore të veçanta.

Për këto zgjedhje, kufijtë e shpenzimeve për fushatën u rritën nga maksimumi trefish në maksimumin pesëfish të shumës më të lartë të marrë nga një subjekt zgjedhor nga fondet publike. Tavanin për shpenzimet e partive dhe koalicionëve, pa përfshirë kandidatët në listat e tyre, është 326,456,950 lekë (afërsisht 3,300,000 euro), kurse për kandidatët e pavarur - 32,645,695 lekë (afërsisht 330,000 euro). Shpenzimet për aktivitete *online* duhet të raportohen dhe përfshihen në tavanin e përgjithshëm të shpenzimeve të fushatës. KQZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se monitoron reklamën politike të sponsorizuara në *Facebook* të 77 llogarive të garuesve.

KQZ-ja mbikëqyr zbatimin e rregullave për financimin e fushatës dhe në rast shkeljesh vendos sanksione. Garuesit janë të detyruar të dorëzojnë raportet financiare brenda 60 ditëve nga shpallja zyrtare e rezultateve. Të gjitha raportet financiare të fushatës duhet të dorëzohen përmes Platformës Elektronike të Raportimit Financiar në faqen zyrtare të KQZ-së. Për raportim të ndërmjetëm nuk ka ndonjë detyrim. Brenda pesë ditësh nga shpallja e rezultateve, KQZ-ja duhet të emërojë auditues për shqyrtimin e këtyre raporteve. Gjetjet e audituesve duhet të publikohen brenda 30 ditësh nga paraqitja e tyre. Kodi Zgjedhor përmban një listë sanksionesh për shkeljet gjatë fushatës sa i përket financimit.

X. MEDIA

Mungesa e qëndrueshmërisë financiare për shumë media, e shkaktuar nga rënia e të ardhurave nga reklamën dhe nga mungesa e modeleve të zhvilluara alternative të biznesit, ndikon në pavarësinë dhe diversitetin e medias dhe raportimit. Varësia nga financimet jotransparente të interesave të biznesit, shpesh të mbështetura në tenderë publikë, ndikon në rolin mbikëqyrës të medias ndaj pushtetit politik. Për më tepër, përqendrimi i pronësisë së mediave dëmton më tej pluralizmin e burimeve të lajmeve.⁴⁰

Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, gazetarët përballen me ndërhyrje në pavarësinë editoriale dhe ushtrojnë autocensurë. Përveç kësaj, grupet e avokatisë për median raportojnë një sërë sulmesh verbale dhe fizike ndaj gazetarëve.⁴¹ Disa media të themeluara nga shoqëria civile dhe të

⁴⁰ Sipas Monitorit të Pluralizmit të Medias 2024, katër pronarët kryesorë në tregun e transmetimeve kontrollojnë 72 për qind të të ardhurave dhe 87 për qind të audiencës. Ligji për Median Audiovizive kufizon pronësinë e licencave kombëtare të transmetimit deri në 20 për qind në një licencë të dytë kombëtare dhe kufizon pjesën e mbajtësit të një licence kombëtare në tregun e reklamave deri në 30 për qind.

⁴¹ Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias raporto 45 incidente kundër lirisë së medias në vitin 2024. Më shkurt 2024, Gjykata e Lartë e cilësoi të ligjshme sekuestrimin nga SPAK i telefonave dhe kompjuterëve që i përkisnin një gazetari që raportonte mbi një çështje të krimit të organizuar nën hetim nga SPAK. Më pas, organizata ndërkombëtare të medias shprehën shqetësim lidhur me mundësinë e zbulimit të burimeve të gazetarëve, dhe Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut urdhëroi një masë të përkohshme, duke ndaluar përpunimin e mëtejshëm të materialit të sekuestruar deri në një vendim përfundimtar. Vendimi i Gjykatës së Lartë u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese më 22 prill 2025. Gjykata anuloi vendimet e mëparshme që lejonin sekuestrimin e të dhënave kompjuterike dhe pranoi kërkesën e ankuesit për shkatërrimin e të gjitha të dhënave në pajisjet e sekuestruara. Gjykata e cilësoi sekuestrimin si një ndërhyrje të paarsyeshme në lirinë e shprehjes së ankuesit si dhe në të drejtën e publikut për të pasur informacion.

financuara nga donatorë ofrojnë gazetari hulumtuese dhe në interes publik, por janë prekur nga shkurtime të fundit të financimeve ndërkombëtare.

Në përgjithësi, Kushtetuta dhe legjislacioni parashikojnë mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Megjithatë, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, shpifja vazhdon të parashikohet si vepër penale dhe ka pasur një numër të konsiderueshëm çështjesh penale dhe civile për shpifje, përfshirë edhe disa padi gjyqësore strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut (SLAPP), ndaj gazetarëve.⁴² Procedura bipartizane e emërimit të Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) si dhe të Bordit Drejtues të Radio-Televizionit Shqiptar (RTSH) është kritikuar nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it si një procedurë që nuk garanton në mënyrë të mjaftueshme pavarësinë.⁴³

Kodi Zgjedhor parashikon që partitë që kanë fituar mbi 20 për qind të mandateve në zgjedhjet parlamentare të mëparshme të përfitojnë dyfish më shumë mbulim në edicionet informative sesa partitë e tjera parlamentare. Mbulimi i partive joparlamentare është në diskrecionin e transmetuesve, por nuk mund të tejkalojë mbulimin e parashikuar për partitë parlamentare që kanë më pak se 20 për qind të mandateve. Partitë politike kanë të drejtë për kohë transmetimi falas për reklama politike dhe për të blerë kohë reklamimi sipas kushteve të caktuara.⁴⁴ AMA nisi një monitorim vetëm sasior të 29 transmetuesve më 11 prill dhe raporton çdo ditë pranë KQZ-së. KQZ-ja mund të urdhërojë korrigjimin e shkeljeve ose vendosjen e sanksioneve administrative.

Më 8 prill, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin e katër stacioneve televizive dhe tre mediave online. Mediat e monitoruara janë RTSH, TV Klan, Top Channel dhe A2 CNN, si dhe as *panorama.al*, *lapsi.al* dhe *reporter.al*.

XI. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ZGJEDHORE

Kuadri ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore përfshin procedura administrative pasuar nga mundësia për apelim gjyqësor. Ankesat duhet të paraqiten brenda tre ditëve nga marrja e vendimit, përveç ankesave që lidhen me rezultatet e zgjedhjeve, për të cilat afati është pesë ditë, dhe atyre që lidhen me dizajnin e fletës së votimit, të cilat duhet të paraqiten brenda 24 orësh. Vëzhguesit mund të ankimojnë vetëm mohimin e akreditimit të tyre, ndërsa zgjedhësit mund të ankohen për përjashtim nga lista e zgjedhësve, duke iu drejtuar Gjykatës së Rrethit përkatës. Megjithatë, ankesa administrative mund të paraqesin edhe palë të treta që dëshmojnë një interes legjitim, përfshirë organizatat e shoqërisë civile.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve shqyrton në shkallë të parë të gjitha ankesat kundër vendimeve të KQZ-së dhe KZAZ-eve, duke përfshirë edhe ankesat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve ose vlefshmërinë e tyre. Ai ka dy ditë kohë për të marrë vendim mbi ankesat, përveç atyre që lidhen me rezultatet e zgjedhjeve, për të cilat afati është 10 ditë. Me kërkesë të KQZ-së, KAS-i mund të vendosë edhe sanksione. Të gjitha çështjet shqyrtohen në seancë publike, me pjesëmarrjen e palëve të përfshira në të gjitha fazat e procedurës. Deri më 21 prill, KAS-i ka shqyrtuar 13 ankesa kundër vendimeve të

⁴² Një studim i Safejournalists.net raportoi gjithsej 8 çështje penale dhe 65 çështje civile për shpifje në vitin 2023.

⁴³ Më 6 shtator 2024 Drejtori i RTSH-së dha dorëheqjen pas shqetësimeve të ngritura lidhur me funksionet që kishte mbajtur më parë në Partinë Socialiste. Më 17 shkurt 2025, Parlamenti shkarkoi Këshillin Drejtues të RTSH-së për parregullsi në përzgjedhjen e Drejtorit të ri të RTSH-së. Një Këshill i ri Drejtues u emërua më 17 mars. Procedura e aplikimit për Drejtorin e ri përfundoi më 15 prill 2025.

⁴⁴ Sipas një vendimi të KQZ-së të datës 4 prill 2025, dy partitë politike që kanë më shumë se 20 për qind të mandateve kanë të drejtë për gjithsej 90 minuta transmetim falas në televizion dhe radio, ndërsa partitë parlamentare me më pak se 20 për qind të mandateve përfitojnë gjithsej 45 minuta transmetim falas. Partitë joparlamentare marrin 20 minuta transmetim falas. Partive garuese u lejohej të blejnë deri në 90 minuta kohë reklamimi për çdo transmetues, me çmime të barabarta, ndërsa kandidatët në listat preferenciale mund të blejnë deri në 140 minuta kohë transmetimi. Transmetuesit janë të detyruar të ofrojnë gjysmën e kohës së transmetimit të shitur, si kohë shtesë falas për reklamim politik.

KQZ-së, të cilat lidhen ndër të tjera me dizajnin e fletës së votimit dhe disa veprimtari të ndaluara, si dhe një ankesë kundër një vendimi të KZAZ-së. Në tre raste, ai ka pranuar ankesën, ka rrëzuar dy vendime të KQZ-së, ndërsa tre të tjera i ka ende në shqyrtim. Ankesat e tjera nuk i ka pranuar.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (Kolegji Zgjedhor) shërben si autoriteti më i lartë për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të lidhura me zgjedhjet.⁴⁵ Vetëm subjektet zgjedhore mund të ankimojnë vendimet e KAS-it në Kolegji; ankesat duhet të paraqiten brenda pesë ditëve dhe shqyrtohen brenda dhjetë ditëve. Palët e tjera duhet të ndjekin procedurat standarde administrative dhe mund të ankimojnë në Gjykatën Administrative të Tiranës. Ankesat që lidhen me regjistrimin e kandidatëve ose vendimet e Komisionit Rregullator të KQZ-së mund të paraqiten drejtpërdrejt në Kolegji.⁴⁶ Deri më 21 prill, Kolegji Zgjedhor kishte shqyrtuar dhe rrëzuar tre ankesa që lidhen me regjistrimin e partive politike, dizajnin e fletës së votimit dhe përdorimin e pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit. Seancat e Kolegjit Zgjedhor janë publike dhe vendimet duhet të jenë të arsyetuara dhe të publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kodi Zgjedhor parashikon një gamë të gjerë shkeljesh administrative, të cilat KQZ-ja mund t'i hetojë *ex officio* ose pas paraqitjes së raportimeve përmes një portali *online* të dedikuar. Kodi Penal parashikon 15 vepra penale që lidhen me zgjedhjet, shumica e të cilave janë në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme. SPAK-u ka juridiksion mbi rastet e korrupsionit zgjedhor të kryera nga kategori të caktuara të zyrtarëve të lartë publikë ose rastet e lidhura me krimin e organizuar. Për herë të parë, SPAK-u ka ngritur një task-forcë hetimore dhe ka nisur një platformë *online* për raportimin e veprave penale zgjedhore. Një protokoll bashkëpunimi ndërmjet SPAK-ut, KQZ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme lehtëson shkëmbimin e informacionit për krimet zgjedhore.

XII. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Në Shqipëri njihen nëntë pakica kombëtare.⁴⁷ Sipas regjistrimit të vitit 2023, rreth 2.5 për qind e popullsisë identifikohet si pjesë e një pakice kombëtare. Kushtetuta garanton të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat, dhe Kodi Zgjedhor garanton të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur për të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht prejardhjes etnike, racës, fesë ose gjuhës.⁴⁸ Disa parti të pakicave pretendojnë se sistemi zgjedhor favorizon në mënyrë të pajustificuar dy partitë më të mëdha dhe kufizon mundësitë e partive më të vogla për të fituar mandate.

Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare konfirmon të drejtën e personave që u përkasin pakicave kombëtare për të themeluar dhe për të marrë pjesë në parti politike, shoqata dhe organizata të tjera civile. Një parti e pakicës kombëtare (pakica greke) është e përfaqësuar në parlamentin aktual, me vetëm një deputet.⁴⁹ Për zgjedhjet e vitit 2025, kandidojnë dy parti të pakicave kombëtare, që të dyja si pjesë e koalicionit të drejtuar nga PD-ja.⁵⁰ Fushata në gjuhët e pakicave kombëtare lejohet me ligj. KQZ-ja po përgatit disa materiale zgjedhore në gjuhët e pakicave kombëtare. Shumë nga çështjet e ngritura nga përfaqësuesit e pakicave që u takuan me MVZ-në e ODIHR-it lidhen me probleme që prekin popullsinë

⁴⁵ Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për një mandat katërvjeçar. Kolegji aktual u emërua në shtator 2024. Trupa gjyqëse për çdo çështje përbëhet nga pesë gjyqtarë të përzgjedhur me short.

⁴⁶ Për ankesat jashtë periudhës që fillon 48 orë pas shpalljes së zgjedhjeve, afati i procedurës administrative prej 30 ditësh zbatohet si për paraqitjen e ankesës, ashtu edhe për marrjen e vendimit nga KAS-i ose Kolegji Zgjedhor.

⁴⁷ Arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, rome dhe serbe.

⁴⁸ Shqipëria është palë në Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, por jo në Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.

⁴⁹ Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.

⁵⁰ Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Evropian dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.

në tërësi, si të drejtat pronësore, ndërsa komunitetet rome dhe egjiptiane raportojnë edhe për diskriminim socio-ekonomik.

XIII. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve në të gjitha nivelet nga vëzhgues vendas dhe vëzhgues ndërkombëtarë. Deri më 11 prill, ishin akredituar 26 organizata kombëtare dhe 10 organizata ndërkombëtare. Organizatat e vëzhguesve vendas do të dërgojnë si vëzhgues afatgjatë ashtu edhe afatshkurtër në të gjithë vendin për të ndjekur procesin zgjedhor dhe do të përqendrohen në keqpërdorimin e burimeve publike, funksionimin e administratës zgjedhore dhe financimin e fushatës. OSHC-të informuan MVZ-në e ODIHR-it se mungesa e fondeve ka kufizuar kapacitetin e tyre për të kryer një vëzhgim gjithëpërfshirës në ditën e zgjedhjeve. Subjektet zgjedhore, pasi regjistrohen, mund të caktojnë nga një vëzhgues pranë KAZ-eve dhe KQV-ve përkatëse, si dhe pranë çdo tavoline të numërimit të votave.

XIV. AKTIVITETET E MVZ-SË SË ODIHR-IT

MVZ-ja e ODIHR-it u hap në Tiranë me një konferencë për shtyp më 2 prill 2025. MVZ-ja është takuar me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, KQZ-në, SPAK-un, Prokurorinë e Përgjithshme, AMAN, drejtues dhe përfaqësues të partive politike, shoqërisë civile, medias, si dhe me anëtarë të komunitetit diplomatik dhe ndërkombëtar. Vëzhguesit afatgjatë kanë zhvilluar takime me aktorët në nivel lokal. Asambleja Parlamentare e OSBE-së, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe Parlamenti Evropian kanë njoftuar se do të dislokojnë delegacione vëzhguesish. Kryetari i Radhës i OSBE-së ka emëruar Farah Karimi (deputete, Holandë) si Koordinatorë të Posaçme të misionit.

*Versioni anglisht është i vetmi dokument zyrtar.
Ky raport është i disponueshëm dhe në gjuhën shqipe.*



azhbr_al and 3 others

Original audio



azhbr_al Edited • 7w

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ju informojnë se thirrja për aplikime në Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi për vitin 2025 hapet më 14 prill dhe do të qëndrojë e hapur deri më 30 maj.

Skema përfshin 8 masa mbështetëse:

- 1 Mbështetje për tufën bazë të matrikulluar të gjedhëve
- 2 Mbështetje për tufën bazë të



861 likes

April 9



Add a comment...



More posts from azhbr_al





EKONOMI

AZHBR hap aplikimet gjatë fushatës: 44 milionë euro për lopët, delet dhe kecat për zgjedhje

Publikuar: 13/04/2025



Në kulmin e fushatës dhe zgjedhjeve parlamentare të 11 majit, qeveria ka hapur një tjetër skemë për të vjelë vota. Në datën 14 prill 2025 do të hapen aplikimet për skemat e mbështetjes në bujqësi dhe blegtori, ku bujqit apo firmat që merren me keca, dele, lopë apo që kanë mbjellë kastraveca, specat, domate, etj., do të mund të marrin një kompensim nga shteti.

Kjo është një nismë gjysmake e qeverisë, e cila ka vendosur kritere të dyshimta për t'a përfutur, teksa ajo që bie në sy është se këto para do të përdoren gjatë zgjedhjeve. Ashtu siç ndodh me pensionistët apo edhe në fusha të tjera, ku qeveria synon t'u marrë votën bujqve apo blegtorëve me kacidhe.



Prapaskena

per bujqit, teksa parat e IPARD-it tu anane oligarkëve dhe politikanëve. Dhe, duke qenë se programi IPARD është bllokuar, qeveria shpërndaj para' për disa kultura bujqësore apo kope me lopë, dele apo dhi.



MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL Nr. <u>2500</u> Prot. Datë <u>28.03</u> 2025	MINISTRIA E FINANCËVE Nr. <u>5589</u> Prot. Datë <u>84</u> 2025
U D H Ë Z I M Nr. <u>14</u> , datë <u>28.01</u> 2025	
PËR PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR MASAT MBËSHTETËSE PËR VITIN 2025	
Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025" dhe të VKM nr. 150, datë 6.3.2025, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përlimitit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025", ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave,	
UDHËZOJNË:	

Foto më sipër është njoftimi që ka bërë Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, e famshmja për shpërdorim fondesh AZHBR, për çeljen e skemës së mbështetjes së vitit 2025.

"Skema kombëtare e mbështetjes në bujqësi 2025. Hapja e aplikimeve do të bëhet më 14 prill 2025 dhe do të vazhdojë deri më datë 30 maj 2025"



Prapaskena

ç'njohet me abuzime të rënda me shpërndarjen e parave në bujqësi e blegtori, abuzime të cilat çuan në mbylljen e skemës së BE-së IPARD.

Mësohet se, koha në të cilën është hapur, përkon me fushatën dhe zgjedhjet, teksa menjëherë kanë filluar edhe shpërndarja nga deputetë dhe kryetar bashkish të kësaj skeme. Më shumë se para për bujqit, duket se skema do të jetë një mjet tjetër për “patronazhistët” apo edhe firmat që janë pranë qeverisë.

VENDIM Nr. 150, datë 6.3.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2025 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zeri “Transfer të në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), përdoret për:

- ritjen e konkurrencshmërisë së prodhimeve bujqësore në mjedis të mbrojtura, të bimëve mjekësore dhe aromatike e të prodhimeve blegtorale, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për sipërfaqe të kultivuar dhe për kafshë të matrikulluara;
- mbështetjen e fermerëve nëpërmjet pagesave për uljen e kostos për naftën që përdoret, për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;
- certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;
- mbështetjen e formave të kooperimit në bujqësi.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1. Bujqësia dhe blegtoria

- Pagesa për gjedh të matrikulluar, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë lopë/mëshqerrë dhe deri në 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë viça për fermer/aplikant, me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë gjedhe.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfutimit zvogëlohet me 50%, përfshijë rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor (në vijim SHBB)”;.

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim aplikantët me status “Grup fermerësh” dhe “SHBB”, të cilët përfitojnë vlerën maksimale të financimit të parashikuar në këtë vendim, edhe kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse.

4. Për aplikimet në masat mbështetëse, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2.1, kryhet kontrolli në terren për verifikimin faktik të numrit të krerëve, në jo më pak se 30% të subjekteve përfituese.

Çdo subjekt, në rastet kur verifikohet se ka përfutur më shumë se 20% nga vlera për të cilën plotëson kriteret, përjashtohet 3 (tre) vjet nga e drejta e përfutimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

5. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët individualë, grupet e fermerëve, personat fizikë e juridikë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

6. Ngrahkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEXSI 1
KULTURA BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT, NORMATIVAT E KONSUMIT TË
NAFTËS DHE VIÇERA QË PËRFITTOHET



deri voxnews, qeveria ka marrë një vendim me numër 150 më datë 6 mars 2025 për “përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025”.

Mësohet se fondi për bujqit është 44 milionë euro, teksa është rreth 8 milionë më pak se një vit më parë. Në vendim përcaktohet se fondi do të përdoret për mbështetjen e fermerëve nëpërmjet pagesave për uljen e kostos për naftën që përdoret, për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike, mbështetjen e formave të kooperimit në bujqësi.

Do të jepen para për gjedhët, tufat me dele, dhi dhe lopë. Do të jepen për grupe fermash, sera. Por edhe këtu ka shumë masa përjashtuese, pasi nëse do të kesh më pak se 100 dele ose dhi, nuk përfiton. Madje, nëse ke më shumë se 300 krerë, përfitimi zvogëlohet në masën 50 %.

Duhet të kesh më shumë se 1 hektarë me perime, rrush apo luleshtrydhe që të përfitosh. Por, nëse ke më shumë se 5 hektarë, masa përgjysmohet! E njëjtë edhe për bimët aromatike, ku përfitojnë ata që kanë nga 1 deri në 10 hektarë. Më pak se 1 hektarë nuk përfiton dhe nëse ke më shumë se 10 hektarë përfiton gjysmën.

Kriteret e vendosura përjashtojnë shumë bujq të vegjël, teksa janë vendosur klauzola që vetëm ekspertët e AZHBR-së mund ti zhbirilojnë.

Po përse tani?! Nëse VKM-ja e mësipërme doli më 6 mars, ministria e Bujqësisë dhe ajo e Financave kanë nxjerrë udhëzimin më datë 28 mars, disa ditë para çeljes së fushatës. Një skemë e cila më shumë do të përdoret për propagandë, kryesisht në Qarkun e Fierit dhe Beratit. Fakti që VKM-ja është



Belinda Balluku's Post



Belinda Balluku

April 22



Një diskutim i hapur me fermerë të Roskovecit 🧑🏻🧑🏻, tek 'Rinaldi', një nga pikat e grumbullimit më të mëdha në zonë 📍. Transformimi i sektorit sot është një realitet, por ka ende shumë për të bërë për të ndihmuar e lehtësuar fermerët 🙌, mundi i të cilëve po jep një kontribut të pazëvendësueshëm në zhvillimin e sektorit 📈. Përmes dialogut 🗣️ dhe bashkëpunimit të ngushtë do të mund të adresojmë çdo sfidë. Bashkë ja dalim 🤝.



+12



Comment as Marash Logu







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 06 Maj 2025

Drejtuar: **Z. Altin DUMANI**
Drejtues i Prokurorisë së Posaçme

Ambasadori Lamberto ZANNIER
Shefi i misionit vëzhgues të zgjedhjeve i ODIHR

Tiranë

I nderuar z. Drejtues i Prokurorisë së Posaçme,
I nderuar z. Ambasador Zannier,

Më lejoni fillimisht të shpreh vlerësimin tim maksimal për strukturat që ju drejtoni dhe rolin që ato kanë në garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Në kuadër të zgjedhjeve të 11 Maj, dua të shpreh shqetësimin tim të thellë për rolin e Policisë së Shtetit, në qarkun Fier, që përbëjnë një ndërhyrje brutale të shtetit në zgjedhje dhe një shpërdorim të qartë të autoritetit policor.

Sot, më datë 06 Maj, Drejtori i Policisë së qarkut Fier Skënder Hitaj, në një mbledhje pune informale me drejtues të policisë në qarkun Fier, ka urdhëruar vartësit e tij që të ndjekin, mbajnë në vëzhgim në mënyrë të paligjshme dhe të inskenojnë ngjarje mbi disa prej kandidatëve të Partisë Demokratike të Shqipërisë në qarkun Fier (konkretisht Gentian Koçi, Silva Hasaj, Samena Malenaj, Gentian Çela, etj.), përfshirë edhe drejtuesin politik të qarkut Gazment Bardhi. Gjithashtu, target i veprimeve të paligjshme të Policisë janë urdhëruar të bëhen edhe disa prej drejtuesve të strukturave tona apo mbështetësve tanë më aktiv.

Prej ditësh, Policia e Shtetit me urdhër të Drejtorit Hitaj, ka nisur një fushatë friksimi të kandidatëve dhe mbështetësve tanë. Kudo ku kandidatët tanë takojnë qytetarë, menjëherë pas tyre paraqiten në banesat e qytetarëve punonjës të Policisë së Shtetit që

ushtrojnë persion ndaj tyre që të inkriminojnë kandidatët tanë apo të heqin dorë nga mbështetja për PD, ndryshe do të kenë pasoja.

Nga ana tjetër, punonjësit e Policisë së Shtetit janë urdhëruar që të shoqërojnë dhe marrin në mbrojtje grupet e punonjësve të administratës publike që janë prej muajsh tashmë në zonë dhe që janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme të blerjes së votës, kryesisht në zonën e Fierit de Mallakastrës, ku procesi intensiv është urdhëruar të nis ditën e nesërme (datë 7 Maj).

Kjo ndërhyrje brutale dhe e paligjshme e Policisë së Shtetit, si dhe shfaqja e anshmërisë politike nga ana e tyre, kërkon ndërhyrjen tuaj të menjëhershme për të mbajtur nën monitorim të posaçëm të gjithë veprimtarinë e Policisë së Shtetit në qarkun Fier, kryesisht të Drejtorit dhe të Nëndrejtorëve të qarkut.

Duke shprehur bindjen e plotë që ky shqetësim i yni do të trajtohet dhe verifikohet me mënyrat dhe metodat tuaja të pavarura, mbetem besimplotë që Ju do të merrni çdo masë për të garantuar një proces të drejtë dhe të lirë zgjedhor në Shqipërinë e vitit 2025.

Me respekt,

D E P U T E T I

Gazment BARDHI¹



¹ Njëkohësisht Drejtues Politik i Partisë Demokratike dhe kandidat për deputet në qarkun Fier



Tiranë, më 06.03.2025

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga kryetarja e Bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi dhe marrjen e sanksioneve administrative.

Drejtuar: **Z. Ilirjan CELIBASHI**
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

I Nderuar Zoti Komisioner,

Në datën 24.01.2025, Bashkia Roskovec ka njoftuar tenderin me objekt *“Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në Njësinë administrative Strum”*, me vlerë fondi limit 59.111.172 lekë ose rreth 600 mijë euro. Tenderi është zhvilluar në datën 10.02.2025 dhe fitues është shpallur shoqëria “Caushi M” sh.p.k., në datën 17.02.2025, me ofertë fituese në vlerën 41.083.400 lekë plus TVSH. Kontrata parashikon një kohëzgjatje 6-mujore. Vihet re se kjo procedurë prokurimi është njoftuar, zhvilluar dhe shpallur fituesi i saj pas datës 11 janar 2025, që përkon në periudhën e ndalimeve për disa veprimtari të caktuara, të cilat vlerësohet se kanë për qëllim që të ndikojnë vullnetin e zgjedhësve në favor të një kandidati apo partie politike, e në rastin konkret në favor të Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj.

Kodi Zgjedhor parashikon ndalimin e përdorimit ose vënien në mbështetje të kandidatëve dhe partive politike të burimeve të organeve apo enteve publike në nivel qendror dhe vendor. Në kuptim të këtij parashikimi, me burim do të kuptohet çdo aset i luajtshëm ose i paluajtshëm (shih nenin 91, pikat 1 dhe 2). Më tej, Kodi Zgjedhor parashikon se institucionet publike, qendrore dhe vendore janë të detyruara të raportojnë të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve. Në rast se konstatohet se veprimtaria publike përbën keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë KQZ urdhëron ndalimin e saj (shih nenin 92, pikat 1 dhe 4).

Në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe me qëllim detajimin e tyre, Komisioni Rregullator ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik..., sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”* (në vijim “Vendimi nr. 9/2020”). Ky vendim ka për qëllim që në periudhën katër muaj para zgjedhjeve të garantojë paanshmërinë dhe trajtimin e barabartë të kandidatëve dhe partive politike, duke krijuar kushte të drejta e të barabarta për të gjitha subjektet që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake (shih nenin 1, pika 1).

Më tej, Vendimi nr. 9/2020 ka përcaktuar se veprimtari të ndaluara konsiderohen ato për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë



mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut. Kryetari i bashkisë e ka të ndaluar të drejtojë, marrë pjesë apo të kontribuojë në çfarëdo formë në veprimtari të ndaluara (shih nenin 3, pika 1.1, gërma “a”, dhe pikën 2).


Detyrimi i kryetarëve të bashkive për të organizuar menjëherë punën dhe marrë masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e institucioneve shtetërore/publike, si dhe të burimeve njerëzore në nivel qendror e vendor, rrjedh edhe nga neni 7, pika 1, gërma “a”, e Vendimit nr. 9/2020. Në të kundërt, neni 10 i Vendimit nr. 9/2020 parashikon listën e sanksioneve administrative që vendosen nga KQZ-ja.

Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se kryetarja e Bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi, me qëllim të qartë për të mbështetur dhe favorizuar Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj në zgjedhje, ka njoftuar, zhvilluar dhe shpallur fituesin e një procedure prokurimi publik për rikonstruksionin e rrugëve të Njësisë administrative Strum, e cila ka një numër prej 7577 zgjedhësish ose rreth 30% e totalit të zgjedhësve të Bashkisë Roskovec, referuar të dhënave zyrtare për zgjedhjet vendore të vitit 2023. Zhvillimi i kësaj procedure prokurimi publik dhe fillimi i zbatimit të saj në periudhën e ndalimeve 4 muaj para zgjedhjeve përkon me fenomenin e njohur si “asfalti elektorat”.

Në këto kushte, është e qartë se burimet financiare, paratë e taksapaguesve të Bashkisë Roskovec, po përdoren me qëllim që të ndikohet, manipulohet apo tjetërsohet vullneti i tyre për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, nëpërmjet këtij investimi që nuk synon ndërtimin e mirëfilltë të infrastrukturës rrugore (me problematika të theksuara në këtë bashki), por vetëm riparimin e shtresave të rrugëve, siç dëshmohet qoftë nga objekti i tenderit, ashtu edhe nga kohëzgjatja e kontratës. 600 mijë euro fonde publike në mbështetje të fushatës së Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj është e qartë nuk krijojnë kushtet për një garë të drejtë dhe të barabartë ndërmjet kandidatëve dhe partive politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje.

Përkundrazi, siç ka rezultuar edhe nga raportet e OSBE/ODIHR-it në dy zgjedhjet e fundit (2021 dhe 2023) kemi të bëjmë me një përdorim flagrant të burimeve shtetërore në mbështetje të partisë në pushtet, e cila përkon edhe me partinë që drejton aktualisht Bashkinë e Roskovecit. Në këto kushte, në mbështetje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 3, 7, 10 të Vendimit nr. 9/2020, kërkojmë konstatimin e kryerjes së veprimtarive të ndaluara dhe marrjen e sanksioneve administrative ndaj kryetares së Bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi.

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
Av. Marash LOGU


2



Partia
Demokratike

Tiranë, më 12 Shkurt 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht miratimi i akteve nënligjore dhe propozimi për dhënie të ndihmave për një kategori të caktuar para fushatës zgjedhore dhe shpërdorimi i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po çenohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.
2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor. [...].

Në vijim gjeni shkeljet e kryera nga Bashkia Fier në kuadër të zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 maj 2025:

- I. Përdorimi i aseteve publike dhe burimeve njerëzore për organizimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Festojmë me emigrantët fierak në Greqi"

Partia Demokratike ka marrë dijeni nëpërmjet publikimeve të shumta në media se Bashkia Fier ka organizuar para disa ditësh një tender për organizimin e një "feste" me emigrantët fierakë në Greqi, e maskuar si aktivitet kulturor, duke nisur në këtë formë krimin zgjedhor.

Sipas burimeve mediatike, shpenzimet për këtë aktivitet do të konsistojnë në shpenzime pagese për 3 këngëtarë fierak, shërbim transporti autobus 30 vende dhe shpenzime për koordinatorin e ngjarjes.

Sipas deklaratës së Kryetarit të Bashkisë Fier Armando Subashi në lidhje me këtë aktivitet është shprehur *"E anuluar sepse nuk kishim bërë njoftimin pesë ditë përpara në KOZ. Aktiviteti në Athinë u zhvillua, por pa bashkinë"*.

Partia Demokratike ngre shqetësimin dhe dyshimin se për organizimin e këtij aktiviteti do të përdoren burimet publike. Nga ana tjetër, organizimi i këtij aktiviteti në Greqi do të thotë se do të kishte takim me diasporën. Në këtë drejtim, Partia Demokratike ngre dyshime të arsyeshme se në këtë takim me zgjedhësit, të deleguarit nga Bashkia Fier do të tentojnë të ndikojnë në bindjen politike të zgjedhësve. Përndryshe, për çfarë qëllimi do të organizonte Bashkia Fier një aktivitet të tillë në Greqi pikërisht para fushatës zgjedhore? Përse duhet të jepte deklaratë Kryetari i Bashkisë Fier për një aktivitet në të cilin Bashkia nuk ka qenë prezent?

Ne dyshojmë se Bashkia Fier ka qenë organizatore e këtij aktiviteti dhe ka përdorur burimet publike, megjithatë nuk ka qenë prezente. Në rast të kundërt, nëse Bashkia Fier nuk do të ishte as organizatore dhe nuk do të kishte interesa të lidhura me këtë aktivitet, Kryetari i Bashkisë nuk kishte arsye përse të jepte deklaratë dhe të shprehej për këtë rast.

Sipas dokumenteve të siguruar nga mediat, Drejtoria e Artit dhe Kulturës në Bashkinë Fier, e drejtuar nga Ardjana Mile, ka hapur më 6 janar 2025 një tender me objekt: "Festojmë me emigrantët fierakë në Greqi." Fituesi është shpallur më 8 janar dhe përfshin:

- Shërbim transporti me autobus për 30 persona
- Angazhimin e 3 këngëtarëve fierakë për një koncert të organizuar në Greqi
- Një koordinator për organizimin e eventit

Sipas përshkrimit në dokumentet e tenderit, aktiviteti është një bashkëpunim me shoqatën "Bashkimi i fierakëve në Greqi – Apolonia" dhe ka për qëllim "krijimin e një atmosfere festive dhe nostalgjike për vendlindjen." Megjithatë, koha e organizimit dhe përmbajtja e projektit ngrejnë pyetje të mëdha për qëllimin e vërtetë të tij.

Zgjedhja për ta organizuar këtë aktivitet para fushatës zgjedhore ngjall dyshime të forta për përdorimin e këtij event si një mjet për të mobilizuar votat e emigrantëve. Pra, Bashkia Fier përdor burimet publike para fushatës zgjedhore për të siguruar mbështetjen elektorale nga emigrantët, duke kryer njëkohësisht dy krime zgjedhore.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

"Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të puluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me



përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim".

Në kuptim të nenit 91, pika 1 dhe 2 Bashkia Fier është ka përdorur si asetet publike po ashtu edhe burimet njerëzore,

Ne dyshojmë se qëllimi i realizimit të këtij aktiviteti është realizuar më së miri dhe mendojmë se Bashkia Fier mund të ketë deleguar persona mbështetës, persona civil të kahut politik që Bashkia Fier përfaqëson. Partia Demokratike kërkon zbardhjen e këtij rasti.

Në këto kushte, Partia Demokratike kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëngjitur po ju vendosim LINK të postimit denoncues.

<https://prapaskena.com/2025/01/13/bashkia-fier-tender-me-sfond-elektoral-feste-me-emigrantet-fierake-ne-greqi/>

<https://publik.al/skandal-ne-prag-te-zgjedhjeve-bashkia-fier-organizon-festa-zgjedhore-me-emigrantet-ne-greqi/>

Në këto kushte, Partia Demokratike po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht :

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këto raste nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PER PARTINE DEMOKRATIKE
Përfaqësues i PD në KQZ

Franci NURI



(https://publik.al/)



Përgjimet/Si...



Nëse e kërko...



Huffington P...



Bushka përd...



Fier/Shiste k...



Rama tregon...



Rama i inato...



Sea

Skandal në prag të zgjedhjeve: Bashkia Fier organizon "festa" zgjedhore me emigrantët në Greqi

2025-01-13



FISH CITY & ROZAFI RESTAURANT



(https://www.facebook.com/FISH.CITY.ROZAFI/)

Zgjedhjet parlamentare të majit 2025 duket se kanë vënë në lëvizje makinerinë elektorale të mazhorancës, e cila po shfrytëzon burimet publike për të siguruar votat e emigrantëve shqiptarë. Një shembull i freskët është Bashkia Fier, e cila ka hapur një tender për organizimin e një "feste" me emigrantët fierakë në Greqi, e maskuar si aktivitet kulturor, por që duket qartazi një lëvizje elektorale.

Tenderi për "festime" në Greqi: Një maskim zgjedhor

(https://publik.al/)



REPUBLIK E ALBANIË
BASHKIA E FIET
DREJTORIA E ARTIT DHE KULTURËS

Nr. _____ Prot. _____
Fier, më 06.01.2025

Formulari nr.3**FTESË PËR OFERTË**

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri : Drejtorja e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier

Adresa : Lagjja "1 Maj", Rruga "Jani Bakalli" Fier.

Tel/Fax 0692230141;

E-mail : _____

Faqja e Internetit : _____

Autoriteti kontraktor Drejtorja e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: **"Festojmë me emigrantët fierakë Në Greqi"**.

Data e zhvillimit do të jetë **08/01/2024, ora 13:30** në adresën: **www.app.gov.al**; Drejtorja e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

Nr.	Emri i shpenzimit	Njësia /copë, persona
1	Koncerti fierak	1
2	Koncerti fierak	1
3	Koncerti fierak	1
4	Shërbim Transporti Autobuz 30 Vende	1
5	Kordinatori	1

Ky projekt vjen si bashkëpunim me Shoqatën "Bashkimi i fierakëve në Greqi "Apolonia". Për të krijuar atmosferë festive, por edhe nostalgjie për vendlindjen, në kuadër të aktivitetit të parë të vitit 2025, kërkohet që koncerti festiv, i cili është aktiviteti kryesor i projektit, të realizohet me këngëtarët më të dashur fierakë, që **bëhen pjesë për herë të parë e festimeve me emigrantët**.

Drejtorja e Artit dhe Kulturës, Turizmit dhe Promovimit kërkon që në event të marrin pjesë:

1. Të jenë tri banda muzikore fierake dhe ato të kërkuara nga Shoqata "Bashkimi i fierakëve në Greqi"
2. Bandat muzikore të këndojnë live
3. Minutazhi i kërkuar është 1 orë
4. Çdo bandë duhet të ketë foninë me vete dhe sipas parametrave teknike



Sipas dokumenteve të siguruara, Drejtoria e Artit dhe Kulturës në Bashkinë Fier, e drejtuar nga Ardjana Mile, ka hapur më 6 janar 2025 një tender me objekt: "Festojmë me emigrantët fierakë në Greqi." Fituesi është shpallur më 8 janar dhe përfshin:

- Shërbim transporti me autobus për 30 persona.
- Angazhimin e 3 këngëtarëve fierakë për një koncert të organizuar në Greqi.
- Një koordinator për organizimin e eventit.

Sipas përshkrimit në dokumentet e tenderit, aktiviteti është një bashkëpunim me shoqatën "Bashkimi i fierakëve në Greqi – Apolonia" dhe ka për qëllim "krijimin e një atmosfere festive dhe nostalgjike për vendlindjen." Megjithatë, koha e organizimit dhe përmbajtja e projektit ngrejnë pikëpyetje të mëdha për qëllimin e vërtetë të tij.

(https://publik.al/)

Pse festohet tani, kur festat kanë mbaruar?

Edhe pse fundviti dhe festat tradicionale kanë përfunduar, Bashkia Fier ka nxituar të organizojë këtë aktivitet në prag të fushatës zgjedhore. Në një situatë normale, një organizim festiv do të kishte ndodhur gjatë periudhës së festave të fundvitit, por zgjedhja për ta organizuar tani ngjall dyshime të forta për përdorimin e këtij eventit si një mjet për të mobilizuar votat e emigrantëve.

A po përdoren fondet publike për qëllime elektorale?

Ky aktivitet ngre shqetësime serioze për përdorimin e parave të taksapaguesve fierakë për një organizim që duket më shumë si pjesë e një strategjie elektorale. Në një kohë kur Shqipëria përballet me probleme të mëdha ekonomike dhe sociale, shpenzimi i fondeve publike për një "feste" në Greqi është një tallje me qytetarët e thjeshtë.

Rikthimi i skemave të presionit mbi administratën dhe emigrantët

Ky rast kujton skandalin e drejtorit të Teatrit Bylis, Klajdi Marku, i cili dha dorëheqjen pas pjesëmarrjes së detyruar në një takim të kryeministrit Rama me emigrantët në Greqi. Asokohe, Marku deklaroi publikisht se ishte "detyruar" të merrte pjesë, ndërsa dorëheqja e tij erdhi për të ruajtur imazhin personal dhe profesional. Tashmë, Bashkia Fier duket se po rikthen të njëjten praktikë, por këtë herë në formën e një organizimi të maskuar festiv.

Çfarë thotë dokumentacioni?

Dokumentet e tenderit tregojnë detaje për organizimin e aktivitetit, përfshirë:

- Performanca live nga tri banda muzikore fierake, të cilat duhet të kenë foninë me vete.
- Një koncert me këngëtarë lokalë që do zgjasë një orë.
- Bashkëpunim me shoqatën e emigrantëve fierakë për të garantuar pjesëmarrjen.

Por asnjë justifikim logjik nuk sqaron pse ky aktivitet po organizohet tani dhe çfarë "festash" po kremtohen në mes të janarit, jashtë çdo kalendarit tradicional.

Kërkohet transparencë dhe ndëshkim për keqpërdorimin e fondeve publike

Ky skandal është një tjetër dëshmi se mazhoranca po përdor çdo mjet, përfshirë burimet shtetërore, për të siguruar mbështetjen elektorale. Shqiptarët, brenda dhe jashtë vendit, meritojnë një proces të drejtë dhe transparent, jo manipulime të tilla të hapura.

Institucionet përgjegjëse dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të ndërhyjnë për të garantuar që fondet publike të mos përdoren si mjet elektorale. Në një vend që aspiro standardet evropiane, abuzimet e tilla janë të papranueshme.

Publikuar nga Publik Media

Huffington Post: Gjërat nuk po shkojnë mirë për Edi Ramën



FISH CITY & ROZAFa RESTAURANT



(https://www.facebook.com/FISH.CITY.ROZAFa/)



AKTUALITET

Bashkia Fier tender me sfond elektoral, festë me emigrantët fierakë në Greqi!

Publikuar: 13/01/2025



Zgjedhjet e parlamentare të muajit maj 2025 kanë futur në "ethe" punonjësit e administratës lokale dhe qendrore. Punonjësit e thjeshtë janë "detyruar" të plotësojnë formularët me të afërmit në diasporë, pasi për herë të parë emigrantët do votojnë. Por, kjo ka sjellë një riorganizim të strukturave partiake, ku mazhoranca duket se ka angazhuar gjithë "flotën" për të evidentuar apo "detyruar" emigrantët që t'a votojnë.

Disa muaj më parë, drejtori i Teatrit Bylis në Fier, Klajdi Marku, ishte prezent në takimin e kryeministrit Edi Rama në Greqi. Madje, ai tha se është “detyruar” që të shkojë në këtë takim. Pas videos që u bë virale, Marku dha dorëheqjen, teksa e motivoi këtë lëvizje “për të ruajtur imazhin personal dhe të artistit”.

Aktualisht, Bashkia e Fierit ka gjetur një zgjidhje për organizimin e emigrantëve. Bashkia ka nisur procedurat për zhvillimin e një tenderi për udhëtim në Greqi, me arsyetimin se është festiv! Por, kur festat kanë mbaruar, nuk kuptohet se për çfarë do të festohet në Greqi. Aq më tepër një takim që vjen para zgjedhjeve nuk është festiv, por një organizim i mirëfilltë zgjedhor. *Përse po shpenzohen paratë e taksapaguesve fierakë për këtë takim partiak?*

REPUBLICA E SHqipërisë
BASHKIA E FIER
DREJTORIA E ARTIT DHE KULTURËS

Nr. _____ Prot.
Fier, më 06.01.2025

Formulari nr.3

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri : Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier
Adresa : Lagja "1 Maj", Rruga "Jani Bakalli" Fier.
Tel/Fax 0692230141;
E-mail : _____
Faqja e Internetit : _____

Autoriteti kontraktor Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt:
"Festojmë me emigrantët fierakë Në Greqi".

Data e zhvillimit do të jetë 08/01/2024, ora 13:30 në adresën:
www.app.gov.al; Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier.
Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia /copë, persona
1	Këngëtar fierak	1
2	Këngëtar fierak	1
3	Këngëtar fierak	1
4	Shërbimi Transporti Autobuz 30 Vende	1
5	Kordinatori	1

Ky projekt vjen si bashkëpunim me Shoqatën "Bashkimi i fierakëve në Greqi "Apolonia". Për të krijuar atmosferë festive, por edhe nostalgjie për vendlindjen, në kuadër të aktivitetit të parë të vitit 2025, kërkohet që koncerti festiv, i cili është aktiviteti kryesor i projektit, të realizohet me këngëtarët më të dashur fierakë, që *bëhen pjesë për herë të parë e festimeve me emigrantët.*

Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Turizmit dhe Promovimit kërkon që në event të marrin pjesë:

1. Të jenë tri banda muzikore fierake dhe ato të kërkuara nga Shoqata "Bashkimi i fierakëve në Greqi"
2. Bandat muzikore të këndojnë live
3. Minutazhi i kërkuar është 1 orë
4. Çdo bandë duhet të ketë foninë me vete dhe sipas parametrave teknike

Faksimile: Dokumentet e tenderit të Bashkisë së Fierit "festojmë me emigrantët fierakë Në Greqi"

Drejtorja e Artit dhe Kulturës në Fier ka si drejtuese znj. Ardjana Mile, teksa kanë varësi direkt edhe Qendra e Aktiviteteve Kulturore (ish shtëpinë e Pioneerit), Teatrin Bylis, Muzeu Historik, Galerinë e Artit dhe Bibliotekën.

Sipas dokumenteve, kjo drejtori ka hapur në datë 6 janar 2025 tenderin me objekt "festojmë me emigrantët fierakë në Greqi". Fituesi është shpallur në datë 8 janar, teksa ka një shpjegim shpenzimi ku kërkohen 3 këngëtarë fierak, shërbim transporti me autobus në 30 vende dhe një kordinator.

"Ky projekt vjen si bashkëpunim me shoqatën 'Bashkimi i fierakëve në Greqi 'Apolonia'. Për të krijuar atmosferë festive, por edhe nostalgjie për vendlindjen, në kuadër të aktivitetit të parë të vitit 2025, kërkohet që koncerti festiv, i cili është aktiviteti kryesor i projektit, të realizohet me këngëtarët më të dashur fierakë, që bëhen pjesë për herë të parë e festimeve me emigrantët" thuhet në këto dokumente.

Sipas saj, Drejtorja e Artit dhe Kulturës, Turizmit dhe Promovimit kërkon që në event të marrin pjesë "tri banda muzikore fierake dhe ato të kërkuara nga Shoqata 'Bashkimi i fierakëve në Greqi'". Sipas tyre, bandat muzikore të këndojnë live dhe minutazhi i kërkuar është 1 orë. **"Çdo bandë duhet të ketë foninë me vete dhe sipas parametrave teknike të kërkuara"** shkruhet në dokumentet e tenderit.

13:21 ▲

79% ■



Posts

About

Photos

More ▼



Gazeta Drenica

Jan 13 · 🌐



Bashkia Fier tender me sfond elektoral, festë me emigrantët fierakë në Greqi!

Zgjedhjet e parlamentare të muajit maj 2025 kanë futur në "ethe" punonjësit e administratës lokale dhe qendrore. Punonjësit e thjeshtë janë "detyruar" të plotësojnë formularët me të afërmit në diasporë, pasi për herë të parë emigrantët do votojnë. Por, kjo ka sjellë një riorganizim të strukturave partiake, ku mazhoranca duket se ka angazhuar gjithë "flotën" për të evidentuar apo "detyruar" emigrantët që t'a votojnë.

Disa muaj më parë, drejtori i Teatrit Bylis në Fier, Klajdi Marku, ishte prezent në takimin e kryeministrit Edi Rama në Greqi. Madje, ai tha se është "detyruar" që të shkojë në këtë takim. Pas videos që u bë virale, Marku dha dorëheqjen, teksa e motivoi këtë lëvizje "për të ruajtur imazhin personal dhe të artistit".

Aktualisht, Bashkia e Fierit ka gjetur një zgjidhje për organizimin e emigrantëve. Bashkia ka nisur procedurat për zhvillimin e një tenderi për udhëtim në Greqi, me arsyetimin se është festiv! Por, kur festat kanë mbaruar, nuk kuptohet se për çfarë do të festohet në Greqi. Aq më tepër një takim që vjen para zgjedhjeve nuk është festiv, por një organizim i mirëfilltë zgjedhor. Përse po shpenzohen paratë e taksapaguesve fierakë për këtë takim partiak?

Drejtorja e Artit dhe Kulturës në Fier ka si drejtuese znj. Ardjana Mile, teksa kanë varësi direkt edhe Qendra e Aktiviteteve Kulturore (ish shtëpinë e Pioneerit), Teatrin Bylis, Muzeu Historik, Galerinë e Artit dhe Bibliotekën.

13:22 ▲

79%



Posts

About

Photos

More ▼

Sipas dokumenteve, kjo drejtori ka hapur në datë 6 janar 2025 tenderin me objekt "festojmë me emigrantët fierakë në Greqi". Fituesi është shpallur në datë 8 janar, teksa ka një shpjegim shpenzimi ku kërkohen 3 këngëtarë fierak, shërbim transporti me autobus në 30 vende dhe një kordinator.

"Ky projekt vjen si bashkëpunim me shoqatën 'Bashkimi i fierakëve në Greqi 'Apolonia'. Për të krijuar atmosferë festive, por edhe nostalgjie për vendlindjen, në kuadër të aktivitetit të parë të vitit 2025, kërkohet që koncerti festiv, i cili është aktiviteti kryesor i projektit, të realizohet me këngëtarët më të dashur fierakë, që bëhen pjesë për herë të parë e festimeve me emigrantët" thuhet në këto dokumente.

Sipas saj, Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Turizmit dhe Promovimit kërkon që në event të marrin pjesë "tri banda muzikore fierake dhe ato të kërkuara nga Shoqata 'Bashkimi i fierakëve në Greqi'". Sipas tyre, bandat muzikore të këndojnë live dhe minutazhi i kërkuar është 1 orë. "Çdo bandë duhet të ketë foninë me vete dhe sipas parametrave teknike të kërkuara" shkruhet në dokumentet e tenderit.



E-mail :

Faqja e Internetit :

Autoriteti kontraktor Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt:

13:22 ▲

79%



Posts About Photos More ▼

që koncerti festiv, i cili është aktiviteti kryesor i projektit, të realizohet me këngëtarët më të dashur fierakë, që bëhen pjesë për herë të parë e festimeve me emigrantët" thuhet në këto dokumente.

Sipas saj, Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Turizmit dhe Promovimit kërkon që në event të marrin pjesë "tri banda muzikore fierake dhe ato të kërkuara nga Shoqata 'Bashkimi i fierakëve në Greqi'". Sipas tyre, bandat muzikore të këndojnë live dhe minutazhi i kërkuar është 1 orë. "Çdo bandë duhet të ketë foninë me vete dhe sipas parametrave teknike të kërkuara" shkruhet në dokumentet e tenderit.



E-mail :

Faqja e Internetit :

Autoriteti kontraktor Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt:
"Festojmë me emigrantët fierakë Në Greqi".

Data e zhvillimit do të jetë 08/01/2024, ora 13:30 në adresën:
www.app.gov.al; Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier.
Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

Nr.	Lloji i shpërndimit	Njësia / cepi, person
-----	---------------------	-----------------------



Like



Comment



Send



Share



Gazeta Drenica

Jan 13 · 🌐





Tiranë, më 18.03.2025

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga kryeministri Edi Rama, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku dhe kryetari i Bashkisë Divjakë Josif Gorrea, dhe marrjen e sanksioneve.

Drejtuar: **Z. Ilirjan CELIBASHI**
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

I Nderuar Zoti Komisioner,

Në datën 17.03.2025, ora 13:45, kryeministri Edi Rama ka postuar në profilin e tij në rrjetin social Facebook një postim me titull *“Divjakë – Në kantierin e rrugës Gurë-Remas”, me përmbajtje si vijon: “Divjakë – Në kantierin e rrugës rurale Gurë-Remas, një investim i Fondit Shqiptar të Zhvillimit që do të lidhë Gurin dhe Remasin, si dhe do të lidhet me rrugën e Karavastasë, duke lehtësuar jetesën e banorëve që jetojnë aty, por edhe duke hapur perspektiva të reja të zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit në këto zona.”*¹ Postimi është shoqëruar edhe me video, ku shfaqet kryeministri, së bashku me ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, si dhe kryetari i Bashkisë Divjakë, Josif Gorrea, duke inspektuar punimet e një rruge.

Në të njëjtën datë, ora 18:16, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ka postuar në profilin e saj në rrjetin social Facebook një postim me përmbajtje: *“Divjakë, aty ku po punohet për rehabilitimin e rrugës Gurë-Remas, me një gjatësi prej afro 3.2 km. Një ndërhyrje e cila do ta sjellë këtë rrugë në parametrat e duhur, duke ju shërbyer të gjithë banorëve të zonës, e veçanërisht do të lehtësojë ndjeshëm fermerët. Investim i FSHZH, përmes të cilit hapen perspektiva të reja për zhvillimin e mëtejshëm të të gjithë zonës.”*² Postimi është shoqëruar edhe me foto, ku shfaqet ministrja, kryeministri dhe kryetari i Bashkisë Divjakë, duke inspektuar punimet e një rruge.

Kodi Zgjedhor parashikon ndalimin e përdorimit ose vënien në mbështetje të kandidatëve dhe partive politike të burimeve të organeve apo enteve publike në nivel qendror dhe vendor. Në kuptim të këtij parashikimi, me burim do të kuptohet çdo aset i luajtshëm ose i paluajtshëm (shih nenin 91, pikat 1 dhe 2). Më tej, Kodi Zgjedhor parashikon se institucionet publike, qendrore dhe vendore janë të detyruara të raportojnë të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve. Në rast se konstatohet se veprimtaria publike përbën keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë KQZ urdhëron ndalimin e saj (shih nenin 92, pikat 1 dhe 4).

Në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe me qëllim detajimin e tyre, Komisioni Rregullator ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik..., sjelljes dhe përdorimit të*

¹ <https://www.facebook.com/ediramaal/videos/1032673081660605>

² https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=1087057526795580&id=100064740292189&mibextid=wwXlfr&rdid=x8RjbK3t4y8AikFz#



burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” (në vijim “Vendimi nr. 9/2020”). Ky vendim ka për qëllim që në periudhën katër muaj para zgjedhjeve të garantojë paanshmërinë dhe trajtimin e barabartë të kandidatëve dhe partive politike, duke krijuar kushte të drejta e të barabarta për të gjitha subjektet që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake (shih nenin I, pika 1).

Më tej, Vendimi nr. 9/2020 ka përcaktuar se veprimtari të ndaluara konsiderohen ato për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut. Kryeministri, ministri dhe kryetari i bashkisë e kanë të ndaluar të drejtojnë, marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme në veprimtari të ndaluara (shih nenin 3, pika 1.1, gërma “a”, dhe pikën 2).


Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se kryeministri Edi Rama, ministrja Belinda Balluku, kryebashkiaku Josif Gorrea, me qëllim të qartë për të mbështetur dhe favorizuar Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, në Bashkinë Divjakë dhe më tej në Qarkun e Fierit, kanë drejtuar, marrë pjesë dhe kontribuar në promovimin e investimit që po kryhet për ndërtimin e rrugës Gurë-Remas, Divjakë. Kjo veprimtari ka pasur karakter publik dhe ka pasur për qëllim që të ndikojë zgjedhësit në Bashkinë Divjakë, Qarkun e Fierit dhe më gjërë, duke treguar punën që është duke u kryer nga qeveria dhe bashkia në infrastrukturën e qytetit të Divjakës. Megjithatë, kryerja e investimeve në infrastrukturë është detyrë funksionale e zyrtarëve organizator dhe pjesëmarrës në këtë aktivitet, promovimi i këtij investimi është përdorur për të ndikuar, manipuluar dhe tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025.

Ashtu siç ka rezultuar edhe nga raportet e OSBE/ODIHR-it në dy zgjedhjet e fundit (2021 dhe 2023) kemi të bëjmë me një përdorim flagrant të burimeve shtetërore në mbështetje të Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj, e cila përkon me partinë që drejtohet nga kryeministri Edi Rama, dhe ku bëjnë pjesë ministrja Belinda Balluku dhe kryebashkiaku Josif Gorrea. Në këto kushte, në mbështetje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 3, 7, 10 të Vendimit nr. 9/2020, kërkojmë konstatimin e kryerjes së veprimtarive të ndaluara dhe marrjen e sanksioneve administrative ndaj kryeministrit Edi Rama, ministres Belinda Balluku dhe kryebashkiakut Josif Gorrea.

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga:

Av. Marash LOGU



2



Nr. 247 Prot.

Tiranë, më 24 Mars 2025

- Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)
- Lënda:** Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, nepermjet shpalljes së procedurave të prokurimit para fushatës zgjedhore
- Baza Ligjore:** Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po çenohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....".

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se **Bashkia Roskovec ka shpallur procedurat e prokurimit "Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare": Faza 1 "Punime për bazamentin e fushës së futbollit"** para fushatës zgjedhore.

Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) është publikuar njoftimi për shpalljen e procedurave të prokurimit me këto të dhëna:

- *Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Roskovec*
- *Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e hapur*
- *Objekti i kontratës: "Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregtare": Faza 1 "Punime për bazamentin e fushës së futbollit"*
- *Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-40758-03-11-2025*
- *Fondi limit: 20 708 484.26 Lek pa Tvsh*
- *Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj*
- *Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 27/03/2025 Ora 09:00*

Shpallja e procedurave të prokurimit publik para fushatës zgjedhore është veprimtari e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Pika 1 dhe 2 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor parashikon:

"Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore"

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...".

Në kuptim të kësaj dispozite, Bashkia Roskovec po përdor asetet publike para fushatës zgjedhore.

Neni 3 pika 4 e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon:

"4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor".

Për këto arsye, vlerësojmë se shpallja e kësaj procedure nga ana e Bashkisë Roskovec para fushatës zgjedhore është veprim i kryer në shkelje flagrante të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Qëllimi i kësaj procedure është tërësisht politik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe mobilizimin e votave të zgjedhësve.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Partia Demokratike kërkon nga institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëngjitur po ju vendosim LINK të postimit denoncues (faqja 22 e dokumentit).

<https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=3d1a7cbb-7414-45ae-a625-f3dca46d4227>

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, **duke kërkuar përfundimisht:**

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

**PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ**

Franci NURI





Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 2 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, nëpërmjet shpalljes së procedurave të prokurimit Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re” nga Bashkia Patos

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 “E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në” parashikon se:
“1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....”.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Bashkia Patos ka shpallur procedurat e prokurimit “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re” para fushatës zgjedhore.

Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) është publikuar njoftimi për shpalljen e procedurave të prokurimit me këto të dhëna:

- Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Patos
- Lloji i procedurës së prokurimit: Tender i hapur
- Objekti i kontratës: Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re
- Numri i referencës së procedurës: REF-42101-03-20-2025
- Fondi limit: 40,572,556 Lek pa Tvsh
- Kohëzgjatja e kontratës: 5 muaj
- Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 07/04/2025 Ora: 11:00

~~Shpallja e procedurave të prokurimit publik para fushatës zgjedhore është veprimtari e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.~~

Pika 1 dhe 2 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...".

Në kuptim të kësaj dispozite, rruga konsiderohet **aset publik** dhe Bashkia Patos po përdor asetet publike para fushatës zgjedhore.

Neni 3 pika 4 e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon:

"4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor".

Për këto arsye, vlerësojmë se shpallja e kësaj procedure nga ana e Bashkisë Patos para fushatës zgjedhore është veprim i kryer në shkelje flagrante të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Qëllimi i kësaj procedure është tërësisht politik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe mobilizimin e votave të zgjedhësve.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Partia Demokratike kërkon nga institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëngjitur po ju vendosim LINK të postimit denoncues (faqja 28 e dokumentit)

<https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=ed8bcc46-19fc-4134-9512-c6f29db3317a>


Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, **duke kërkuar përfundimisht:**

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi Ligjor i PD-ASHM në KQZ

Franci NURI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot.

Patos, më ____ / ____ / 2025

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

AGJENCISË SË PROKURIMEVE PUBLIKE TIRANË
OPERATORËVE EKONOMIKË

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri: Bashkia Patos

Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza, Patos.

Tel/Faks: 0686228214

E-mail: info@bashkiapatos.gov.al/ floriankita1@gmail.com

Ueb-faqe: www.bashkiapatos.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Florian Kita

E-mail: floriankita1@gmail.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Tender i hapur.

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes Kuader: Punë.

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-42101-03-20-2025.

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re".

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punë ndërtimore 45.

8. Fondi limit: 40,572,556 (dyzet milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale për vitin 2024-2025.

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumenteve të tenderit: Bazuar në pikën 2 të nenit 75 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "*Per prokurimin publik*" ku citohet "*2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce*", pas koordinimit të APP-së, njesia e prokurimit vendsoi të hartojë shtojcën për modifikimin e kriterëve.

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:

Nuk ka shtim afati.

ISHTE:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40,572,556 (dyzetë million e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë)** lekë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

BËHET:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40,572,556 (dyzetë million e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë)** lekë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Shënim:

Periudha tre vjecare 2022, 2023, 2024 i referohet edhe procesverbalit të argumentimit.

ISHTE:

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të balanceve të viteve financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

BËHET:

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të balanceve të viteve financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara

me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Shënim:

Periudha tre vjeçare 2022, 2023, 2024 i referohet edhe procesverbalit të argumentimit.

ISHTE:

2.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

BËHET:

2.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çili operator ekonomik duhet të disponojë punonjësin, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Ndryshohet te Specifikimet teknike:

Përsa i përket specifikimeve AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit **SSH/UNI/ISO**, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

NJESIA E PROKURIMIT



Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Nr. 286 Prot.

Tiranë, më 4 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht përdorimit të aseteve publike dhe promovimit të veprave në fushën e infrasktrukturës nga Bashkia Fier

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së...."

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Bashkia Fier ka filluar të shtrojë "asfaltin elektoral". Kjo ngjarje shoqërohet me foto, të cilat lehtësisht vërtetojnë shkeljen ligjore të kryer nga Bashkia Fier.

Bazuar në nenin 23 pika 4 e ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" parashikon: "Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore"

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ngre shqetësimin dhe dyshimin se rehabilitimi dhe shtrimi i rrugëve para fushatës zgjedhore është një tentativë nga ana e Bashkisë Fier për të ndikuar dhe përfituar votat e banorëve. Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM dyshon se kjo veprimtari e kryer para fushatës zgjedhore bëhet për qëllime politike dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe synon manipulimin e votave të zgjedhësve.

Kjo veprimtari është e ndaluar sipas Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, i cili parashikon:

"Neni 3

Veprimtari të ndaluara

1 Në zbatim të këtij vendimi:

1.1 "Veprimtari të ndaluar për tu promovuar janë" veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjitikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, ai edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet..."

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

"Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit....".

Në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, rruga cilësohet të jetë burim/aset publik dhe përdorimi i saj për të mbështetur një subjekt zgjedhor të caktuar përbën shkelje të Kodit Zgjedhor.

Për këto arsye, vlerësojmë se veprimtaria e rehabilitimit të rrugëve para fushatës zgjedhore është kryer në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe ka sfond propagandistik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe mbi të gjitha kërkon të ndalohej ndikimi në votën e zgjedhësve. Kujtojmë se jetojmë në një rend demokratik ku vota është e lirë dhe e fshehtë. Askush dhe në asnjë formë nuk mund të ndikojë në bindjen personale të zgjedhësve.

Ndaj, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore. Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni foto të shkeljeve të kryera.

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.


Duke ju falenderuar,

PËR KOALICIONIN


PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ

z. Franci NURI


































Belinda Balluk



'a



May 4 at 4:52 PM ·

Në Cakran, ku ka përfunduar investimin për rehabilitimin e p...
See more

Në Cakran, ku ka përfunduar investimi për rehabilitimin e plotë të rrugës hyrëse

 1.3K

144 39K

Like

Comment

 Share

Comments

Hide

Most relevant



Gabriel Isufaj · 1:27

Fut një parakolp makine kësaj
hajvanes,se ka shkelje të kodit
rugor po ecën në mes të rrugës
injorantia!!

...

3w Like Reply



Gjysho Meçaj · 1:23

Si per cudi tani mbaroi ajo

• •

3w Like Reply

View 1 reply

[View more comments](#)

2 of 137



Comment as Marash Logu





Belinda Balluku's Post



Belinda Balluku

April 23 · 🌐



Me @sefaeriselda në Plug të Lushnjes, ku po punohet për rehabilitimin e plotë të rrugës dhe pajisjen e saj me të gjithë elementët urbanë, ndriçim dhe trotuarë. 🚧 ➡️
Një investim i FSHZH, në shërbim të banorëve dhe zhvillimit të zonës. 🏡✅



+3

👍 1.6K

75 comments 109 shares



Comment as Marash Logu





LAJME (HTTPS://WWW.SYRI.NET/LAJME/) WEB TV (HTTPS://WWW.SYRI.NET/WEB-TV/) OP-ED (HTTPS://WWW.SYRI.NET/OP-ED/)
BLOG (HTTPS://WWW.SYRI.NET/BLOG/) SPORT (HTTPS://WWW.SYRI.NET/SPORT/) KOSOVA (HTTPS://WWW.SYRI.NET/KOSOVA/)
JETË/STIL (HTTPS://WWW.SYRI.NET/JETE-STIL/) RAJONI (HTTPS://WWW.SYRI.NET/RAJONI/) BOTË (HTTPS://WWW.SYRI.NET/BOTE/)
KURIOZITETE (HTTPS://WWW.SYRI.NET/MISTERE/) SHENDET (HTTPS://WWW.SYRI.NET/SHENDET/)
ARTE & MEDIA (HTTPS://WWW.SYRI.NET/ARTE-MEDIA/) PLUG (HTTPS://WWW.SYRI.NET/PLUG/)
MARKETING (MAILTO:MARKETING@SYRI.NET) +355697009690 (TEL:+355697009690)

syri

(https://www.syri.net/)



NGA ALFRED LELA

Thika e urimit të Ambasadës amerikane

(https://www.syri.net/op-ed/791541/thika-e-urimit-te-ambasades-amerikane/)



NDRIÇIM KULLA

Ne nuk jemi një popull atipik, që të votonim sërish një klikë e cila e la pa njerëz Shqipërinë

(https://www.syri.net/op-ed/791524/ne-nuk-jemi-nje-popull-atipik-qe-te-votonim-serish-nje-klike-e-cila-e-la-pa-njerez-shqiperine/)

Të detyruar për të ndjekur mitingun e kryeministrit, Rama grumbullon patronazhis...



f 'Piranjat' faktojnë skemën e

(https://www.facebook.com/laajmi.syri.net/)

u=https://www.syri.net/2Fpolitike%2F780119%2Fpiranjat-

skemën e krimit elektoral të PS-së!

Administrata e Fierit me

pahir në Tiranë në koncertin

e Ramës

https://www.syri.net/2Fpolitike%2F780119%2Fpiranjat-

skemën e krimit elektoral të PS-së!

Administrata e Fierit me

pahir në Tiranë në koncertin

e Ramës

https://www.syri.net/2Fpolitike%2F780119%2Fpiranjat-

skemën e krimit elektoral të PS-së!

Administrata e Fierit me

pahir në Tiranë në koncertin

e Ramës

https://www.syri.net/2Fpolitike%2F780119%2Fpiranjat-

skemën e krimit elektoral të PS-së!



Emisioni investigativ "Piranjat" i erdhi në ndihmë SPAK-ut, duke zbuluar se drejtuesit politikë të qarkut Fier nuk e kanë aspak frikë SPAK-un dhe as ndiejnë presion nga Prokuroria e Fierit se mund të jeten për krime zgjedhore.

Grupi i xhirimit të "Piranjave", së bashku me gazetaren Avi Mema, ndodhej në autobusin që solli njerëz nga Fieri në Tiranë për mitingun e hapjes së fushatës elektorale të PS-së më 12 prill.

ADMINISTRATA-
me-
fieri-
pahir-

FIERIT- LEXO EDHE:
PANJAT- 'Jemi bërë si autoshkollë', Beqaj në gjyq për
PAHIR- 'Sterilizimin': S'bëj dot mbrojtje efektive pa një akuzë të
SHKRUAR (https://www.syri.net/politike/791561/jemi-bere-si-autoshkolle-beqaj-
 ne-gjyq-per-sterilizimin-sbej-dot-mbrojtje-efektive-pa-nje-akuze-te-
 shkruar/)
TERANE- Pa kush ishte në autobusin e PS-së?
KONCERNI (https://www.syri.net/politike/791562/terane-pa-kush-ishte-ne-autobusin-e-ps-se-
 rames%2F)
RAMES%2F)

"Kishte persona me lista që thërrisnin një për një emrat për të hipur në autobus. Ajo që është e paligjshme është se ata ishin punonjës të administratës së Fierit, dhe gjatë dy orëve që ishim në autobus, kishte edhe persona që ishin sjellë nga këta punonjës. Pra, atyre jo vetëm që u ishte bërë presion për të qenë të pranishëm në mitingun e Tiranës, por edhe për të sjellë familjarët e tyre. Hareja, këngët dhe vallet ishin thjesht fasada e shëmtuar e mitingut të hapjes së fushatës së PS-së në Sheshin 'Skënderbej', pasi pamë një mungesë të theksuar dëshire nga ana e njerëzve për të qenë aty – ata ishin të detyruar për të ruajtur vendin e punës së tyre apo të familjarëve," tha gazetarja për emisionin "Kafe Shqeto" në SYRI TV.

Gjatë udhëtimit për në Tiranë, Piranjat kanë folur me njerëz të thjeshtë, hallexhinj, dhe gjatë bisedave me ta kanë arritur të dokumentojnë me zë dhe figurë se si persona me pushtet i kanë detyruar të marrin pjesë në mitingun elektoral të PS-së, ose për t'u punësuar, ose për të ruajtur një vend pune – në kundërshtim me ligjin.

"Është faktuar me video, prova dhe me zë se si njerëzit janë të detyruar të shkojnë në këtë miting. Ka edhe nga ata që pranojnë se kanë pasur premtime të herëpashershme për një vend pune dhe kishin shpresë se pas prezencës në mitingun hapës do të merrnin një telefonatë për një punësim," tha gazetarja.

Investigimin e plotë të "Piranjave" do ta ndiqni të premten në orën 20:44 në SYRI TV.

Pas këtyre provave të paraqitura nga "Piranjat", është radha e drejtësisë të veprojë pa vonesë për zbrëthimin e kësaj skeme kriminale elektorale.

© SYRI.net



Lexo edhe:



KAS zhvillon nesër seancë publike për shqyrtimin e ankimimeve të PD-së për zgjedhjet në Berat, Gjirokastrë dhe Vlorë
 (https://www.syri.net/politike/791584/kas-zhvillon-neser-seance-publike-per-shqyrtimin-e-ankimimeve-te-pd-se-per-zgjedhjet-ne-berat-gjirokastrer-dhe-vlore/)



Sterilizimi/ Gjykim i shkurtuar për të gjithë të pandehurit, përveç Ilir Beqajt...
 (https://www.syri.net/politike/791567/sterilizimi-)



(https://aleancaetike.media/raporto-syri-net/)

më të lexuarat

Drejtoresha e fondacionit të njohur gjerman: BE po e toleron autokratin Rama vetëm prej qendrave të azilantëve

(https://www.syri.net/politike/791041/drejtoresha-e-fondacionit-te-njohur-gjerman-be-po-e-toleron-autokratin-rama-vetem-prej-qendrave-te-azilanteve/)



Gazment Bardhi's Post



Gazment Bardhi

April 12 · 🌐



✕ Të detyrosh punonjësit e administratës që të marrin pjesë në miting është krim elektoral!

✕ T'u premtosh njerëzve vende pune në këmbim të votës, është krim elektoral!

🔊🔊🔊 Shikoni kameran e fshehtë që emisioni "Piranjat" ka realizuar sot me autobuzat e sjellë nga qarku Fier për të mbushur sheshin bosh të Edi Ramës dhe Belinda Ballukut. Janë dëshmi që SPAK-u nuk mund t'i injorojë!

!?! Keqardhje për SPAK-un që nuk arrin të zbulojë as sa "Piranjat" nga krimet elektorale që po kryhen në qarkun e Fierit, në drejtimin e Belinda Ballukut!

Jo vetëm metodat e paligjshme në shkelje të ligjit elektoral nga Balluku por sidomos arroganca e saj në komunitet dhe me vetë socialistët, janë për nga lloji të ngjashme me çizme pushtuesish!

Fieri dhe administrata publike do të çlirohet nga kjo më 11 Maj!



0:29 / 2:51



Bernard Banushi and 343 others

31 comments 105 shares



Like



Comment



Send



Share

Most relevant



Nori Bracja

O beqoviç celibashoviç ramoviç berishoviç + partiçka = ppshe = bashkpunëtor të serbit



Comment as Marash Logu



Belinda Balluku's Post



Belinda Balluku

May 1 at 3:21 PM



Me të rinjtë inxhinierë që i janë bashkuar skuadrës së Albpetrol, përmes programit të punësimit të profesionistëve të rinj.

Kënaqësi që brezat e rinj, të sapodiplomuar, kanë zgjedhur të japin kontributin e tyre në një sektor me shumë sfida, por shumë të rëndësishëm për ekonominë tonë.

Prezenca e tyre sot është garancia më e madhe e vazhdimësisë, ndërsa planet tona parashikojnë mbështetje edhe më të madhe me investime në mënyrë që ky sektor të marrë zhvillimin që i takon.



+6



Comment as Marash Logu



QV	EMER MBIEMER I PERSONIT QË KËRROJN TE PUNËSOHET	ARSHIVI / PROFESIONI	KOMENTE	PUNËSIMI I MËPARSHËM	CV	PRIORITETI	PUNËSIMI I AR
2983	Arjan Faimir Kalash	Arsim i lartë, Inzhinier i natës	Arsim i lartë, Inzhinier i natës	Alpetrol Sh.a	PO		
2983	Fredion Petraq Sak	Arsim i lartë, Jurist	Arsim i lartë, Jurist	Privat	PO		
2983	Diana Yangjel Stambolliu	Arsim i lartë, Biokimist	Arsim i lartë, Biokimist	AKU	PO		
2983	Sabiana Naci	Arsim i mesëm	Arsim i mesëm				
2983/1	Sirjona Arjan Llakaj	Arsim i lartë, Inzhinier Mekanik	Arsim i lartë, Inzhinier Mekanik	Alpetrol	PO	Prioritet i Lartë	
2983/2	Geri Frederik Pjetri	Menaxhimi Biznesi (Master)	Menaxhimi Biznesi (Master)				
2983/3	Teodor Frederik Pjetri	Juridik	Juridik				
2984	Olimbi Kristaq Kërci	Arsim i lartë, Financiere	Arsim i lartë, Financiere	Aktualisht punon Aktive-Produkt në Bordin e Kullimit	PO	Prioritet i Lartë	
2984	Mira Iqmet Bushi	Arsim i lartë, Inzhinier Ndërtim	Arsim i lartë, Inzhinier Ndërtim	Sek Urbanistikës, Bashkia Fier	PO	Prioritet i Lartë	
2984/1	BLORNA DOKO	Fakulteti	Kudo ku ka mundësi, ka punuar zëvendësues neper shkolle		PO		
2984/2	SHYANA BELE	Arsim i lartë për kum udhëqimorë	Kerkon te punesohet	Sektor Privat	PO		
2985	Ira Dula	Arsim i lartë, Ekonomi-Biznes	Kryetare OS, Kerkon te punesohet ne profesion, Specialiste tek Drejtorja e Pergjithshme e Tregimeve	ka punuar te ADISA per 7 vjet	PO	PO	
2985	Jargosa Baha	Arsim i lartë, Inzhinier Naltë	Arsim i lartë, Inzhinier Naltë				
2986	Paolo Jaupaj	Arsim i lartë, Ekonomi-Biznes	Arsim i lartë, Ekonomi-Biznes	Sektori privat-ALBES Shoes	PO	PO	
2986	Eugert Xhalafaj	Arsim i mesëm	Arsim i mesëm profesional "Peto Sola" kerkon shofer dhe murgazier				
2986/1	Rajmonda Borova	Edukatore	Arsim i mesëm, bashkëkryetare OS, Kerkon te punesohet ne profesion				
2987	Florina Dimo	Arsim i lartë, Ekonomi-Finance	Arsim i lartë, Ekonomi-Finance	Bashkia	PO	PO	
2988	LULJETA RISTANI	Arsim i lartë, Juriste/Master ne drejtesi	Arsim i lartë, Juriste/Master ne drejtesi	Initiativë egrimeve shqetore Fier	PO	PO	
2988	SUZANA CUKO	Arsim i mesëm, faturiste	Arsim i lartë, Inzhinier Naltë	Ursjellës	PO	PO	
2988	ENKLIID BYZYKA	Arsim profesional	Arsim i lartë, Inzhinier Naltë	Elektreist ne natë	PO	PO	
2988	FATJON MECALLIU	Arsim i mesëm profesional	! pajuar, (me 3 vjetshë), Kerkon pune shiti		jo	jo	
2988	KLARTA DUMI	Arsim i mesëm	Per dy vjet ne pension, dhe kerkon te punesohet si sanitar		jo	PO	
2988/1	TEUTA SHKURTII	Arsim i mesëm	Grupja e anetarit Gëzim Shkurta (i cili nuk do angazhohet pa u futur bashkëshortja ne punë), e kane beqar nga puna si pastreues ne bashki	Pastrim gjelberim ne bashki	jo	PO	
2988/2	NERTIAN MECANI	Arsim i lartë, Ekonomist	Djalo i kryetarit i admirt, pa pune kerkon te punesohet me task forcen e ujt, ose tarmet	I vetpuesuar, emigracion	po		
2988/3	DONIKA HONHA	Arsim i lartë, Mesuese geografie	Stuaja e anetarit Miroslava Honha, me influencë dhe ngjyhe ne zone, ka punuar ndihmese ne qarkun e fterri i kane prishur korrupsionin i vjetare. Ka bere dhe ankese dhe nuk e kane bashkuar pergjigja e ministrise se arsimi. Kudo edhe besnikendues.	Mesuese zëvendësuese	PO	PO	
2988/4	INESA GOGA	Arsim i mesëm	Stuaja e Elton Gogës Arstar, punon ne privat kerkon pastreues (te kopshu nr 7 del diktat ne pension) i eshte premuar ne zgjedhjet e kaluara nga kryetari dhe nuk i eshte zgjedhur	Privat	jo	PO	

3016	Figera Salaku	Arsim i Mesem	edukatore kopeshi cerdhe		pa pune	PO	PO
3016	Gecitan sollaku	Arsim i Mesem	Kerkon te punesohet roje eabte veti i gashke		pa pune	PO	PO
3016	Anjeza Allaj	Arsim i larte	Kerkon te punesohet si ekonomiste/financiere				
3016/1	Lutrim Shehu	Agronom	I Papune agronom i mesem. Kerkon te gjerbermis		Vite papune	PO	PO
3016/2	FATJONA MAZREKU	Master Profesional Cikl Ulet	Ka vite e papune, kerkon pune ne institucione arsimore			PO	PO
3017	Susana Ndani	Arsim i larte	Mesuese Gulke Letorse. Ka qe nga viti 2015 deri tani qe punon si mesuese zevendesuese me kontrat pasi ne 2015 e ka reforme dhe e kaluan zevendesuese. Ka influencë dhe eabte aktive. Kerkon te labej mesuese ne vendim	Mesuese adhimese te Lin Gero		JO	PO
3017	Engjela Hasanaj	Arsim i larte	bashkekrytare e divocuar. Ka Master shkencor gulbe te huaja (ang. ualishi), punon ne cerdhen ne 5 por do te punesohet ne profesion.	Edukatore ne cerdhe		PO	PO
3017	Adela Kullau	Arsim i larte	Kerkon te punoje tek ZVA ose qendra ekonomike	punon tek UNK		PO	PO
3018	Laurene Devija	Arsim i Mesem	Kerkon pune shofere ose roje ne ajrpetrol		la punuar ne nalfte operator pompist 2011-2016	JO	PO
3018/1	Branilda Vangjeli Devija	Arsim i Mesem	Do te punoj sanitare ne kopeshi, shkolle, cerdhe eabte shume imediate pasi ka 10 vota dhe e kane si kerkese imediate punesimin e brulides pasi e kane gjerjet shume per punesim	sanitare		PO	PO
3019	Branilda Tafa	Arsim i Mesem	Kerkon te punesohet si sanitare ne bashki				
3019/1	Eduart Tego	Arsim i Mesem	Kerkon te punesohet ne ujesjelles rose punosyes shetbimi bashki			PO	PO
3019/1	Marijus Muresaj	Shkolle e Mesme	Kerkon te punesohet si roje ne Albpetrol		Ujesjelles fier tek task forca	JO	PO
3019/1	Vjollanda shibesh	Shkolle e larte per sociologji	do te punesohet tek shetbimi social tek amando naci		JO	JO	PO
3019	Robert Cupa	Shkolle e larte Usharake akademja skenderbej ka licence per kompanie e sigurise Ilzike dhe permes	Zyra e mbajtyes se Vjoses ose Agjencia rajonale e mjelosit		JO	JO	PO
3018	Mirdina Refit Ruzi	shkolle e mesme ekonomike	ndihmes guzhinier ose sanitare		JO	JO	PO
407978	Flamur Lila	shkolle e mesme	kerkon pune jo roje ne privat		JO	JO	PO
406882	Emerrilda Bushi	Shkolle e larte ekonom. adm bujqesi	Kerkon specialiste ne shet				
3014	Gezim Dervishi	Shkolle e Mesme	Punon usht. vendos pllaka, kerkon roje ne shet				
3014	Giseld Dervishi	Shkolle e larte per gazetar	Kerkon pune ne profesion				
3014	Alberta Dervishi	Shkolle e Mesme	Kerkon Sanitare ne shet				
3013/1	Majlinda Shehu	shkolle e mesme elektrike	Kerkon te OSHEE		Punon tek Albese		
3012/1	Hedon Barjaktari	Shkolle e larte per fiskulture	Ka mbaruar per fiskulture, ka 5 vite qe punon tek shkolle "Mustafa Mustafi" eabte emesme eabshkuar ne Patos Lan Emri i Dergori te shkolles Teuta Sina. Punon me kontrate deshturon te jete me kobe te jete aty				
2987/1	Xheta Alket Solo	Shkolle e larte per inzhineri elektrike	I jati dhe xhaxhallaret (Albetti, lldageti, Erioni) jane anetare te PS. Xheti po mbaron univeritetin e Vlores per inzhinern elektrike dhe kerkon te punesohet ne ujeshtie ne rye nga kompanie e sustenut elektroenergitikut. Preferon OSHEE				

2985	Petrit Njeto Zano	Shkollë e mesme	Ametar i vjetër i partisë dhe aktiv. Aktualisht roje. I ka vdekur e mouta dhe po rrit dhe fëmijet e saj. Kërkon një vend me të mirë, mundësisht në Albpetrol				
2986/1	Lajza F'akë Mehmetaj	Shkollë e mesme	Kerkon punë si edukatore kuptohet. E sëmure, me sëmundje të leqë. I shoq. Shkelqimi, ka ndikim në zonë dhe megjithatë vonesë i vjetër i partisë thotë që nuk ka marrë asgjë prej mbledhjet				Po
2985	Fabio Aleksandër Boroj	Shkollë lartë për informetë, nuk ka marrë licencën ende	Do punë në zbatim e tij				



Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË
MADHËSHTORE

Nr. 239 Prot.

Tiranë, më 21 Mars 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht shpërndarja e certifikatave të pronësisë

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....".

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni nëpërmjet publikimeve në media se Kryetarja e Bashkisë Roskovec Majlinda Bufi ka shpërndarë Vendimet e legalizimeve dhe Certifikatat e pronësisë për banorët e njësisë Roskovec e Strum.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ngre shqetësimin se subjekti në fjalë është duke shfrytëzuar dhe përdorur këto akte pronësie dhe këtë veprimtari për të synuar mobilizimin e votave të banorëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Neni 3 "Veprimtaritë e ndaluara" pika 1.3 gërma "b" i vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon se:

"1.3 Veprimtari të ndaluara janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

~~b) shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë, dhe çfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve"~~

Neni 91/4 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënie të përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënie të pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”.

Kjo veprimtari e Kryetares së Bashkisë Roskovec është kryer në shkelje flagrante dhe të hapur të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe të nenit cituar më sipër, ndaj subjekti i kësaj shkelje duhet të mbajë përgjegjësi ligjore sipas rastit.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe mbi të gjitha që është më e rëndësishmja, të ndalohej ndikimi në votën e zgjedhësve. Kujtojmë se jetojmë në një rend demokratik ku vota është e lirë dhe e fshehtë. Askush dhe në asnjë formë nuk mund të ndikojë në bindjen personale të zgjedhësve.

Ndalimi i promovimit të projekteve dhe investimeve të tilla ka për qëllim zhvillimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe të barabartë midis partive politike dhe që asnjëra nga palët mos të jetë në pozita më të favorshme se të tjerat dhe mos të ketë përparësi.

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëngjitur po ju vendosim LINK të postimit denoncues.

https://boldnews.al/2025/03/20/material-per-spak-un-bufi-i-roskovecit-jep-hapur-legalizime-ne-kembim-te-votave/?fbclid=IwY2xjawJJDBJleHRuA2FlbQlXMQABHS2qmoMCJmyU6CGWVE5HKUWFYE3flsUmXn6FwO7_cpM7Vyl4pWwtryCOsg_aem_mdcjtpU0kHmCZIQFIM0iBw

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, **duke kërkuar përfundimisht:**

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislationit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ

z. Franci NURI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më ____ . ____ .2025

KALLËZIM PENAL

KALLËZUES: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, i përfaqësuar nga Kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, me adresë njoftimi: Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

KUNDËR: Majlinda Bufi, me detyrë kryetare e Bashkisë Roskovec, e bija e Daut dhe Nadire, lindur më 20.05.1972, në Roskovec, banuese në Roskovec, me numër personal H25520269P.

OBJEKTI: Kallëzimi i veprës penale “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 328/a, paragrafi i katërt, dhe neni 25, i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Nenet 328/a dhe 25 të Kodit Penal;
Nenet 280 dhe 281 të Kodit të Procedurës Penale.

PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

I/E Nderuar Z./Znj. Prokuror/e,

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në datën 19 mars 2025, ora 08:17, shtetasja Majlinda Bufi, me detyrë kryetare e Bashkisë Roskovec, ka postuar në profilin e saj zyrtar në rrjetin social Facebook, postimin me përmbajtje si vijon: «*Mirëmëngjes, me lajmin se rreth 300 dosje janë plotësuar me elementët e duhur nga grupet e terrenit dhe për gati 90 banesa janë gjeneruar Vendimet e Legalizimeve/Certifikatat e Pronësisë në njësitë Roskovec e Strum, ju urojmë një ditë të bukur.*».¹ Bashkëlidhur këtij postimi janë pesë foto, në të cilat shfaqen dy individë që plotësojnë dokumente (prezumohet funksionarë shtetërorë katër persona të tjerë që qëndrojnë krah tyre (prezumohen qytetarë përfitues të këtyre procedurave).

¹ <https://www.facebook.com/photo/?fbid=2090803398058916&set=pcb.2090803738058882>

2. Në këto kushte, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, se shtetasja Majlinda Bufi, së bashku me shtetas të tjerë, kanë konsumuar elementët e veprës penale të «Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore», në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 328/a, paragrafi i katërt, dhe neni 25, i Kodit Penal, pasi është e qartë se kjo veprimtari përbën përdorimin e funksionit shtetëror dhe burimeve njerëzore, me qëllim favorizimin e Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj, në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025.

II. E DREJTA E APLIKUESHME

3. Kodi Penal:

- (i) **Neni 25** parashikon: “Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.”.
- (ii) **Neni 328/a** parashikon: “Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.”.

4. Kodi i Procedurës Penale:

- (i) **Neni 280** parashikon: “1. Prokuroria dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.”
- (ii) **Neni 281** parashikon: “1. Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale.”.

III. ANALIZA LIGJORE

5. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar qëndrimin e tyre lidhur me elementet që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative që të ndodhemi përpara ekzistencës së një vepre penale. Konkretisht, kërkohet bashkëekzistenca e katër elementeve, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive. Në vijim do të analizojmë secilin prej këtyre elementëve sa i përket veprës penale të “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, të cilat në vlerësimin tonë përmbushen plotësisht nga veprimet e shtetases Majlinda Bufi, me detyrë kryetare e Bashkisë Roskovec, dhe personave të tjerë të paidentifikuar nga ana jonë.
6. **Objekti:** Objekti i veprës penale ka të bëjë me marrëdhënien juridike ose vlerën e rëndësishme shoqërore që legjislatori ka synuar të mbrojë posacërisht, duke vendosur

sanksion penal në rast të shkeljes së saj. Në rastin e veprës penale të “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, legjislatori ka synuar të mbrojë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar funksionimin normal sipas ligjit të sistemit të zgjedhjeve, votimin e lirë e të ndershëm, interesat personale të kandidatit ose të një partie politike, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Konkretisht, marrëdhënia juridike që synohet të mbrohet është zhvillimi i zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të barabarta në Bashkinë Roskovec, Qarku Fier, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme të shtetases Majlinda Bufi, me detyrë kryetare e Bashkisë Roskovec, dhe shtetasve të tjerë që kryejnë detyra shtetërore.

7. **Ana objektive:** Ana objektive e veprës penale ka të bëjë me veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme nëpërmjet të cilave është cënuar marrëdhënia juridike ose vlera shoqërore, e mbrojtur nga ligji penal. Në rastin e veprës penale të “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, ana objektive lidhet me përdorimin nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje. Në rastin konkret, është e qartë se shtetasja Majlinda Bufi, në bashkëpunim edhe me shtetas të tjerë, punonjës të administratës shtetërore, përdor funksionin e saj si kryetare bashkie dhe burimet njerëzore shtetërore, me qëllim favorizimin e Partisë Socialiste dhe kandidatëve të saj në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, në territorin e Bashkisë Roskovec dhe Qarkun Fier.
8. Përdorimi i funksionit publik, ashtu si edhe i burimeve njerëzore, për veprimtari politike ose zgjedhore është kategorikisht i ndaluar edhe nga legjislacioni zgjedhor, përkatësisht nga nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator. Këto akte kanë pasur për qëllim që të ndalojnë funksionarët publikë, të zgjedhur apo të emëruar, që funksionet, veprimtarinë dhe kompetencat e tyre t’i përdorim me qëllim për të favorizuar subjekte politike apo kandidatët e tyre në proceset zgjedhore. Përdorimi i burimeve shtetërore dhe njerëzore, veçanërisht shpërndarja e lejeve të legalizimit dhe certifikatave të pronësisë është shprehimisht i ndaluar, dhe në raportet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e viteve 2021 dhe 2023 është përmendur shprehimisht si një prej problematikave kryesore të proceseve zgjedhore, që ka për qëllim deformimin, tjetërsimin dhe manipulimin e vullnetit të zgjedhësve.
9. **Subjekti:** Subjekti i veprës penale ka të bëjë me personin që nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të tij kryen vepër penale. Autori i veprës penale duhet të ketë mbushur moshën e parashikuar me ligj dhe të jetë i përgjegjshëm. Në rastin e veprës penale të “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, subjekti i veprës penale është i posaçëm – punonjës i administratës shtetërore ose i shërbimit civil si në rastin kur është në pozicion drejtues ashtu edhe zbatues, punonjës që kanë mbushur moshën për

përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm. Në rastin konkret, rezulton se shtetasja Majlinda Bufi ushtron detyrën e kryetares së Bashkisë Roskovec, është 52 vjeçe dhe e përgjegjshme, e në këtë kuptim përmbushet edhe elementi i tretë i veprës penale.

10. **Ana subjektive:** Ana subjektive e veprës penale lidhet me aftësinë e personit për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij dhe qëndrimin psikik që mban personi ndaj veprimit/mosveprimit të paligjshëm dhe pasojave të dëmshme. Në rastin e veprës penale të “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, vepra penale kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, duke u nisur nga motive dhe qëllime politike. Në rastin konkret, është e qartë se shtetasja Majlinda Bufi, së bashku me shtetas të tjerë, punonjës shtetërorë, kanë qenë plotësisht të vetdijshëm për pasojat e veprimeve të tyre dhe kanë dëshiruar ardhjen e këtyre pasojave, me qëllim që nëpërmjet dhënies së këtyre përfitimeve drejtuar potencialisht 390 familjeve (300 dosje në përpunim, 90 vendime të gjeneruara), të siguronin sa më shumë mbështetje për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj në territorin e Bashkisë Roskovec, për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025.

IV. KONKLUSIONE

11. Prandaj, në kushtet kur provohet katërcipërisht kryerja e veprës penale “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 328/a, paragrafi i katërt, dhe neni 25, i Kodit Penal, *përfundimisht*,

K Ë R K O J M Ë:

- (i) Shqyrtimin e këtij kallëzimi dhe kryerjen e verifikimeve paraprake.
- (ii) Regjistrimin e procedimit penal.
- (iii) Kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithëanshëm, në një kohë sa më të shpejtë.
- (iv) Dërgimin e çështjes në gjyq për shtetasen Majlinda Bufi, me detyrë kryetare e Bashkisë Roskovec, dhe shtetasit e tjerë, të akuzuar për veprën penale “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 328/a, paragrafi i katërt, dhe neni 25, i Kodit Penal.

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Kryetari

Gazment BARDHI



Partia
Demokratike

Tiranë, më 12 Shkurt 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht miratimi i akteve nënligjore për dhënien e tokave me qira para fushatës zgjedhore

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.

2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor. [...]".

Në vijim gjeni shkeljet e kryera nga Bashkia Fier në kuadër të zgjedhjeve për kuvend të datës 11 maj 2025:

I. Përdorimi i aseteve publike për dhënien e tokave me qira në Bashkinë Fier

Sipas denoncimeve të shumta në media, rezulton se në mbledhjen e datës 30 janar të Këshillit Bashkiak në Fier janë miratuar katër projektvendime për dhënie me qira të pasurive publike të cilat u morën me shumicën e votave të këshilltarëve socialistë.

Tokat ndodhen në Asturkas, Libofshë, Sheq, Marinas, Topojë, Bregas, Frakull si dhe dy pasuri brenda në qytetin e Fierit. Kryebashkiaku Subashi mohoi që vendimi të ketë lidhje me zgjedhje dhe pretendoi se ishte vijim i punës së bashkisë. Ai tha se vendimi ishte marrë vetëm në parim dhe se procesi do të vijonte me shqyrtimin e ofertave. Ai është shprehur se: "Më tej do vazhdojmë me procesin e shqyrtimit të ofertave dhe tokat do t'i marrë ai që jep ofertën më të mirë".

Në faqen zyrtare të Bashkisë Fier është publikuar vetëm shkresa "Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak" që mban datën 22.1.2025 ndërsa projektvendimet nuk gjenden të publikuara, duke shkelur në këtë mënyrë edhe parimin e transparencës. Kopje të kësaj shkrese do ta vendosim në dispozicion për shqyrtimin tuaj.

Nxjerrja e projektvendimeve para fushatës zgjedhore të cilat sigurojnë dhënien e tokave me qira në favor të subjekteve të caktuara është veprimtari publike e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Neni 91/4 i Kodit Zgjedhor parashikon "4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore".

Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon "3. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë".

Aktet nënligjore në fjalë janë në kundërshtim me këto dispozita për arsye se:

- a) Parashikojnë dhënien e përfitimeve për një kategori të caktuar njerëzish/subjektsh. Në këtë rast aktet i drejtohen një numri të caktuar subjektsh, të cilat janë individët/shoqëritë tregtare, të cilave do tju jepen tokat me qira.
- b) Aktet nënligjore nuk janë nxjerrë në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme (siç parashikon neni 91/4). Këto projektvendime nuk janë nxjerrë në kushte të një fatkeqësie natyrore, epidemie, gjendje lufte apo një gjendje tjetër të jashtëzakonshme e cila preket të gjithë popullin e vendit.

Vendimet që merren gjatë periudhës zgjedhore duhet të jenë të bazuara në nevoja të qarta dhe të arsyeshme, pa pasur ndikime të drejtpërdrejta nga procesi zgjedhor.

Për këto arsye, vlerësojmë se këto akte nënligjore përveçse janë nxjerrë në shkelje flagrante të nenit 91/4 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Qëllimi për të cilat janë nxjerrë 4 muaj përpara zgjedhjeve është tërësisht politik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

Ndalimi i miratimit të akteve nënligjore para fushatës zgjedhore është një masë që synon të sigurojë integritetin, ndershmërinë dhe besueshmërinë e zgjedhjeve, duke parandaluar përfitime të padrejta dhe duke mbajtur një sistem të drejtë për të gjithë aktorët politikë dhe qytetarët.



Ndalimi i miratimit të akteve nënligjore bëhet me qëllimin për të parandaluar ndikimet politike të mundshme që mund të vijnë nga miratimi i këtyre akteve të cilat mund të favorizojnë një parti ose kandidat të caktuar.

Në rastin konkret, dyshojmë se qëllimi i nxjerrjes së këtyre para fushates zgjedhore është ndikimi te subjektet të cilat kanë shprehur interesin për të përfutur tokat me qira, për të marrë votat e tyre.

Partia Demokratike kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe që ndalojnë nxjerrjen e akteve para fushatës zgjedhore, ndalimin e shpërdorimit të fondeve publike dhe mbi të gjitha që është më e rëndësishmja, të ndalohet ndikimi në votën e zgjedhësve. Kujtojmë së jetojmë në një rend demokratik ku vota është e lirë dhe e fshehtë. Askush dhe në asnjë formë nuk mund të ndikojë në bindjen personale të zgjedhësve.

Ndalimi i promovimit të projekteve të tilla ka për qëllim të promovojë zhfillimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe të barabartë midis partive politike dhe që asnjëra nga palët mos të jetë në pozita më të favorshme se të tjerat dhe mos të ketë përparësi.

Shkelja e ligjit në mënyrë të rëndë dhe e kryer në bashkëpunim nga disa persona, ndoshta është tregues se ligji në vendin tonë nuk funksionon dhe nuk është aq i fuqishëm sa personat në fjalë.

Në këto kushte, Partia Demokratike kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëngjitur po ju vendosim LINK të postimit denoncues.

<https://www.syri.net/politike/761819/toka-me-qira-dhe-gosti-elektorale-si-po-blihen-votat-nga-e-majta-ne-fier/>

<https://boldnews.al/2025/02/10/toka-me-qira-dhe-gosti-elektorale-si-po-blihen-votat-nga-socialistet-ne-fier/>

<https://www.reporter.al/2025/02/10/toka-me-qira-dhe-gosti-elektorale-fushata-ne-fier-dominohet-nga-akuzat/>


Në këto kushte, Partia Demokratike po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, **duke kërkuar përfundimisht :**

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këto raste nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PER PARTINE DEMOKRATIKE
Përfaqësues i PD në KQZ

Franci NURI



Toka me qira dhe gosti elektorale: Fushata në Fier dominohet nga akuzat

Bashkia e Fierit akuzohet se po përdor burimet dhe pasurinë publike për të ndikuar në votën e qytetarëve në zgjedhjet e 11 majit, pasi socialistët në Këshill miratuan dhënien me qira të mijëra metrave tokë pa vënë në dispozicion dokumentet.

Nga Valbona Davidhi — 07:56 | 10/02/2025 Në Analiza, Artikull kryesor I, Zgjedhje 2025

0



Kryetari i Bashkisë së Fierit, Armando Subashu dhe drejtuesja e PS për qarkun, Belinda Balluku gjatë një aktiviteti. Foto: Facebook.

 Share on Facebook

 Share on Twitter



Në fillim të janarit, Drejtoria e Artit dhe Kulturës në Bashkinë e Fierit çeli një tender me objekt "Festojmë me emigrantët fierakë në Greqi". Aktiviteti përshkruhej si 'koncert festiv', për të cilin bashkia kërkonte të punësonte tre këngëtarë nga Fieri, një autobus transporti 30 vendësh dhe një koordinator.

I planifikuar të zhvillohej në Athinë në kohën kur partitë politike janë përfshirë në një garë të ethshme për votën e diasporës, koncerti u anulua.

"E anulua sepse nuk kishim bërë njoftimin pesë ditë përpara në KQZ. Aktiviteti në Athinë u zhvillua, por pa bashkinë", tha kryebashkiaku Armando Subashi për BIRN.

Aktiviteti u denoncua nga opozita si përpjekje për përdorimin e parave publike për të joshur votën e emigrantëve. Tërheqja e bashkisë erdhi vetëm pas denoncimit.

Por për përfaqësuesit lokalë të opozitës në Bashkinë e Fierit, kjo nuk është përpjekja e vetme për tjetërsim të votës përmes përdorimit të fondëve publike apo shkeljes së ligjit elektorale.

Opozita denoncoi gjithashtu dhënien e mijëra metra katrorëve tokë me qira nga Këshilli Bashkiak i dominuar nga socialistët, me qëllim sipas tyre për të ndikuar në zgjedhjet e 11 majit.

"Është skandaloze mënyra se si merren vendimet në këtë Këshill. Po të japësh pasuritë publike me "sy mbyllur" pa një relacion shpjegues, qoftë edhe vetëm si procedurë, është kriminale", tha këshilltari i Partisë Demokratike, Endri Jaupaj për BIRN.

Kryebashkiaku Armando Subashi mohoi akuzat.

"Ne jemi në punë, bashkia do vazhdojë punën normalisht", tha ai, duke pretenduar se procedurat për dhënien e tokës nuk ishin përfunduar dhe vendimi ishte vetëm në parim.

Toka me qira para zgjedhjeve

Katër projektvendime për dhënie me qira të pasurive publike u morën me shumicën e votave të këshilltarëve socialistë në mbledhjen e datë 30 janar të Këshillit Bashkiak në Fier. Tokat ndodhen në Asturkas, Libofshë, Sheq, Marinas, Topojë, Bregas, Frakull si dhe dy pasuri brenda në qytet.

Dhënia e tyre me qira u bë sipas opozitës pa transparencë dhe se as këshilltarët socialistë nuk e dinin se çfarë votuan. Asnjë prej vendimarrjeve nuk ishte i shoqëruar me dokumentacion dhe këshilltarët votuan pa e ditur as sipërfaqjen e secilës prej pasurive publike që bashkia do të japë me qira. Në pikat respektive të rendit të ditës, përshkruhej vetëm vendodhja dhe numri kadastral i pasurive.

Këshilltarët e partive të tjera votuan kundër dhe thanë se do ankimojnë vendimet, që sipas tyre janë një përpjekje për të tjetërsuar votën përmes përdorimit të pasurisë publike.

"Ne do ta ankimojmë vendimin, fillimisht te prefekti e më pas do ndjekim shkallët e gjyqësorit. Ndërkohë do sinjalizojmë edhe KQZ për këtë vendimarrje", tha Kreshnik Dapi, këshilltar i Partisë SocialDemokrate.

"Është marrë vendim për dhënien e pasurive publike, pa asnjë informacion për përfitimet që do të ketë komuniteti, subjektet që përfitojnë dhe për çfarë do shfrytëzohen këto toka", shtoi ai.

Këshilltarët e partive në opozitë shtuan gjithashtu se në Këshill u votua pa pasur informacion.

"Sigurisht që ka efekte elektorale një pasuri e tillë e dhënë në këtë moment para zgjedhjeve," shtoi më tej Dapi.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak, Antoneta Çuni pranoi se nuk ishte në dijeni të detajeve për dhënien e tokave me qira dhe këmbënguli se detyra e saj ishte vetëm të drejtojë mbledhjet.

"Nuk i di detajet, por di që janë tokë shtet dhe pa frut. Unë nuk kam detyrim të njoh detajet e projektvendimeve që kalojnë në Këshill, por vetëm të bëj detyrën time si drejtuese e atij Këshilli ku të respektohet ligji për vendimmarrjen nga pikëpamja procedurale", tha Çuni.

Kryebashkiaku Subashi mohoi që vendimi të ketë lidhje me zgjedhjet dhe pretendoi se ishte vijim i punës së bashkisë. Ai tha se vendimi ishte marrë vetëm në parim dhe se procesi do të vijonte me shqyrtimin e ofertave. "Më tej do vazhdojmë me procesin e shqyrtimit të ofertave dhe tokat do t'i marrë ai që jep ofertën më të mirë", tha Subashi.

Kjo vendimmarrje nuk është i vetmi rast që opozita pretendon se lidhet me zgjedhjet. Zyrtarë lokalë të opozitës kanë dënoncuar marrjen pjesë të administratës në aktivitetet e socialistëve, ndërsa po ashtu BIRN gjeti se punonjës të ndërmarrjeve të bashkisë morën pjesë në një gosti të shtruar nga Partia Socialiste me pensionistë.

Për kryebashkiakun Armando Subashi, përfshirja e administratës apo punonjësve të bashkisë në aktivitete zgjedhore është çështje orari. Sipas tij, askush nuk mund të ndalojë një nënpunës, qoftë zyrtar i lartë apo punonjës pastrimi, të marrë pjesë në fushatë pas orarit zyrtar të punës.

"Nëse akuzat që bëhen verifikojnë se këta punonjës janë në orar zyrtar, unë jam i gatshëm të marr masat sipas ligjit," tha Subashi.

Por përfaqësues të opozitës pretendojnë se punonjësit e administratës janë nën presion për të qenë pjesë e aktiviteteve elektorale dhe këmbëngulin se mjaft prej tyre kërcënohen me vendin e punës.

"Unë di raste me emër dhe mbiemër që janë hequr nga puna duke u thënë: Nuk je me ne. Janë duke bërë fushatë shumë agresive. Tani me votën e diasporës po kërkojnë nga punonjësit e administratës të dhënat e të afërmeve jashtë, e-mail dhe numër telefoni", tha përfaqësuesi i Partisë së Lirisë, Arben Çuko.

Akuzat për punësime

Ndryshe nga Bashkia e Fierit, në Lushnjë opozita ankohet për rritje fiktive të numrit të punonjësve në kompanitë në varësi të bashkisë. Përmes një kërkesë për informacion, BIRN mësoi se numri i punonjësve në bashkinë e Lushnjes u rrit me 37 vetë, nga 1033 në vitin 2023, në 1070 në vitin 2024.

Drejtoresha e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Lushnjes, Erisa Qalliu tha se kjo rritje e numrit të punonjësve është bërë si plotësim i nevojave që kishin disa sektorë në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike.

"Është për nevojat e ardhura nga drejtoritë përkatëse, psh ka rritje të Sektori MZSH (nevojë e vazhdueshme nga zjarret) një nga bashkitë me numër më të lartë zjarresh", pretendoi Qalliu.

Deputeti i Partisë Demokratike, Saimir Koreshi thotë se ndërmarrjet vartëse apo shoqëritë anonime me aksioner kryesor bashkinë, po përdoren për punësime elektorale. Sipas tij, kjo ndodh sepse shoqëri si ujësjellësi nuk japin llogari për punësimet duke qënë se operojnë si subjekt privat.

"Unë e kam deklaruar edhe nga foltorja e Kuvendit, në Lushnje janë punësuar në bashki persona që nuk janë fare në Shqipëri edhe marrin rrogën. Skandali shkon deri aty sa një vend pune të ndahet përgjysmë, sigurimet i merr një punonjës dhe pagën një tjetër", tha Koreshi për BIRN.

Koreshi tha gjithashtu se duke qënë ndërmarrje shërbimesh, punësimi bëhet pa kriter arsimimi dhe profesional, ndërsa kontratat në punë janë me afate të shkurtra që nuk i kalojnë 6 muajt.

Bashkitë Divjakë dhe Rroskovec nuk iu përgjigjën kërkesës së BIRN për informacion mbi numrin e punonjësve dhe ndryshimet në këtë numër gjatë dy viteve të fundit. Bashkitë e tjera të Qarkut të Fierit, që iu përgjigjën kërkesës për informacion pretenduan se numri i punonjësve në to nuk kishte ndryshuar.

Etiketa: Antoneta Çuni Armando Subashi Bashkia e Fierit Bashkia e Lushnjes

Burimet shtetërore Endri Jaupaj Keshilli Bashkiak Kreshnik Dapi Partia Demokratike

Saimir Korreshi Vota e diasporës

Pas

Kosova në zgjedhje: Gara për parlamentin e ri dhe sfidat politike

Tjetri

Evropa mundet dhe duhet t'i rezistojë Donald Trump

Më të lexuarat



KRYESORE INVESTIGIME OP-ED VETTING AKTUALITET POLITIKE SPORT ▾ TE TJERA ▾

Fillimi > AKTUALITET

Toka me qira dhe gosti elektorale: Si po blihen votat nga socialistët në Fier

09:58 : 10/02/2025 në AKTUALITET, KRYESORE, POLITIKE



Në fillim të janarit, Drejtoria e Artit dhe Kulturës në Bashkinë e Fierit çeli një tender me objekt "Festojmë me emigrantët fierakë në Greqi".

Aktiviteti përshkruhej si 'koncert festiv', për të cilin bashkia kërkonte të punësonte tre këngëtarë nga Fieri, një autobus transporti 30 vendësh dhe një koordinator.

I planifikuar të zhvillohej në Athinë në kohën kur partitë politike janë përfshirë në një garë të ethshme për votën e diasporës, koncerti u anulua.

Toka me qira dhe gosti elektorale: Si po blihen votat nga socialistët në Fier



"E anuluam sepse nuk kishim bërë njoftimin pesë ditë përpara në KQZ. Aktiviteti në Athinë u zhvillua, por pa bashkinë", tha kryebashkiaku Armando Subashi për BIRN.

Aktiviteti u denoncua nga opozita si përpjekje për përdorimin e parave publike për të joshur votën e emigrantëve. Tërheqja e bashkisë erdhi vetëm pas denoncimit.

Lexo edhe:

Veliaj pas arrestimit: Nuk hesht më për atë që më kanë parë sytë dhe dëgjuar veshët!

Zgjedhjet në Kosovë/ Numërohen mbi 96% e votave, ja si është rezultati

Por për përfaqësuesit lokalë të opozitës në Bashkinë e Fierit, kjo nuk është përpjekja e vetme për tjetërsim të votës përmes përdorimit të fondeve publike apo shkeljes së ligjit elektorale.

Opozita denoncoi gjithashtu dhënien e mijëra metra katrorëve tokë me qira nga Këshilli Bashkiak i dominuar nga socialistët, me qëllim sipas tyre për të ndikuar në zgjedhjet e 11 majit.

“Është skandaloze mënyra se si merren vendimet në këtë Këshill. Po të japësh pasuritë publike me “sy mbyllur” pa një relacion shpjegues, qoftë edhe vetëm si procedurë, është kriminale”, tha këshilltari i Partisë Demokratike, Endri Jaupaj për BIRN.

Kryebashkiaku Armando Subashi mohoi akuzat.

“Ne jemi në punë, bashkia do vazhdojë punën normalisht”, tha ai, duke pretenduar se procedurat për dhënien e tokës nuk ishin përfunduar dhe vendimi ishte vetëm në parim.

Toka me qira para zgjedhjeve

Katër projektvendime për dhënie me qera të pasurive publike u morën me shumicën e votave të këshilltarëve socialistë në mbledhjen e datë 30 janar të Këshillit Bashkiak në Fier. Tokat ndodhen në Asturkas, Libofshë, Sheq, Marinas, Topojë, Bregas, Frakull si dhe dy pasuri brenda në qytet.

Dhënia e tyre me qira u bë sipas opozitës pa transparencë dhe se as këshilltarët socialistë nuk e dinin se çfarë votuan. Asnjë prej vendimmarrjeve nuk ishte i shoqëruar me dokumentacion dhe këshilltarët votuan pa e ditur as sipërfaqjen e secilës prej pasurive publike që bashkia do të japë me qira. Në pikat respektive të rendit të ditës, përshkruhej vetëm vendodhja dhe numri kadastral i pasurive.

Këshilltarët e partive të tjera votuan kundër dhe thanë se do ankimojnë vendimet, që sipas tyre janë një përpjekje për të tjetërsuar votën përmes përdorimit të pasurisë publike.

“Ne do ta ankimojmë vendimin, fillimisht te prefekti e më pas do ndjekim shkallët e gjyqësorit. Ndërkohë do sinjalizojmë edhe KQZ për këtë vendimarrje”, tha Kreshnik Dapi, këshilltar i Partisë SocialDemokrate.

“Është marrë vendim për dhënien e pasurive publike, pa asnjë informacion për përfitimet që do të ketë komuniteti, subjektet që përfitojnë dhe për çfarë do shfrytëzohen këto toka”, shtoi ai.

Këshilltarët e partive në opozitë shtuan gjithashtu se në Këshill u votua pa pasur informacion.

“Sigurisht që ka efekte elektorale një pasuri e tillë e dhënë në këtë moment para zgjedhjeve,” shtoi më tej Dapi.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak, Antoneta Çuni pranoi se nuk ishte në dijeni të detajeve për dhënien e tokave me qira dhe këmbënguli se detyra e saj ishte vetëm të drejtojë mbledhjet.

“Nuk i di detajet, por di që janë tokë shtet dhe pa frut. Unë nuk kam detyrim të njoh detajet e projektvendimeve që kalojnë në Këshill, por vetëm të bëj detyrën time si drejtuese e atij Këshilli ku të respektohet ligji për vendimarrjen nga pikëpamja procedurale”, tha Çuni.

Kryebashkiaku Subashi mohoi që vendimi të ketë lidhje me zgjedhjet dhe pretendoi se ishte vijim i punës së bashkisë. Ai tha se vendimi ishte marrë vetëm në parim dhe se procesi do të vijonte me shqyrtimin e ofertave. “Më tej do vazhdojmë me procesin e shqyrtimit të ofertave dhe tokat do t'i marrë ai që jep ofertën më të mirë”, tha Subashi.

Kjo vendimarrje nuk është i vetmi rast që opozita pretendon se lidhet me zgjedhjet. Zyrtarë lokalë të opozitës kanë dënoncuar marrjen pjesë të administratës në aktivitetet e socialistëve, ndërsa po ashtu BIRN gjeti se punonjës të ndërmarrjeve të bashkisë morën pjesë në një gosti të shtruar nga Partia Socialiste me pensionistë.

Për kryebashkiakun Armando Subashi, përfshirja e administratës apo punonjësve të bashkisë në aktivitete zgjedhore është çështje orari. Sipas tij, askush nuk mund të ndalojë një nënpunës, qoftë zyrtar i lartë apo punonjës pastrimi, të marrë pjesë në fushatë pas orarit zyrtar të punës.

“Nëse akuzat që bëhen verifikojnë se këta punonjës janë në orar zyrtar, unë jam i gatshëm të marr masat sipas ligjit,” tha Subashi.

Por përfaqësues të opozitës pretendojnë se punonjësit e administratës janë nën presion për të qenë pjesë e aktiviteteve elektorale dhe këmbëgulin se mjaft prej tyre kërcënohen me vendin e punës.

“Unë di raste me emër dhe mbiemër që janë hequr nga puna duke u thënë: Nuk je me ne. Janë duke bërë fushatë shumë agresive. Tani me votën e diasporës po kërkojnë nga punonjësit e administratës të dhënat e të afërmeve jashtë, e-mail dhe numër telefoni”, tha përfaqësuesi i Partisë së Lirisë, Arben Çuko.

Akuzat për punësime

Ndryshe nga Bashkia e Fierit, në Lushnjë opozita ankohet për rritje fiktive të numrit të punonjësve në kompanitë në varësi të bashkisë. Përmes një kërkesë për informacion, BIRN mësoi se numri i punonjësve në bashkinë e Lushnjës u rrit me 37 vetë, nga 1033 në vitin 2023, në 1070 në vitin 2024.

Drejtoresha e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Lushnjes, Erisa Qalliu tha se kjo rritje e numrit të punonjësve është bërë si plotësim i nevojave që kishin disa sektorë në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike.

“Është për nevojat e ardhura nga drejtoritë përkatëse, psh ka rritje të Sektori MZSH (nevojë e vazhdueshme nga zjarret) një nga bashkitë me numër më të lartë zjarresh”, pretendoi Qalliu.

Deputeti i Partisë Demokratike, Saimir Koreshi thotë se ndërmarrjet vartëse apo shoqëritë anonime me aksioner kryesor bashkinë, po përdoren për punësime elektorale. Sipas tij, kjo ndodh sepse shoqëri si ujësjellësi nuk japin llogari për punësimet duke qënë se operojnë si subjekt privat.

“Unë e kam deklaruar edhe nga foltorja e Kuvendit, në Lushnje janë punësuar në bashki persona që nuk janë fare në Shqipëri edhe marrin rrogën. Skandali shkon deri aty sa një vend pune të ndahet përgjysmë, sigurimet i merr një punonjës dhe pagën një tjetër”, tha Koreshi për BIRN.

Koreshi tha gjithashtu se duke qënë ndërmarrje shërbimesh, punësimi bëhet pa kritere arsimimi dhe profesionale, ndërsa kontratat në të punës janë me afate të shkurtra që nuk i kalojnë 6 muajt.

Bashkitë Divjakë dhe Rroskovec nuk iu përgjigjën kërkesës së BIRN për informacion mbi numrin e punonjësve dhe ndryshimet në këtë numër gjatë dy viteve të fundit. Bashkitë e tjera të Qarkut të Fierit, që iu përgjigjën kërkesës për informacion pretenduan se numri i punonjësve në to nuk kishte ndryshuar./ BIRN

Etiketa: akuzat armando Subashi balluku Fushata në Fier gosti elektorale Toka me qira

Zgjedhjet



Lajme të lidhura



LAJME (HTTPS://WWW.SYRI.NET/LAJME/) **WEB TV** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/WEB-TV/) **OP-ED** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/OP-ED/) **BLOG** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/BLOG/) **SPORT** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/SPORT/) **KOSOVA** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/KOSOVA/) **JETE-STIL** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/JETE-STIL/) **RAJONI** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/RAJONI/) **BOTE** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/BOTE/) **KURIOZITETE** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/MISTERE/) **SHENDET** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/SHENDET/) **ARTE & MEDIA** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/ARTE-MEDIA/) **PLUG** (HTTPS://WWW.SYRI.NET/PLUG/) **MARKETING** (MAILTO:MARKETING@SYRI.NET) **+355697009690** (TEL:+355697009690)



(https://www.syri.net/)



GENC POLLO

Tri fjale për kryebashkiakun Vellaj
(https://www.syri.net/op-ed/762114/tri-fjale-per-kryebashkiakun-vellaj/)



LUTFI DERVISHI

Spektakli i munguar i prangave
(https://www.syri.net/op-ed/762095/spektakli-i-munguar-i-prangave/)



Toka me qira dhe gosti elektorale: Si po blihen votat nga socialistët në Fier

(https://www.syri.net/politike/761819/toka-me-qira-dhe-gosti-elektorale-si-po-blihen-votat-nga-socialistet-ne-fier/)
Toka me qira dhe gosti elektorale: Si po blihen votat nga socialistët në Fier
09:51, 10/02/2025
FORWARD?
https://www.syri.net/politike/761819/toka-me-qira-dhe-gosti-elektorale-si-po-blihen-votat-nga-socialistet-ne-fier/



DENONCO (HTTPS://WA.ME/+355697009691)

https://www.syri.net/politike/761819/toka-me-qira-dhe-gosti-elektorale-si-po-blihen-votat-nga-e-majta-ne-fier/

Bashkia e Fierit akuzohet se po përdor burimet dhe pasurinë publike për të ndikuar në votën e qytetarëve në zgjedhjet e 11 majit, pasi socialistët në Këshill miratuan dhënien me qira të mijëra metrave tokë pa vënë në dispozicion dokumentet.

BIRN

SOCIALISTET

Denoncimi tronditës i Berishës: Punonjësit e bashkisë që protestuan te Skapi i partisë ishin të armatosur
(<https://www.syri.net/politike/762426/denoncimi-trondites-i-berishes-punonjesit-e-bashkise-qe-protestuan-te-skapi-i-partise-ishin-te-armatosur/>)

Në fillim të janarit, Drejtoria e Artit dhe Kulturës në Bashkinë e Fierit çeli një tender me objekt "Festojmë me emigrantët fierakë në Greqi". Aktiviteti përshkruhej si "koncert festiv", për të cilin bashkia kërkonte të punësonte tre këngëtarë nga Fieri, një autobus transporti 30 vendësh dhe një koordinator.

I planifikuar të zhvillohej në Athinë në kohën kur partitë politike janë përfshirë në një garë të ethshme për votën e diasporës, koncerti u anulua.

"E anulua sepse nuk kishim bërë njoftimin pesë ditë përpara në KQZ. Aktiviteti në Athinë u zhvillua, por pa bashkinë", tha kryebashkiaku Armando Subashi për BIRN.

Aktiviteti u denoncua nga opozita si përpjekje për përdorimin e parave publike për të joshur votën e emigrantëve. Tërheqja e bashkisë erdhi vetëm pas denoncimit.

Por për përfaqësuesit lokalë të opozitës në Bashkinë e Fierit, kjo nuk është përpjekje e vetme për tjetërsim të votës përmes përdorimit të fondeve publike apo shkeljes së ligjit elektorale.

Opozita denoncoi gjithashtu dhënien e mijëra metra katrorëve tokë me qira nga Këshilli Bashkiak i dominuar nga socialistët, me qëllim sipas tyre për të ndikuar në zgjedhjet e 11 majit.



"Është skandalozë mënyra se si merren vendimet në këtë Këshill. Po të jepësh pasuritë publike me "sy mbyllur" pa një relacion shpjegues, qoftë edhe vetëm si procedurë, është kriminale", tha këshilltari i Partisë Demokratike, Endri Jaupaj për BIRN.

Kryebashkiaku Armando Subashi mohoi akuzat.

"Ne jemi në punë, bashkia do vazhdojë punën normalisht", tha ai, duke pretenduar se procedurat për dhënien e tokës nuk ishin përfunduar dhe vendimi ishte vetëm në parim.

Toka me qira para zgjedhjeve

Katër projektvendime për dhënie me qira të pasurive publike u morën me shumicën e votave të këshilltarëve socialistë në mbledhjen e datë 30 janar të Këshillit Bashkiak në Fier. Tokat ndodhen në Asturkas,



ARTIKULL JOETIK?

DENONCO ([HTTPS://WA.ME/+355697009691](https://wa.me/+355697009691))

Libofshë, Sheq, Marinas, Topojë, Bregas, Frakull si dhe dy pasuri brenda në qytet.

Dhënia e tyre me qira u bë sipas opozitës pa transparencë dhe se as këshilltarët socialistë nuk e dinin se çfarë votuan. Asnjë prej vendimmarrjeve nuk ishte i shoqëruar me dokumentacion dhe këshilltarët votuan pa e ditur as sipërfaqjen e secilës prej pasurive publike që bashkia do të japë me qira. Në pikat respektive të rendit të ditës, përshkruhej vetëm vendodhja dhe numri kadastral i pasurive.

Këshilltarët e partive të tjera votuan kundër dhe thanë se do ankimojnë vendimet, që sipas tyre janë një përpjekje për të tjetërsuar votën përmes përdorimit të pasurisë publike.

"Ne do ta ankimojmë vendimin, fillimisht te prefekti e më pas do ndjekim shkallët e gjyqësorisë. Ndërkohë do sinjalizojmë edhe KQZ për këtë vendimarrje", tha Kreshnik Dapi, këshilltar i Partisë SocialDemokrate.

"Është marrë vendim për dhënien e pasurive publike, pa asnjë informacion për përfitimet që do të ketë komuniteti, subjektet që përfitojnë dhe për çfarë do shfrytëzohen këto toka", shtoi ai.

Këshilltarët e partive në opozitë shtuan gjithashtu se në Këshill u votua pa pasur informacion. "Sigurisht që ka efekte elektorale një pasuri e tillë e dhënë në këtë moment para zgjedhjeve," shtoi më tej Dapi.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak, Antoneta Çuni pranoi se nuk ishte në dijeni të detajeve për dhënien e tokave me qira dhe këmbënguli se detyra e saj ishte vetëm të drejtojë mbledhjet.

"Nuk i di detajet, por di që janë tokë shtet dhe pa frut. Unë nuk kam detyrim të njoh detajet e projektvendimeve që kalojnë në Këshill, por vetëm të bëj detyrën time si drejtuese e atij Këshilli ku të respektohet ligji për vendimmarrjen nga pikëpamja procedurale", tha Çuni.

Kryebashkiaku Subashi mohoi që vendimi të ketë lidhje me zgjedhjet dhe pretendoi se ishte vijim i punës së bashkisë. Ai tha se vendimi ishte marrë vetëm në parim dhe se procesi do të vijonte me shqyrtimin e ofertave. "Më tej do vazhdojmë me procesin e shqyrtimit të ofertave dhe tokat do t'i marrë ai që jep ofertën më të mirë", tha Subashi.

Kjo vendimarrje nuk është i vetmi rast që opozita pretendon se lidhet me zgjedhjet. Zyrtarë lokalë të opozitës kanë dënuar marrjen pjesë të administratës në aktivitetet e socialistëve, ndërsa po ashtu BIRN gjeti se punonjës të ndërmarrjeve të bashkisë morën pjesë në një gosti të shtuar nga Partia Socialiste me pensionistë.

Për kryebashkiakun Armando Subashi, përfshirja e administratës apo punonjësve të bashkisë në aktivitetet zgjedhore është çështje orari. Sipas tij, askush nuk mund të ndalojë një nënpunës, qoftë zyrtar i lartë apo punonjës pastrimi, të marrë pjesë në fushatë pas orarit zyrtar të punës.

"Nëse akuzat që bëhen verifikojnë se këta punonjës janë në orar zyrtar, unë jam i gatshëm të marr masat sipas ligjit," tha Subashi.

Por përfaqësues të opozitës pretendojnë se punonjësit e administratës janë nën presion për të qenë pjesë e aktiviteteve elektorale dhe këmbëngulin se mjaft prej tyre kërcënohen me vendin e punës.

(<https://aleanetike.media/raporto-syri-net/>)

më të lexuarat

VIDEO/ Denoncimi i 'Piranjave', reagon Cellbashi: KQZ nuk ofron regjistrim në terren të emigrantëve

(<https://www.syri.net/politike/761600/video-denoncimi-i-piranjave-reagon-celbashi-kqz-nuk-ofron-regjistrim-ne-terren-te-emigranteve/>)

Kush është Chris LaCivita, arkitekti i fitores së Donald Trump më 2024, që do të udhëheqë fushatën e PD më 11 maj

(<https://www.syri.net/politike/761856/kush-eshte-chris-lacivita-arkitekti-i-fitores-se-donald-trump-me-2024-qe-do-te-udheheqe-fushaten-e-pd-me-11-maj/>)

Mediat e huaja: Lajm viral, LaCivita do të punojë për opozitën dhe Berishën

(<https://www.syri.net/politike/762368/mediat-e-huaja-lajm-viral-lacivita-do-te-punoje-per-opoziten-dhe-berishen/>)

📞 DENONCO ([HTTPS://WA.ME/+355697009891](https://wa.me/+355697009891))

"Unë di raste me emër dhe mbiemër që janë hequr nga puna duke u thënë: Nuk je me ne. Janë duke bërë fushatë shumë agresive. Tani me volën e diasporës po kërkojnë nga punonjësit e administratës të dhënat e të afërmyve jashtë, e-mail dhe numër telefoni", tha përfaqësuesi i Partisë së Lirisë, Arben Çuko.

Akuzat për punësime

Ndryshe nga Bashkia e Fierit, në Lushnjë opozita ankohet për rritje fiktive të numrit të punonjësve në kompanitë në varësi të bashkisë. Përmes një kërkesë për informacion, BIRN mësoi se numri i punonjësve në bashkinë e Lushnjes u rrit me 37 vetë, nga 1033 në vitin 2023, në 1070 në vitin 2024.

Drejtoresha e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Lushnjes, E.Q. tha se kjo rritje e numrit të punonjësve është bërë si plotësim i nevojave që kishin disa sektorë në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike. "Është për nevojat e ardhura nga drejtoritë përkatëse, psh ka rritje të Sektorit MZSH (nevojë e vazhdueshme nga zjarret) një nga bashkitë me numër më të lartë zjarresh", pretendoi ajo.

Deputeti i Partisë Demokratike, Saimir Kreshi thotë se ndërmarrjet vartëse apo shoqëritë anonime me aksioner kryesor bashkinë, po përdoren për punësime elektorale. Sipas tij, kjo ndodh sepse shoqëri si ujësjellësi nuk japin llogari për punësimet duke qenë se operojnë si subjekt privat.

"Unë e kam deklaruar edhe nga foltorja e Kuvendit, në Lushnjë janë punësuar në bashki persona që nuk janë fare në Shqipëri edhe marrin rrogën. Skandal i shkon deri aty sa një vend pune të ndahet përgjysmë, sigurimet i merr një punonjës dhe pagën një tjetër", tha Kreshi për BIRN.

Kreshi tha gjithashtu se duke qenë ndërmarrje shërbimesh, punësimi bëhet pa kriter arsimimi dhe profesional, ndërsa kontratat në punë janë me afate të shkurtra që nuk i kalojnë 6 muajt.

Bashkitë Divjakë dhe Rrokskovec nuk lu përgjigjen kërkesës së BIRN për informacion mbi numrin e punonjësve dhe ndryshimet në këtë numër gjatë dy viteve të fundit. Bashkitë e tjera të Qarkut të Fierit, që lu përgjigjen kërkesës për informacion pretenduan se numri i punonjësve në to nuk kishte ndryshuar.



Lexo edhe:



Kërcënimi ndaj Metës në burg/ Berisha: Akt banditesk dhe hakmarrës i Edi Ramës

(<https://www.syri.net/politike/762433/kercenimi-ndaj-metes-ne-burg-berisha-akt-banditesk-dhe-hakmarres-i-edl-rames/>)



VIDEO/ Berisha: Burri i Aiketa Vejsluti ndërton në mes të parkut të Tiranës vetëm pse sponsorizoi detoksin e Ramës

(<https://www.syri.net/politike/762430/video-berisha-burri-i-aiketa-vejsluti-nder-ton-ne-mes-te-parkut-te-tiranes-vetem-pse-sponsorizoi-detoksin-e-rames/>)

Berisha: Sot është fillimi i një fushate që do të rikthejë Shqipërinë në rrugën e shpresës
(<https://www.syri.net/politike/761858/berisha-sot-eshte-fillimi-i-nje-fushate-qe-do-te-riktheje-shqiperine-ne-rrugen-e-shpreses/>)

'Mos guxoni të më merrni telefonin'/ Rama kërcënon njerëzit e drejtësisë
(<https://www.syri.net/politike/762370/mos-guxoni-te-me-merrni-telefonin-rama-kercenon-njeret-e-drejtetise/>)

Lumir Abdixhiku fton qytetarët e Kosovës të votojnë: Vendosni fatin tuaj për 4 vitet e ardhshme
(<https://www.syri.net/politike/761603/lumir-abdixhiku-ften-qytetaret-e-kosoves-te-votojne-vendosni-fatin-tuaj-per-4-vitet-e-ardhshmes/>)

Chris La Civita: Berisha do fitojë, ai është një mik i vërtetë i SHBA dhe Donald Trump. Rama është marionetë e Sorosit
(<https://www.syri.net/politike/761859/chris-lacivita-berisha-do-fitoe-ai-eshte-nje-mik-i-vertete-i-shba-dhe-donald-trump-rama-eshte-marionete-e-sorosit/>)

VIDEO/ A po merr Rama drejtimin e bashkisë së Tiranës, zbulon sot takimin e parë

📢 DENONCE/INTERSHARK (MIR-65597-00007)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 940 Prot.

Fier, më 22.01.2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dëjani: KRYETARIT TË BASHKISË FIER

PREFEKTIT TË QARKUT FIER


Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e Enjte datë 30.01.2025 në orën 13:00 me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 23.12.2024
3. Projekt – vendim: "Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Fier"
4. Projekt – vendim: "Për miratimin e kalendarit vjetor të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fier për vitin 2025"
5. Projekt – vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Dhjetor 2024"
6. Projekt – vendim: "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok - ndihmën me fondet e pushtetit qëndror e vendor për vitin 2025".
7. Projekt – vendim: "Për praninë në Shtëpinë e të Moshuarve Fier të Shtetasit Theodhor Haki Bjeko"
8. Projekt – vendim: "Për një shtesë nga të ardhurat e trashëguara në Buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2025"
9. Projekt – vendim: "Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë për vitin 2025"

10. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit Subvencionimi i interesave të kredisë “
11. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e projektit: “Pompat e Hidrovorit në Darëzezë deri në Bregdet” si dhe bashkëfinancimin e Bashkisë me Këshillin e Qarkut Fier në këtë projekt ”
12. **Projekt – vendim:** “Për projektimin dhe financimin e segmentit rrugor, nga “Unaza e madhe e Rrugës Skënderbe” deri tek kryqëzimi me rrugën “Mujo Ulqinaku”, si dhe autorizimin e ekzekutivit të bashkisë për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në kuadër të realizimit të këtij projekti
13. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e projektit për vazhdimin e fazës së II-të, të” Unazës së Cakranit”
14. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e vijimit të procedurës për dhënien me qira të pasurisë,. Nr.7/362, zk.8531 lagja “1 Maj”, pasurisë,. Nr.4/414 , zk.8534, pasurisë,. Nr. 4/30-N2 , zk.8534 lagja “Kastriot” , në pronësi të Bashkisë Fier “
15. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes tokë pa frut në fshatin Hasturkas, Njësia Administrative Libofshë , Bashkia Fier”
16. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e dhënies me qira të pasurive.. Nr.9/10, zk.3358 ndodhur në fshatin.”Sheq Marinas”, Njësia Administrative Topojë , Bashkia Fier,. Nr.4978, zk.1273 ndodhur në fshatin Bregas , Njësia Administrative Frakull , Bashkia Fier , të llojit tokë arë , në pronësi të Bashkisë Fier “
17. **Projekt – vendim:** “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Nuri Ferko, lagjia, “Mbrostar Ferko”, Njësia Administrative nr. 3, për dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga zjarri i datës 23.11.2024”
18. **Kërkesë** “Për dhënie ndihme të menjëherëshme Alketi Zonja ”
19. **Diskutime dhe komente**

Kryetar Këshilli

Antoneta Çunaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr.

Fier në 22.01. 2025

VENDIM NR. 21 DATË 22.01.2025

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 " Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit", Kreu 2, neni 22 "Kryesia e Këshillit " neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraparak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 30.01.2025. Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraparak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Antoneta Lunaj

2-Endri Jaupaj

5-Kreshnik Dapi

3-Fatbardha Merkaj

6-Arben Çuko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 940 Prot.

Fier, më 22.01.2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER

PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e Enjte datë 30.01.2025 në orën 13:00 me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 23.12.2024
3. Projekt – vendim: "Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Fier"
4. Projekt – vendim: "Për miratimin e kalendarit vjetor të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fier për vitin 2025"
5. Projekt – vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Dhjetor 2024"
6. Projekt – vendim: "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok - ndihmën me fondet e pushtetit qëndror e vendor për vitin 2025".
7. Projekt – vendim: "Për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier të Shtetasit Theodhor Haki Bjeko"
8. Projekt – vendim: "Për një shtesë nga të ardhurat e trashëguara në Buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2025"
9. Projekt – vendim: "Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë për vitin 2025"

10. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit Subvencionimi i interesave të kredisë “
11. **Projekt – vendim:**” Për miratimin e projektit: “Pompat e Hidrovorit në Darëzezë deri në Bregdet” si dhe bashkëfinancimin e Bashkisë me Këshillin e Qarkut Fier në këtë projekt ”
12. **Projekt – vendim:** “Për projektimin dhe financimin e segmentit rrugor, nga “Unaza e madhe e Rrugës Skënderbe” deri tek kryqëzimi me rrugën “Mujo Ulqinaku”, si dhe autorizimin e ekzekutivit të bashkisë për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në kuadër të realizimit të këtij projekti
13. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e projektit për vazhdimin e fazës së II-të, të” Unazës së Cakranit”
14. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e vijimit të procedurës për dhënien me qira të pasurisë,. Nr.7/362, zk.8531 lagja “1 Maj”, pasurisë,. Nr.4/414 , zk.8534, pasurisë,. Nr. 4/30-N2 , zk.8534 lagja “Kastriot” , në pronësi të Bashkisë Fier “
15. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes tokë pa frut në fshatin Hasturkas, Njësia Administrative Libofshë , Bashkia Fier”
16. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e dhënies me qira të pasurive,. Nr.9/10, zk.3358 ndodhur në fshatin,”Sheq Marinas” , Njësia Administrative Topojë , Bashkia Fier,. Nr.4978, zk.1273 ndodhur në fshatin Bregas , Njësia Administrative Frakull , Bashkia Fier , të llojit tokë arë , në pronësi të Bashkisë Fier “
17. **Projekt – vendim:** “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Nuri Ferko, lagjia, “Mbrostar Ferko”, Njësia Administrative nr. 3, për dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga zjarri i datës 23.11.2024”
18. **Kërkesë** “Për dhënie ndihme të menjëherëshme Alketi Zonja ”
19. **Diskutime dhe komente**

Kryetar Këshilli

Antoneta Çunaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr.

Fier në 22.01.2025

VENDIM NR. 21 DATË 22.01.2025

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 " Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit", Kreu 2, neni 22 "Kryesia e Këshillit " neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraparak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 30.01.2025. Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraparak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Antoneta Junaj

2-Endri Jaupaj

5-Kreshnik Dapi

3-Fatbardha Merkaj

6-Arben Çuko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21.02.2025

Nr: 133

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 31 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 21.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: Zj. Antoneta Çuni
Kryetar i Këshillit Bashkiak Fier

Z. Arnando Çupa
Sekretar i Këshillit Bashkiak Fier

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht miratimi i akteve nënligjore për dhënien e tokave me qira para fushatës zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 31 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtrohet sa vijon:

Data: 21.02.2025

Nr: 133
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 31 ID datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

“Sipas denoncimeve të shumta në media, rezultoi se në mbledhjen e datës 30 janar të Këshillit Bashkiak në Fier janë miratuar katër projektvendime për dhënie me qira të pasurive publike të cilat u morën më shumicën e votave të këshilltarëve socialistë.

Në faqen zyrtare të Bashkisë Fier është publikuar vetëm shkresa “Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak”, që mban datën 22.01.2025 ndërsa projektvendimet nuk gjenden të publikuara, duke shkelur në këtë mënyrë edhe parimin e transparencës. Kopje të kësaj shkrese do ta vendosim në dispozicion për shqyrtimin tuaj.”

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Zj. Antoneta Çuni, Kryetar i Këshillit Bashkiak Fier;
- Z. Amando Çupa, Sekretar i Këshillit Bashkia, Fier

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

TRONAZHIMI E KËNE ZANDESHI

Shpreh: Mëni kujdes për të shprehur vetë qendrën e vëmendjes tuaj në fjalë sipas të cilës përfundimtare të zgjedhjes. Mëni! (përkrahje për anëtarin e paritë të kësaj të përvuadhit).

CELIA

Beitrag: Fier

GV/Frek

NOT THE LIST

CHER, ATEL, MEMBER

CELLULAR

ENTRADA:

3048

GEZIM NOVBUZ HATVNI

0682610 K48

Tratando-se de pessoas e organizações (incluindo também as pessoas físicas) que se encontram em situação de vulnerabilidade social, o presente relatório tem como objetivo principal apresentar o perfil socioeconômico e cultural da população em situação de vulnerabilidade social, bem como as principais causas e consequências da situação de vulnerabilidade social.

U.S. AIR FORCE

[illegible]

INSTITUCIONI

QARKU Fier

BASHKIA Lushnje

NJESIA ADMINISTRATIVE Alibon

NR	EMER	ATESI	MBIEMER	NR . PERSONAL (ID)	NJESIA ADMINISTRATIVE KU VOTON	NR . TELEFON
1	Xhulipana	Nesti	Lic	J106160368	Alibon	0677508
2	Nesti	Zoi	Lic	G60508024V	Alibon	0676252
3	Marpaarta	Ndini	Lic	G65423013F	= 2896	
4	Apoca	Koti	Basha	H0082403V	= 2896	069296
5	Pellumbexha	Zoi	Basha	G55907063V	2896	069828
6	Rristyana	Apion	Basha	J75226015C	2896	069828
7	Varmela	Apion	Basha	K25620017I	2896	069828
8	Apostol	Themi	Lic	F81025061G	2896	069828
9	Lilyana	Ndrek	Lic	G25724067S	2896	
10	Geddon	Apostol	Lic	J70716021A	2896	
11	Amxhel	Fatmit	Lic	J56016081W	2896	
12	Ndona	Thoma	Lic	F70310097F	2896	
13	Evelena	Peti	Arzhe	F46203023K	2896	068240
14	Mirza	Ndini	Arzhe	H30803060W	2897	06928
15	Elamtim	Flamur	Arzhe	H86112051S	2897	06986
16	Alma	Ilir	Arzhe	J860030256	2897	069725
17	Karati	Ilir	Arzhe	K50572017P	2897	73938
18	Erind	Nesti	Lic	J80812028S	diondara	

DOREZOI Thuliano Lic













Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 MAJ 2025
PROCESVERBAL KZAZ - KQV

Për pajisjen me materiale për administrimin e zgjedhjeve

a)	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia
1.	Vula/kode sigurje	copë	9
2.	Vula/kode sigurje rezerve	copë	3
3.	Fletet e votimit	plet	865
4.	<i>Butia, e madhësisë Zgjedhjeve</i>	ret	1
5.	<i>Vula e PU</i>	copë	1
6.	<i>Vula, e kryetarit</i>	copë	1
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
b)	Emërtimi i artikujve të inventarizuar	Njësia	Sasia
1.	Kuti votimi	copë	1
2.	Kuti materialesh	copë	1
3.	Kuti rezerve	copë	1
4.	<i>PEI</i>	copë	1
5.	<i>Hamiera</i>	copë	1
6.			

- Materialet e inventarizuara kthehen në KQZ. Moskthimi i tyre ngarkon KZAZ me përgjegjësi financiare.
- Ky procesverbal mbahet në 4 kopje. Kopja origjinale e kësaj procesverbali dorëzohet në KQZ për efekt verifikimi të vlerës së materialeve të dorëzuara në KQZ në përfundim të procesit zgjedhor. Secila kopje fitohet nga Kryetari, ZvKryetari, Sekretari i KZAZ dhe punonjësi i KQZ-së që kryen dorëzimin. Materialet të cilat duhen kthyer në KZAZ dhe KQZ, janë të inventarizuara dhe moskthimi / dëmtimi i tyre ju ngarkon me përgjegjësi financiare, kundrejt vlerës të pa-dorëzuar në KQZ.
- Në rast dëmtimi, thyerje apo humbje të materialeve mbahet një procesverbal nga personat përgjegjës dhe i dorëzohet menjëherë KQZ-së.

KQV Nr. 3020/00

KZAZ Nr. 60

Kryetar:

Nivellu Novosky
(emër, mbiemër, firmë)

Zv/Kryetar:

Edheleto Vlahu
(emër, mbiemër, firmë)

Sekretar:

Enjan Kalo
(emër, mbiemër, firmë)

Kryetar:

Shkëlzen Mehmeti
(emër, mbiemër, firmë)

Sekretar:

Uroshi Baro
(emër, mbiemër, firmë)





O Çështjet kryesore

Shuhet Artan Lame!

Goditet rrjeti kriminal i trafikut të drogës Shqipëri-Itali

E PLOTË – Tirana pret 47 liderët e Europës

Politikë

11 Maj 2025, 10:57

Humbin 500 fletët e votimit në Fier, gjenden vetëm 47 të tilla, mund të pezullohet procesi



Shkruar nga Newsbomb



